



**ME EMRIN E ALL'LLAHUT,
TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR'ANIT
SHQIPËRI

DRITA E KUR'ANIT

REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE
DHE E STUDIMEVE KUR'ANORE

TIRANË, 2011

Drejtör: prof. Muhammed Reza Haj Kheizr

REDAKSIA:

Prof. dr. Bedri BYLYKU

H. Jetmir ÇELA (*sekretar i redaksisë*)

Prof. dr. Feti MEHDIU

H. Vullnet MERJA (*zëvendëskryeredaktor*)

H. Sulejman efendi REXHEPI

H. Selim STAF

Prof. dr. Hajri SHEHU (*kryeredaktor*)

Redaktore: Liseda RAMAJ

Përkthyes të përmblendhjeve: Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA
Radhitja në kompjuter: Liseda RAMAJ

Fondacioni i Kur'anit

Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272

©: Fondacioni i Kur'anit 5 4 2377311 Tirana – Albania

Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

Del katër herë në vit

FOUNDATION OF QUR'AN
ALBANIA

THE LIGHT OF QUR'AN

QUARTERLY SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR'ANIC
RESEARCHES AND STUDIES

TIRANË, 2011

PASQYRA E LËNDËS

H. Ismet Dibra: Vetëm aj që s’e njih veften, i shtëmanget feës islame	9
Abduldaem Al-Kahiil: Përputhje mes Kur’anit dhe shkencës	17
Ajni Sinani: Hixhreti – ndryshim i rrjedhave të historisë	37
Hajri Shehu: Ç’thotë Kur’ani për Isanë	45
Zbulime shkencore në një këndvështrim tjetër	46
Shtegtimi	52
Shumë gjumë dhe vdekje e papritur	57
Kontribute të teknologjisë islame	59
Aliaa Ibrahim Dakrouy: Një qasje filozofike për hermeneutikën e Kur’anit	66
Ma. Albana Muja: Surja “Jusuf” dhe shoqëria e sotme	89
Dr. Feti Mehdiu: Përzgjedhje në komentimin e Kur’ani Kerimit	98
Hajri Shehu: Rreth shkronjave të veçanta në Kur’an	104
Aktivitete	106
Përmbledhje në gjuhën angleze	108
Përmbledhje në gjuhën arabe	113

TABLE OF CONTENTS

H. Ismet Dibra: Only he who doesn't know himself, avoids the Islamic religion	9
Abduldaem Al – Kahiil: The Compliance between Qur'an and the Science	17
Ajni Sinani: Hijrah - a Change in the Course of History	37
Hajri Shehu: What does the Qur'an say about Jesus	45
Scientific discoveries in a different approach	46
Migration of birds and animals	52
Much sleep may result in sudden death	57
The Contributions of Islamic Technology	59
Aliaa Ibrahim DAKROURY: A Philosophical Approach for the Hermeneutic of the Qur'an	66
MA. ALBANA MUJA: The surah "Yusuf" and the present day society	89
Dr. Feti Mehdiu: The Selection in the Commentary of Qur'an Karim	98
PhD Hajri Shehu: About the Separate Letters in the Qur'an	104
Activities	106
Summaries in English	108
Summaries in Arabic	113

فهرس الموضوعات

9	حافظ عصمت دبير ا	"الذى لا يعرف نفسه فقط يحيد عن الدين الاسلامى"
17	عبدالائم الكحيل	التطابق بين القرآن والعلم
37	أ. عيني سناني	الهجرة النبوية – تغيير مجرى التاريخ
45	ماذا يقول القرآن عن عيسى (ع)	
46	اكتشافات علمية من منظور آخر	
52	هجرة الطيور و الحيوانات	
57	كثير من النوم وموت مفاجئ	
59	إسهامات التكنولوجيا الإسلامية	
66	عليا إبراهيم الذكورى	مقاربة فلسفية حول هرمنيوطيقا (تفسيرية) القرآن
89	ألبانا مويا	سورة يوسف و المجتمع اليوم
98	د. فتحي مهديو	منتخب من تفسير القرآن الكريم
104	أ. د. خيرى شيو	حول الحروف المقطعة
106	نشاطت علمية قرآنية	
108	ملخص باللغة الإنكليزية	
113	ملخص باللغة العربية	

H. Ismet Dibra

Vetëm aj që s'e njeh veften, i shtëmanget feës islame.¹

*“Kush asht aj qi i shtëmanget feës së Ibrahimit, veç atij
qi s'din vehten e vet? Baj be në vehten t'eme Hyjnore
se na me madhnin t'onë me të vërtetë e kimi pëlqye
Ibrahimin në dynjat, e kimi zgjedhë ate për Pejgamber;
aj edhe në ahiret asht nga partia e të mirëvet.”*

Kur-an: 1-130

Kur-ani, thesari i pasosëshëm i dituris s'amshueshme në të cilën njuhunit shkencore e filosofike të zbulueme e të diktue me deri sod, si edhe ata qi do të diktohen e do të zbulohen mbas sodi krejt së bashku formojnë një pjesë nën mikroskopike, këjo gurrë e pa shterun edhe e pambarueme ka lanë me gisht në gojë gjithë dijetarët e naltë e të vërtetë të kësaj botë. Le të mos çuditemi aspak; në qoftë se kështu besojmë për Kur-anin; pse, ky besim nuk rrjedh një zembër naive, por rrjedh nga një studim i kthjellë qi kemi ba përgjithësisht mbi Kur-anin e madhnueshëm. T'u jemi mirnjofhtës të parëve t'onë, të cilët me një vullnet të patundun kanë dijtë me ruajtë origjinalin e Kur-anit Hyjnuër dhe s'kanë tolerue fare qi të ndryshohet as pjesa ma e vogël e Tij, ashtu sikur nuk lejohet as sod. Provat e këtij fakti të gjallë i kemi parasysh: hafizët e ndershëm, ajo rojë e fortë e besnike që ja ka ba detyrë vehtes me i dalë zot Kur-anit të Zotit, ata ushtar të vlefshëm qi k anë pasë fatin e bardhë me e xanë përmenç fjalëne shenjtëte.

1. Titulli është i redaksisë. Shkrimi është marrë nga cikli i ligjeratave me titull “Ç'urdhënon Kur-ani”, “Zani i Naltë”, 1932, 1, f.381-392.



Perendis që ne e quajmë Kur-an, e kanë krye shërbimin e vet pa ndonji shpërblim material dhe deri sot nuk kanë durue fare as ndryshimin ma të vogël të Tij. Janë këta ushtarë besnik të Fjalës Hyjnore që me të shpejtë ja presin yryshin atij që e këndon gabim, kushdo qoftë dhe i thonë: “Ndal zoti, përsërite se e këndove gabim.” Këto njerëz i lavdëron Hazreti Muhammedi me këtë Hadith-Sherif: “Ma të ndershmit e besnikëve të mi janë Hafizët.” Ç’ka fitue Islamizma nga ky kontroll kaqë me kujdes që i ka vu Kur-anit? – ka sigurue saktësin e Kur-anit dhe ka garantue jetën e Tij, për të cilin s’ka, jo probabilitet, po as posibilitet me psue atë që kanë psue librat e ma parëshëm, të cilët tue u përkthye gjuhë me gjuhë e tue humbë origjinalin ebreisht, janë kufizue edhe s’asht e mundun me u interpretue e me u analizue krahas me zbulimet e kohës e të shkencës. Kemi në Kur-an këtë verset:

“Ve min ajatihi khalku-‘s-semavati ve-‘lardi vema beth-the fihima min dab-betin vehuve ala xhem-ihim idha jeshau Kadir.” 42-29. Ky verset Shqip e ka këtë kuptim: “Krijimi i qiellnave e i tokës edhe i frymorëve që gjinden ndër ta janë shenja që dëshmojnë Perendin, i cili kur të dojë asht i Zoti me i bashkue keta frymorë.” 42-29. Fjala “Dab-betin = frymor” ka qenë interpretue nga gjithë Dijetarët Islam të moçëm me kuptimin metaforik “Engjell” për shkak se asndokuj s’ja ka kapë mendja se në trupat qiellorë ka frymorë e njerëz. Sod, kur me anë të teleskopit astronomët shofin në trupat qiellorë njerëz, rrxohet interpretimi i derisoçëm fjalës “Dab-betin” por e ka kuptimin e vërtetë “frymor”.

Sikur të kishte humbë shumë origjinali i Kur-anit dhe të kishim në dorë vetëm përkthimin, atëherë s’kishim me e pasë fjalën “Dab-betin”, por fjalën “Engjell” dhe kështu Kur-ani sod do të binte në kundërshtim me Shkencën, e tue qenë origjinali i saktë gjall, marrim vesht se jo Kur-ani por interpretimi asht kundra Shkencës. Kur-ani jo që s’i kundërshton Shkencës, por sikurse na flet fraza e mbrapme e versetit të ma sipërme “... i cili kur do të dojë asht i zoti me i bashkue keta frymorë” i nxit e i këndell Shkencëtarët me kërkue e me pushtue botën qiellore, pse po të doje. Perendia qenka e mundun me u bashkue frymorët e qiellit me ata të tokës.



Kur-ani me këtë verset i drejton Shkencëtarit kete mesazh:
“Zbulo mjetet se mund të dalish edhe në qiell...” Ky pra asht Kur-ani i Perendis, i cili i thotë njeriut, mos u kënaq me ate qi trashgove prej prindenish, por përpiku me i shtue diçka përparimit për sat ë takon ne pjesë t’ande. Tue marrë para sysh keto pika intelektualët e vërtetë t’elementit musliman të përbotshëm e quajnë vehten incompetent me i thanë Kur-an përkthimit ose komentit të Kur-anit. Prandaj asht guxim i lalogjikshëm me pretendue një Kur-an të vërtetë Shqip, Turqisht, Greqisht, Italisht... etj. këto s’mund të jenë Kur-an, por përkëthime ose komente, të cilat koha e ardhëshme do t’i ndryshoje e do t’i përmirësoje, do t’i korigjoje e do t’i qortoje. Me gjith këtë edhe keto përkthime e komente mund t’i kryeje vetëm një pendë kompetente qi zotnon rregullat e metodat e Tefsirit. Për me përkthye Kur-anin, ma; përpara duhet me dijtë fare mirë gjuhën Arabe, gramatikën, Sindaksën, Stilistikën, retorikën, Letërsinë, Fjalorin; duhet me dijtë pastaj historinë e Kur-anit, hadithet, Usuli-hadithin, usuli-fik-hun, fillofin e një vark diturish tjera... ma në fund edhe gjith Shkancat natyrale, si edhe gjuhën, në të cilën do të përkthehet. Mbassi të zotnoje një kapacitet kaqë të gjanë, një njeri mund t’a kuptojë madhështin e Kur’anit me hollësi. Ata qi tue këndue një Kur-an Anglisht, Frengjithsht, ose Italisht dhe qi kuptojnë se e kanë marrë vesht kuptimin e vërtetë të Kur-anit, ndofta sa për vehten e tyne kanë marrë vesht ndonji gja, por jo kurrëer me predikue botën ose me kritikue Kur-anin e fesë Islame. Këjo gradë nuk arrihet tue studjue ndonji copë libër sa për me shkruie një artikull më ndonji fletore, ose me ndonji rivistë, por kërkon një studjim serioz, të gjatë e të vazhdueshëm. Me fjalën “Hoxhë” do të kuptojmë një njeri qi zotnon një kultur të gjanë e një dije të plotë, në mënyrë qi u tha sypr, e jo ç’do njeri qi ka çallmë në kokë. Mbassi deri këtu kujtojmë se kemi dhanë mjaft dritë mbi ato qi janë kompetentë me spieue kuptimin e Kur’anit, tani le të shofim se keta dijetarë të naltë (paçim bekimin e Perendis) si e spiegojnë Urdhnin Hyjnuër të Kur-anit qi vumë në krye të këtij artikulli.



Urdhnon pra Perndija xhel-le shanuhu: “ve men jergabu an mil-leti Ibrahime il-la men sefihe nefsehu ve le kad istafejnahu fi’d-dunja ve in-nehu fi’l-ahireti le min’ ess-sselihine.” Po t’a përkthejmë fjalë për fjalë kete verset, ka me na dhanë kete kuptim të çuditshëm: “Edhe kush epet nga feja e Ibrahimit veç kush dhunon vehten e vet? Edhe betohem se me të vërtetë e pëlqyem ate në botë edhe padyshim aj në ahiret asht nga të mirët.” Si shifet, së parit verseti e naltpërmendun e humbi fuqin e elokuencës qi zotnon në original; së dytit humbi shijën artistike e së fundit e humbi edhe kuptimin e vërtetë, e sikur mos t’ishte origjinali arabisht, ky verset s’kishte me pasë ndonji vlerë. Ato qi e dijnë mirë gjuhën letrare të Kur-anit edhe janë pajosë me diturit e nevojshme qi kërkon Tefsiri kështu e spiegojnë kete verset të naltë: “ky verset ka zbritur kundra një çifuti të qujtun Muhaxhir, i cili ishte i nipi i Abdull-llah Selamit. Ky mbassi pranon feën Islame, deshi me kthye në kete feë edhe nipat e vet, Selemen edhe Muhaxhirin, të cilëve ju tha: o nipat e mil ju e dini mirë se Zoti Urdhnon në Teurat qi – Un kam me dergue një Profet të qujtun Ahmet prej skotës së të madhit Ismail; kushdo qi ti besojë atij asht drejtue për së mbari edhe aj qi nuk i beson ka humbë rrugën e drejtë dhe ka me u mallkue.² Mbas këtyne fjalëve Selemeja besoj edhe Muhaxhiri abstenoi, e, prandoj ky i fudit qortohet me kete ajet. Tani le të hedhim një sy në pikpamje gjuhe: Kallzuesi “jergabu” e ka participin “ragbet” qi përdoret edhe Shqip në shumë vende; gjith bota i ka dhanë ragbet Sportit; bujqësia e industria s’kanë ma ragbet e prandaj u shkaktua kriza ekonomike. Si kuptohet nga kto shemblla, fjala “ragbet” ka kuptimin me dashtë e me dishërue një gjë, me u prirë ka një gjë, me lakmue një gjë e me u përpjekë për t’a shti në dorë. Dijetarët e mëdhej tue dijtë kete kuptim të fjalës “ragbet” e tue krahasue me kuptimin e frazës Hyjnore kush epet nga feja e Ibrahimit veç atij qi dhunon vehten e vet?...” gjejnë një kundërshtim të madh. Atëherë shofin nevojën të studjojnë rregullat karakteristike të gjuhës Arabe, ku gjejnë se verbi “ragbet” kur asht i ndjekun 2. Fjalët e Abdull-llah Selamit vërtetojnë edhe njëherë se paralajmërimet e Bibllës për Hazreti uhammedin kanë eksistue deri në Shekullin e lumnueshëm të Profitit të madh dhe janë fshi e shdukë mas vonë.



nga parafjala “an” formon një lokusion dhe ka kuptimin “me refuzue me u shtëmangë.” Mbassi u kuptue kejo karakteristikë e gjuhës Arabe, del në shesh kuptimi i urdhnit Hyjnuër kështu: A asht e mundun ta refuzoje kush feën e Hazreti Ibrahimit, asht e mundun t’i shtëmanget kush kësaj feje të naltë? Jo kurrë. Kete mund ta baje vetëm aj qi dhunon vehten e vet, vetëm aj qi ban keq vehtës, d.m.th; nga feja s’e din vehten e vet, se po t’a din vehten e vet nuk ja ban kete dhunë; dhuna mund ti bahet armikut, e jo vehtes. Tani këtu na mbetet të shkoqisim cila asht feja e Hazreti Ibrahimit dhe cila asht dhuna qi i ban vehtes aj njeri qi i shtëmanget kësaj feje, ose cili asht aj njeri qi s’e din vehten. Gjith bota e dijnë se Hazreti Ibrahim ka qenë një ndër Profetët e medhej të Perëndis i dërguëm me tërheqë në rrugë të Zotit politeistët dhe idhujtarët e Mezopotamis së moçme, të cilët nuk e çmuën vlerën e këtij njeriu të madh, por e munduën e ma në fund me urdhnin e Nemrudit e hiodhën edhe në zjarrin e madh qi kishin pregatitë postafat; por ky besnik i Perëndis nuk u tund nga këjo ngjarje e tristuëshme; Aj në mjedis të zjarmit qi ju ba lulishte e fladëshme adhuronte Krijuesin e Plotpushtetshëm. Feja e Hazreti Ibrahimit pra asht Feja hyjnore qi duhet të besojë krejt njerzia. Feja Hyjnore asht një e vetme. Të njajtën feë kanë kumtue gjith Profetët e Zotit. Feë d.m.th. direksioni i njeriut drejt Perëndis. Gjeometria na vërteton se ndërmjet dy pikave vetëm një vizë të drejtë ka edhe këjo vizë formon rrugën ma të shkurtë në mestë t’atye dy pikave. Kështu asht edhe njeriu me Perëndinë. Në mest të tyne vetëm një rrugë të drejtë ka, edhe ajo asht Feja Hyjnore qi kanë kumtue gjith Profetët e Zotit, e sidomos, Ibrahim, Musai e krishti.

Me frazën e fundit i çelëm punë vehtes: Mbassi gjith Profetët, e sidomos Ibrahim, Musai e Krishti paskan kumtue të njajtën feë të hyjnuëshme, ç’kërkon Hazreti Muhammedi me feën islame? Asht një fakt historik i pa kontestuem se njerzit kur janë lidhë ngushtë me feën e hyjnuëshme dhe në bazë të kësaj kanë formue karakterin e tyne janë lumtënue shumë shpejt.



Fatkeqsisht i lumtuni kur e len feën hyjnore hasdiset e çapërdiset, prish moralin dhe nga një herë harron edhe Perëndin (Zot na ruej). Kështu kemi çifutënit që ushqeheshin me tryezën hyjnore, nga e cila u hazdisën dhe filluën me kërkue qepë, bathë, fasule e hudra edhe i kundërshtuën Profitit të tyre, Hazreti Musait; gatuën viçin e artë, të cilin e adhuruën si Perëndi dhe harruën perëndin e vërtetë që i ushqeje me tryezën hyjnore. Keto fakte na provojnë se feja hyjnore nga njëherë harrohet e lehet mbas dore; atëherë perëndia, që është mbrojtësi i vërtetë i saj, ka dërgue një Profet tjetër, e kështu një mbas një të gjithë. Të gjithë Profitët e Zotit janë d'akord në bazat dogmatike. Por ndryshojnë në dispozitat juridike e administrative që kanë kumtue për administratën e popujve, pse kohët e reja bajshin ndryshime të mëdha në jetën shoqërore, politike, ekonomike, kulture, e psikologjike. Prej sa thamë deri këtu merret vesh se feja Hyjnore është një e vetme, është ajo që Kur'an-i i thotë diku Feja e Ibrahimit e diku Feja Islame, ose Shqip Feja Paqit, Feja e Shpëtimit të njerzisë. Shumë lehtë kuptohet pse Kur'an-i Feës Hyjnore i thotë "Feja e Ibrahimit". Të tri feët e mbështetuna në librat qiellore. D.m.th. Israilizma, Kristjanizma dhe Islamizma e njohin hazreti Ibrahimin, i cili është stërgjyshi i gjithë profetëve të këtyre tri feëve, e mbasi Hyu është një i vetëm edhe feja Hyjnore është një e vetme, është ajo e Ibrahimit, prej të cilit rrjedhin gjithë Profetët e pastajmë. Prandaj hazreti Muhammedi j'u thotë dy tjerave në ju duket Islamizma një tjetër, hajdeni në feë të Ibrahimit, se aty keni me kuptue që s'jemi tjetër, por jemi një. Bazat dogmatike të Feës së Hyjnuëshme janë ata që përfshijnë në fillimin e kaptinës së dytë! Elif-Lam-Mim, Qe ky është libri në të cilin s'ka pse bahet dyshim; ky është dritë e udhëheqës për ato që kanë frigë Zotin, të cilët janë ato që besojnë papa gja me sy (gajb) edhe falen e ushqejnë nga ç'u kemi dhanë; edhe janë ato që besojnë ç'të kemi kumtue ty edhe atyre para teje; si edhe jetës së pasosun. Keto njerëz i ka shti Zoti në rrugë të mbarë dhe keto njerëz kanë shpëtue." Si shifet në këtë pjesë të Kur'anit, Muslimanët do të besojnë të gjithë librat e shenjtë ashtu si besojnë edhe Kur'anin, vetëm do të rezervohet me i kontrollue me kujdes



a janë ata qi ka dërgue vetë Perëndia a po janë ndryshue, e kete e njef muslimani fare lehtë: Po të gjeje kundërshtim ndërmjet tyre e Kur-anit për sa i përket pikave dogmatike e kupton se ata e kanë humbë saktësin e po s'pat kundërshtim janë ata vetë. Kejo kuptohet me anë të llogjikës, pse asht origjinali në shesh. Sa për pjesët praktike e veprare qi merr emnin Sheriat – Kod fetar - i cili përfshin të gjith ligjet e rregullat qi i përkasin kësaj jetë, keto pjesë ndryshojnë si mbas kohës. Prandaj Sheriati i Hazreti Muhammedit ndryshon nga Sheriatet e kalueme. Sheriati i Hazreti Muhammedit asht Sheriat i kohës së re dhe i përgjithshëm për krejt njerzinë. Parimet e nalta të këtij Sheriati kanë me qenë bazat e qytetnimit t'ardheshëm. Qysh sod kemi fakte të gjalla qi e dishmojnë kete të vërtetë, por ne këtu duëm me analizue problem tjera qi i përkasin versetit të hyjnueshëm qi duëm me zhvillue me kete artikull e prandaj kete pikë po e lamë për njëherë tjetër.

Urdhnon pra Kur-ani, se vetëm aj qi s'e njef vehten i shtëmangët feës së Ibrahimit, a po, t'a themi ndryshe, feës Islame. “Me njoftë vehten” asht grada ma e naltë qi mund t'arrijë njeriu i qytetnuëm e këjo gradë asht qëllimi i jetës. “kush njeh vehten njeh Perëndin” ka urdhnuë hazreti Muhammedi. Si thamë edhe ma sipër, në krye të Kur-anit urdhnohet se “Ky asht libri Hyjnuër, në të cilin s'ka pse me ba dyshim; Ky asht dritë e udhëheqës për ato qi kanë frigë Zotin...” Tërminalogjia e feës Islame “frigën e Zotit” e quën “Takva” e tash pra do të flasim pak për “Takva”. Takvaja ka tri gradë:

- 1) Me u ruajt nga politeisma – shirq’.
- 2) Me u ruajt nga gjith ata sende qi ka ndalue Perëndia.
- 3) Me okupue zemrën vetëm me Perëndin e me fshi nga zemra çdo gja veç Zotit.

Ata qi arrijnë gradën e tretë të Takvas, dëshirojnë e dashurojnë vetëm Zotin, e s'lakmojnë kurrë gja të kësaj bote; jeta për ta asht një ferr; Bota edhe çdo send i saj pta asht një as gja, një hije qi mund t'i u pengojë Dritën Hyjnore.



Shpirti i tyne tash fluturon në një atmosferë tjetër, në atmosferën morale të Hyjnueshme. Ky shpirt tani asht sunduesi absolut i trupit të vet e i ç'do materjali tjetër të kësaj bote. Përpara këtij shpirti ç'do gja prulet e asht gadi me çfaqë veprime që ka erën e amshimit nuk kallzohet dot me gojë e me shkrim, pse fjala e shkrimi janë mjetet e mendës kuer se në ekstazh s'vepron ma mendja e s'duhet ma aty e tutje arsyetimi. Arsyetimi na duhet për t'a zbulue të vërtetëne kur të dalë në shesh e vërteta s'mbetet ma dyshim që të kemi nevojë për arsyetim; po t'a shofim Diellin s'mbetet nevojë të mendojmë asht apo s'asht Dielli ky që shofim. Këjo gradë e takvas nuk mund të arrihet aq lehtë, për pa i shpallë një luftë të rrebtë e të vazhdueshme, pasioneve, ambicjeve dhe egoizmit.



Abduldaem Al-Kahiil

Përputhje mes Kur'anit dhe shkencës

Abstrakt

Shkencëtarët kanë zbuluar se në thellësinë e oqeanëve ka valë që janë të ndryshme nga ato të sipërfaqes. Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë të cilin e mbulojnë valë mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit Allahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë.” (En-Nur: 40)

Studiuesit francezë dhe amerikanë pobojnë se gurë të stërmëdhenj që janë përdorur nga faraonët për të ndërtuar piramidat, janë veçse deltinë që është pjekur në temperatura të larta... A kanë gjetur përgjigje shkencëtarët për misterin sesi u ndërtuan piramidat në Egjiptin e lashtë? A ka njerëz që ende besojnë se xhindet janë ndërtuesit e këtyre piramidave? A mund të besohet se piramidat e Egjiptit janë ndërtuar nga krijesa jashtëtokësore? Këto spekulime kanë mbushur botën për disa shekuj. Por, zbulimi i ri i shkencëtarëve francezë dhe amerikanë do ta ndryshojë mendimin e shkencëtarëve përgjithmonë. Ai do t'i japë gjithashtu, një shpjegim të thjeshtë shkencor misterit të ndërtimit të piramidave, por më e çuditshme është se ky mister është në Kur'an që katërmëdhjetë shekuj më parë.

Drita e Kur'anit - Nr. 4 - 2011



I. Kur'ani i Shenjtë dhe një zbulim i ri shkencor për valët e errëta në thellësinë e oqeanit

Shkencëtarët kanë zbuluar se në thellësinë e oqeanëve ka valë që janë të ndryshme nga ato të sipërfaqes. Allahu i Plotfuqishëm i shembullson veprat e ateistëve dhe të jobesimtarëve me një njeri që jeton në thellësi të detit, i mbuluar nga një shtresë valësh të thella dhe mbi të, një shtresë valësh të errta sipërfaqësore. Ky shembullsim demonstroi sesi ateistët, me veprat e tyre janë larg nga drita e Allahut. Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë të cilin e mbulojnë valë mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit Allahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë.” (En-Nur: 40).

I Madhëruar qoftë Allahu që shkencëtarët e bënë këtë zbulim në vitin 2007, kur nuk e prisnin. Dhe, ne pyesim: Kush i tha profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi tël) për valët e thella? Është Vetë Allahu që ia thotë:

“Vetëm Ai është Dijësi i Gaibit (i së padukshmes) dhe nuk ia zbulon askujt Gaibin e Tij, përveçse një të Dërguari (nga njerëzit), të cilin Ai e ka zgjedhur.” (El-Xhin: 26, 27).

A është e saktë teoria e Big Bengut? Dhe, a mund të interpretohet ajo me ajetin kur'anor të bashkimit dhe të ndarjes së qiejve dhe të Tokës? Dhe, cilat janë faktet e reja që provojnë se universi ngjante me një pëlhurë të endur që i liroi fijet e saj dhe u çap? ...

Një vëlla (Zoti i shpërbleftë me të mira atë dhe këdo që jep dije të dobishme!) më ka dërguar një studim të ri, të botuar në faqen e internetit të “Science News”, titulluar “From Dark Matter to Light”, në revistën *Astrophysical Journal*.

Ajo që më tërhoqi vëmendjen është se sot studiuesit janë të bindur se ka fije kozmike që mbajnë galaktikat dhe këto fije ndahen siç ndahen fijet e pëlhurës. Le të ndalemi për një çast dhe të mendojmë për këtë ajet: ***“A nuk e dinë ata, të cilët nuk besuan se qiejt e Toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato***



të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?” (El-Enbija: 30). Fjala arabe *retkan* ka kuptimin *qep, kap me pe, fetk* është e kundërta e *retkan* dhe ka kuptimin *ndaj, shqep*. Të dyja fjalët përdoren për të përshkruar pëlhurën ose tekstilin. Në përkthimin e Ibn Kethirit shpjegohet: *“A nuk e shohin ata se qiejt dhe Toka kanë qenë bashkuar, domethënë, në fillim, kanë qenë njësh, ngjitur njëri tek tjetri dhe njëri mbi tjetrin.”* Kështu, Ibn Kethiri kuptoi nga ajeti i mëparshëm se, në fillim të krijimit, universi (qiejt dhe Toka) ishte materie e ngjitur fort, një mbi një. Pastaj Allahu (që qoftë i Madhëruar!) i ndau dhe i veçoi. Duke lexuar studimin e mëparshëm, gjejmë se studiuesit e përshkruajnë saktë atë që ka thënë Ibn Kethiri. Ata thonë se në fillimin e krijimit, universi ishte si lëndë e endur, një mbi një dhe gjatë biliona vjetësh fijet e tij devijuan. Çuditërisht, ata e kapën këtë proces duke përdorur një superkompjuter dhe zbuluan me siguri se fijet kozmike ndahen gati njëloj siç ndahen fijet e pëlurës kur e grisim.

Pamja në kompjuter paraqet universin në fillimin e krijimit të tij (pas 450 milion vjetësh) si një lëndë fijeze në trajtën e një pëlure të endur ngjeshur (djathtas), pastaj fijet fillojnë të ndahen siç ndahet pëlhura. Pamja majtas paraqet universin pas 6000 milionë vjetësh krijimi. Shihni me vëmendje sesi zmadhohen hapsirat e errëta me kalimin e kohës dhe sesi veçohen fijet. Këto fije janë galaktikat. Allahu e di më së miri. Shikoni pamjen e djathtë, e cila ngjan me fijet kozmike dhe foton majtas që ngjan me këto fije pas një periudhe kohe. Dhe, vërehet se këto fije ndahen si një copë pëlure e grisur. Shkencëtarët vërejnë se galaktikat lëvizin përgjatë këtyre fijeve në drejtim të nyjave. Çdo pikë e ndritshme në këtë fotografi është një grup galaktikash. Mendojeni për një çast këtë lidhje kozmike mahnitëse!

Interpretimi i sotëm i ajetit:

Kur’ani ka zbritur 1400 vjet më parë. Megjithatë, deri më sot, myslimanët përpiqen t’i kuptojnë dhe t’i zbulojnë mrekullitë e tij. Kur’ani është plot me ajete që kanë të bëjnë me kozmologjinë. Ne, si myslimanë nuk duhet t’i lëmë jashtë vëmendjes sonë këto ajete, me pretendimin se nuk lejohet të interpretosh ajete sipas



teorive shkencore, sepse ne, si besimtarë jemi të urdhëruar të meditojmë edhe për ajetet kur'anore që përshkruajnë universin, ngaqë janë pjesë e Kur'anit.

Disa shkencëtarë e lidhnin ajetin e mëparshëm me teorinë e Big Bengut. Teoria e Big Bengut nuk është provuar ende, por ajo është më e mira teori deri tani që shpjegon formimin e universit. Ajo thotë se universi ishte një masë e vogël e cila shpërtheu dhe me kohë, formoi ato që sot janë yjet, galaktikat, Diellin, Hënën dhe Tokën.

Teoria e Big Bengut është pjesërisht e saktë, me parimin se universi ishte një masë e vetme dhe pjesëzat e saj u ndanë duke formuar galaktikat, yjet dhe planetet. Gabimi në këtë teori është se shpërthimi krijoi kaos dhe shkatërrim më shumë sesa sistemin e përkryer që ne shohim sot. Problemi i kësaj teorie është se ajo asnjëherë nuk e shpjegon nga erdhi masa fillestare, çfarë e shkaktoi shpërthimin ose si mundet një shpërthim i rastësishëm të krijonte një univers të organizuar saktë? Ja përse disa shkencëtarë e kanë pranuar këtë teori: pavarësisht nga të metat e saj, ajo është i vetmi shpjegim i mirë që ata patën. Por pas shumë zbulimesh, shkencëtarët nisën të flisnin për fije të mëdha të cilat ishin bashkuar dhe pastaj ishin ndarë në një sistem të saktë që konsiderohet një nga dukuritë më të mëdha kozmike. Kjo teori e re, e cila është më afër së vërtetës, mund të shihet. U zbuluan galaktika në tërë universin, pastaj informacioni u fut në një rrjet tredimensional duke përdorur një superkompjuter, për ta vendosur çdo galaktikë në vendin e saj të duhur. Për habinë e tyre, shkencëtarët panë fjetet e galaktikave që ndërthureshin dhe që ndaheshin gjatë biliona vjetësh.

Ne mund të arrijmë në përfundimin se fjetet e ngjeshura në fillimin e krijimit kozmik është bashkimi (*retk*) që specifikohet në ajet, kurse ndarja e përpiktë e këtyre fijeve është *fetku*. Kështu, kjo teori e shpjegon ajetin e mëparshëm saktë.

Si e kuptonte Ibn Abasi ajetin e mëparshëm? Ibn Abasi e interpreton ajetin vërtet, në mënyrë të shkëlqyer. Ai shpjegon: qielli (qiejt) ishin qepur dhe nuk binte shi, dhe Toka ishte qepur



dhe nuk nxirrte bimë. Pastaj, Allahu i ndau qiejt me shi dhe Tokën me bimë. Dhe, vërtet, është provuar shkencërisht se Toka në fillimin e krijimit, ishte e zjarrtë dhe nuk mugullonte. Atmosfera e Tokës nuk ishte formuar ende, prandaj nuk kishte shi. Kur u krijua atmosfera, nisën të formoheshin retë dhe filloi të binte shi; kështu që u rritën bimë pasi u ftoh Toka dhe pasi u formuan malet, lumenjtë dhe detet. Kjo tregon qartë madhësinë e Kur'anit, çka mund të kuptohet me zhvillimin e sotëm. Ne nuk gjejmë ndonjë kontradiktë në kuptimin e Librit të Allahut të Gjithëfuqishëm dhe kjo përmendet në Kur'an: ne jemi të urdhëruar të meditojmë për përsosurinë e tij. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë:

“A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenim në të shumë kundërthënie.” (En-Nisa: 82).

A ka ndonjë kontradiktë në Kur'an?

Le të ndalemi për një çast dhe të themi që nuk është problem nëse një komentues ka gabuar, kur ka shpjeguar një ajet, sepse Kur'ani është e vërteta absolute që nuk ndryshon, ndërsa komentimi është vetëm të kuptuarit njerëzor të ajetit. Meqë njerëzit ndryshojnë për nga niveli i dijes dhe meqë shkenca zhvillohet, duhet të përmirësohet komentimi i Kur'anit. Kjo nuk e fyen Kur'anin; përkundrazi, thekson se Kur'ani u përshtatet të gjitha kohëve meqë nuk ka asnjë libër tjetër që mund të shpjegohet logjikisht sipas shkencës, pavarësisht sesa shumë zhvillohet shkenca.

Me këtë që u tha, kjo është një përgjigje për njerëzit të cilët mohojnë mrekullitë shkencore me arsyen se mbrojnë Kur'anin. Gabime që bëhen nga njerëzit ka ende, por Kur'ani është gjithnjë i pagabueshëm. Nëse besimtari përpiqet dhe gabon, ai shpërblehet nga Allahu një herë (nëse ai ka qëllime të çiltra) dhe nëse është i drejtë, shpërblehet dy herë. Kjo provon që nuk ka asnjë kontradiktë në Kur'an, por ka interpretime dhe kuptime të ndryshme të teksteve kur'anore sepse Kur'ani ka zbritur për të gjithë njerëzit. Si një studiues në këtë fushë, unë them se kushdo që shpjegon mrekullitë shkencore, nuk na siguron se interpretimi shkencor i ajetit është e vërtetë absolute.



Kështu, unë besoj se shumica e autorëve në këtë fushë e dinë këtë dhe besojnë se studimet e tyre janë vetëm përpjekje të tyre dhe jo vetë Kur'ani. Kur'ani është absolut dhe i pandryshueshëm; dallimet në interpretime ndryshojnë me zhvillimin e shkencave. Kjo asnjëherë nuk e fyen Kur'anin. Kur'anin e fyejnë ata që kanë qëllime të këqija dhe gjurmojnë gabime të studiuesve për ta vënë në dyshim librin e Allahut. Kur'ani e përmend këtë tip njerëzish katërmëdhjetë shekuj më parë në këtë ajet të madh:

“Është Ai që ta zbriti Librin ty, në të cilin ka ajete të qarta, që janë bazë e Librit; e, ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). Por, ata, në zemrat e të cilëve ka anim nga e shtrembra, gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar hutim, megjithëse e kërkojnë komentimin e tyre. Por, përveç Allahut, askush nuk e di kuptimin e tyre të saktë. Dhe, ata që kanë dije me themel, thonë: ‘Ne i kemi besuar Librit; i gjithi është nga Zoti ynë. Dhe këtë askush nuk do ta rrokë Mesazhin përveçse ata që e kuptojnë’.”

(Alu Imran: 7).

Ndokush mund të thotë: Përse ka zbritur Allahu i Madhëruar ajete të ngjashme ose të paqarta? A dëshiron Ai që t'i largohemi të vërtetës? A nuk është kjo e padrejtë për njerëzit? Atëherë, përse i dënon Ai ata? Unë do t'u përgjigjesha atyre me një pyetje: A e njihni ju metodën më të fundit të provimeve në universitetet amerikane? Është metoda e zgjedhjes së shumëfishtë. Çdo pyetje ka disa zgjidhje alternative dhe studenti duhet të gjejë përgjigjen e vërtetë. Kjo e dallon studentin punëtor nga studenti përtac. Unë nuk pres që askush të thotë se mësuesit po i mashtrojnë studentët e tyre, edhe pse bëjnë çmos t'i ngatërrojnë ata me shumë përgjigje të gabuara.

Allahu i Madhëruar ka përcaktuar një rrugë shumë të qartë për ne dhe na ka kursyer mundin duke na zbritur Kur'anin që na urdhëron të ndjekim çfarë ka në të. Atëherë, a është kjo udhëheqje apo mosudhëheqje? Mashtrim do të thotë veprim i keq, vepër e keqe, Shejtani dhe lakmitë. Këto ekzistojnë. Dhe kështu, Allahu teston besimin dhe bindjen tonë ndaj Tij.



Çfarë bëjnë ateistët dhe jobesimtarët? “Ata ndjekin atë që nuk është krejtësisht e qartë dhe kërkojnë fitne dhe kuptime të fshehura.” Çfarë thonë besimtarët? “Ne besojmë në të: i gjithi (në ajetet e qarta dhe të paqarta) është nga Zoti ynë.”

Ja përse ajeti i mëposhtëm ka një dua (lutje) mahnitëse, të cilën duhet ta themi vazhdimisht. Allahu na jep përgjigjen e duhur se çfarë duhet të bëjmë dhe çfarë duhet të themi. Allahu i Madhëruar thotë: ***“Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, sepse vetëm Ti je dhuruesi i madh. Zoti ynë, Ti je Ai që në një ditë do t’i tubosh njerëzit, ditë për të cilën nuk ka dyshim. Allahu nuk e shkel premtimin e vet.”*** (Alu Imran: 8, 9).

Tani, pasi na ka udhëzuar Allahu në rrugën e drejtë, na ka mësuar çdo gjë që na duhet nëpërmjet Kur’anit të Shenjtë dhe Syneetit të Profetit, na ka ndaluar nga imoralitetet dhe veprimet e veprat e këqija, na ka paralajmëruar t’u ruhemi Shejtanit dhe metodave të tij dhe na ka dashur të jemi të mirë, - këto i konsiderojmë udhëheqje apo mosudhëheqje? Nëse një student në sallën e provimit e ka marrë përgjigjen e duhur nga pedagogu i tij, por ai ngulmon në përgjigjen e gabuar - si do ta konsideronim këtë? Kush e ka gabimin? Kush është i padrejtë? Është mësuesi i padrejtë ndaj studentit apo është studenti i padrejtë ndaj vetvetes? Kështu është Allahu i Gjithëfuqishëm. Ai dëshiron për ne lumturi dhe mirëqenie edhe në këtë botë, edhe në Botën Tjetër. O Zoti ynë! Mos na ndëshko për arsye të atyre që janë të padrejtë me vetet e tyre dhe na bëj ndër robtë e Tu të bindur dhe fitimtarë në këtë botë dhe në Botën Tjetër! ***“Zoti ynë, ne e besuam atë që e zbrite (Shpalljen), e pasuam të dërguarin (Isain), pra shënona bashkë me ata që dëshmojnë (besimin e drejtë)!”*** (Alu Imran: 53).¹

1. Burimi: <http://www.sciencenews.org/articles/20080322/bob.10.asp> Abdul Daem Al-Kaheel
www.kaheel17.com/eng
Burime literature:

1. <http://www.lanl.gov/abs/0802.3914>



II. Fakte të reja për piramidat: një mrekulli e re e Kur'anit

Zbulimi i fundit shkencor thotë si më poshtë: Studiuesit francezë dhe amerikanë pohojnë se gurë të stërmëdhenj që janë përdorur nga faraonët për të ndërtuar piramidat, janë veçse deltinë që është pjekur në temperatura të larta...

A do të vazhdojnë të mbijetojnë piramidat që ne njohim si një nga Shtatë Mrekullitë e botës? A kanë gjetur përgjigje shkencëtarët për misterin sesi u ndërtuan piramidat në Egjiptin e lashtë? A ka njerëz që ende besojnë se xhindet janë ndërtuesit e këtyre piramidave? A mund të besohet se piramidat e Egjiptit janë ndërtuar nga krijesa jashtëtokësore? Këto spekulime kanë mbushur botën për disa shekuj. Por, zbulimi i ri i shkencëtarëve francezë dhe amerikanë do ta ndryshojë mendimin e shkencëtarëve përgjithmonë. Ai do t'i japë gjithashtu, një shpjegim të thjeshtë shkencor misterit të ndërtimit të piramidave, por më e çuditshme është se ky mister është në Kur'an që katërmbëdhjetë shekuj më parë. Besohej se faraonët i kishin gdhendur gurët, por çështja është këtua: Si ka mundësi që të gjithë gurët janë kaq të puthitur, sa që njeriu nuk mund të gjejë asnjë boshllëk nga njëri gur te tjetri? Dhe, çfarë pajisjesh dhe daltash janë përdorur për të gdhendur gurët?

Deri tani, ato nuk janë gjetur. Ky zbulim vërtetëson se shkencëtarët gabuan kur menduan se piramidat ishin ndërtuar me gurë. Përgjigjia më e afërt për logjikën dhe të vërtetën është të thuhet se qytetërimi i faraonëve ishte ndërtuar mbi deltinë.

2. From Dark Matter to light, http://www.sciencenews.org/view/feature/id/9503/title/From_Dark_Matter_to_Light

3. How Filaments are Woven into the Cosmic Web. <http://arxiv.org/abs/astro-ph/9512141>

4. http://www.kva.se/KVA_Root/files/newspics/DOC_2005217592_1296017045_popcrafoord_05_eng.asp

5. PalleMoller, Johan Fynbo, Bjarne Thomsen, A Glimpse of the Very Early Universal Web, European Southern Observatory, 18 May 2001.



Fakte të reja shkencore:

Një nga faktet shkencore është se piramida e madhe me lartësi 146 metra qe ndërtesa më e lartë në botë në 4500 vjetët e fundit e deri në shekullin XIX. Teoria e re e propozuar nga profesori francez Zhozef Davidoviç, drejtori i Institutit të Gjeopolimerëve pohon se piramidat janë ndërtuar kryesisht prej balte dhe se deltina është përdorur si mjet për të lëvizur gurët në një hekurudhë speciale. Kërkimi shkencor sugjeron se dheu dhe materiale të tjera janë marrë nga toka e Nilit dhe janë vendosur në kallëpë guri të papërshekueshëm. Pastaj, janë pjekur në temperaturë të lartë, duke bërë që këto materiale të ndërveprojnë dhe të formojnë gurë si ata vullkanikë, të miliona vjetëve më parë. Shkencëtari Davidoviç pohon se gurët që janë përdorur për piramidat kanë qenë kryesisht gëlqerorë, deltinë dhe ujë. Provat e bëra duke përdorur nanoteknologjinë (degë e inxhinierisë që merret me sende më të vogla se 100 nanometra) kanë provuar se ka sasi të mëdha uji në këta shkëmbinj; sasi të tilla nuk ka në gurët natyrorë. Përveç kësaj, ka gjithashtu, qëndrueshmëri në strukturën e brendshme të gurëve e cila vërtetëson se është e paarsyeshme që gurët të jenë sjellë, pastaj, të jenë skalitur. Mundësia më realiste është që deltina të jetë derdhur në kallëpë për t'i bërë gurët njëloj, pikërisht si sot që i derdhim veglat plastike në shabllone e kështu, të gjitha janë krejt të barabarta dhe të njëjta.

Mikroskopi elektronik u përdor për të analizuar mostra të gurëve të piramidave. Rezultati qe më afër mendimit të prof. Davidoviçit: kristalet e kuarcit u dukën qartë si pasojë e pjekjes së baltës. Ai tha se nuk kemi gurë të tillë në natyrë dhe konfirmon se ata ishin bërë në kohën e faraonëve. Analiza me shkallën *Mini E* tregoi, gjithashtu, praninë e dioksidit të silikonit. Kjo është një provë tjetër se gurët nuk janë natyrorë.

Libri i famshëm i Davidoviçit, i titulluar “Ils ont bati les pyramides”, botuar në Francë më 2002, i ka zgjidhur të gjitha problemet dhe misteret që thuheshin për mënyrën si ishin ndërtuar piramidat. Veç kësaj, ai solli një trup të thjeshtë balte me ndërtim gjeometrik. Kjo ishte shumë bindëse për shumë studiues në këtë fushë të shkencës.



Disa studiues kanë theksuar se në kohët antike, janë përdorur furra për të bërë qeramika dhe shtatore. Zjarri është përdorur për të pjekur shtatoren prej deltime, përzier me metale dhe materiale natyrore. Shtatorja pijej në furrë derisa të ngurtësohej dhe të merrte trajtën e shkëmbit natyror. Shumë qytetërime e kanë përdorur deltinën e pjekur për të bërë gurët, shtatoret dhe veglat. Të gjitha studimet e konfirmojnë këtë metodë, përdorur nga faraonët për ndërtime të larta të tilla, si piramidat. Ata kanë bërë shina druri në trajtë spirale përreth piramidës, si tenda e rrushit, që rritet në trup dhe ngjitet deri në majë. Kërkime të tjera kanë arritur në të njëjtin përfundim. Analiza të tjera me rreze X provuan se kishte fluska ajri në mostrat e marra nga piramidat që ishin formuar gjatë derdhjes së baltës në kallëpë dhe avullimit të ujit nga balta. Për më tepër, fluskat nuk eksiztojnë në gurë natyrorë dhe kjo na jep të dhëna të reja se gurët janë bërë me deltinë dhe gurë gëlqerorë, 4700 vjet më parë.

Mario Kolepardi, profesor italian ka studiuar arkitekturën e piramidave dhe ka theksuar se faraonët kanë sjellë gëlqere të pashuar (ka pasur shumë gurë gëlqerorë në zonën e tyre), e kanë përzier atë me dhe normal. Pastaj, i kanë hedhur ujë nga lumi Nil dhe e kanë futur në zjarr në temperaturë deri në 900° C. Kjo nxehtësi i ka dhënë gurit fortësinë dhe trajtën e shkëmbit natyror. Kjo do të thotë se nuk ka qenë e mundimshme për punëtorët për t'i transportuar dhe ngritur gurët; gjithçka që duhej të bënin ata, ishte të bënin kallëpët, të hidhnin baltën në to duke e çuar nga poshtë - lart me govata të vogla. Çdo punëtor çonte govatën me baltë për të mbushur kallëpët. Pastaj, vinte procesi i pjekjes në zjarr derisa guri të merrte formë dhe të mos lëvizte, duke u siguruar kështu se nuk kishte asnjë boshllëk ndërmjet gurëve. Kjo metodë ka bërë që piramidat të jenë të sigurta për mijëra vjet. Të shikojmë dy gurë fqinjë të piramidës. Ne mund të vërejmë një hapësirë të vogël ovale midis tyre. Kjo është një provë se gurët janë derdhur nga balta në kallëp shkëmbi dhe kjo hapësirë është formuar gjatë derdhjes, jo si rezultat i erozionit. Kjo është origjinalja e këtyre gurëve.



Fakti shkencor përkon me Kur'anin pas gjithë këtyre fakteve, ne mund të arrijmë te ky përfundim, që është: teknika e përdorur në Kohën e Faraonëve për të bërë ndërtime masive të tilla si piramidat, është përdorur kryesisht balta normale që gjendej pranë lumit Nil. Kjo baltë është përzier me ujë, është hedhur në kallëpë dhe është pjekur në zjarr derisa është ngurtësuar dhe këta janë gurët që ne shohim sot. Kjo teknikë mbeti e fshehur si një sekret deri në vitin 1981, kur ky shkencëtar paraqiti teorinë e tij. Në vitin 2006, shkencëtarë të tjerë provuan vlefshmërinë e teorisë, përtej çdo dyshimi, me analizën laboratorike. Kjo teknikë ka qenë krejtësisht e panjohur në kohën e zbritjes së Kur'anit. Por, çfarë thotë Kur'ani? Le ta madhërojmë, vëllezërit e mi dhe motrat e mia Allahun, të Plotfuqishmin.

Pasi u bë faraoni shtypës, dhe e shpalli veten Zot të Egjiptit (!), çfarë i tha popullit të tij, shikoni këtë: ***“Fir’auni (Faraoni) tha: ‘O ju pari, unë nuk njoh ndonjë zot tjetër përveç meje.’”*** (El-Kasas: 38).

Sfida dhe arroganca e tij arriti deri në këtë skajshmëri. Megjithatë, faraoni nuk u ndal, ai donte të sfidonte fuqinë e Zotit dhe të ndërtonte një monument të lartë, që të ngjitej në të e të shikonte kush ishte Allahu i Plotfuqishëm. Prandaj, faraoni donte të provonte para popullit të tij, dhe atyre që ishin si ai se Musai (paqja qoftë mbi të!) nuk ishte i singërtë dhe se faraoni ishte i vetmi zot i universit (!).

Faraoni i kërkoi Hamanit, zëvendësit dhe bashkëpunëtorit të tij, të ndërtonte një monument gjigand që ta bindte popullin se Zoti nuk ekzistonte (!). Këtu faraoni iu kthye teknikës ndërtimore të asaj kohe: të pjekësh gurët për monumentin. Faraoni tha pas kësaj: ***“Atëherë, m’i piq o Haman (tullat) nga dheu dhe më ndërto një kullë të lartë që të arrij ta shoh Zotin e Musait sepse unë mendoj se vërtet ai është gënjeshtar.”***

(El-Kasas: 38).

Po cili ishte rezultati? Mendoni për fundin e faraonit, Hamanit dhe ushtarëve të tyre! Allahu i Gjithëfuqishëm thotë për këtë: ***“Dhe***



ashtu, ai dhe ushtria e tij u sollën në tokë me kryeneçësi ndaj së vërtetës dhe menduan se nuk do të ktheheshin te Ne. Prandaj, Ne e kapëm atë dhe ushtrinë e tij dhe e hodhëm në det. Shiko, pra sesi përfundojnë mizorët.”

(El-Kasas: 39, 40).

Dikush mund të pyesë: A është monumenti piramidë? Ne themi, jo gjithmonë. Monumenti është i lartë si një kullë ose si një fener deti. Allahu e ndëshkoi faraonin dhe e shkatërroi atë.

Allahu i Gjithëfuqishëm e shkatërroi edhe monumentin e tij që të jetë një shenjë për ata që do të vijnë pas tij. Monumenti që ai ndërtoi për të sfiduar Zotin është shkatërruar dhe nuk gjendet askund. Tregimi për faraonin dhe fundin e tij të zi thuhet në këtë ajet: ***“Dhe, Ne i shkatërruam tërësisht të gjitha veprat dhe ndërtesat e mëdha që i patën ngritur Fir’auni (Faraoni) dhe populli i tij.”*** (El-A’raf: 137).

Tashmë, disa gurë të shpërndarë andej - këtej janë gjetur të mbuluar nga rëra gjatë mijëra vjetësh.

Njëra nga tri piramidat në Giza është ende e mbuluar nga një shtresë balte në majë. Kjo shtresë është nga i njëjti gur që është përdorur në ndërtim, çka tregon se deltina është përdorur plotësisht në ndërtimin e piramidave. Kjo “teknologji faraonike” që, ndoshta sekret i fuqisë së qytetërimit faraonik dhe vazhdoi të mbetej sekret e të mos përmendej madje as në dorëshkrime dhe mbishkrime. Prandaj, Kur’ani na thotë për sekretet e fshehura që nuk mund të dihen përveçse nga Allahu dhe kjo është dëshmi e fuqishme se Kur’ani është Libri i Allahut.

Mrekullia:

1. Ky studiues dhe shumë studiues të tjerë konfirmojnë se deltina është materiali i ndërtimit të piramidave, dhe këto janë ndërtimet më të larta që njihen nga historia antike deri në historinë moderne. Të gjitha këto fakte vërtetësojnë se ajeti kur’anor është i vërtetë dhe në përputhje me shkencën dhe një nga ajetet e mrekullive shkencore.



2. Teknologjia e bërjes së gurëve nga balta duke përdorur nxehtësinë, nuk njihej në kohën e zbritjes së Kur'anit dhe profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk kishte asnjë njohuri për mënyrën e ndërtimit të piramidave. Për këtë arsye, ky ajet duhet të konsiderohet një zbulim i madh shkencor sepse ai bën lidhjen midis baltës dhe nxehtësisë si mjet ndërtimi në Kohën e Faraonëve. Ky fakt na bën me dije se ndërtimi në atë kohë mbështetej në këtë metodë. Ky fakt shkencor është njohur vetëm pak vjet më parë, duke përdorur teknologji të avancuar.

3. Kjo mrekulli është një dëshmi që tregon përputhshmëri të plotë midis Kur'anit dhe shkencës dhe vërtetësisë së asaj që ka thënë Allahu i Gjithëfuqishëm në Librin e Tij: ***“A nuk e përfillin ata me vëmendje Kur'anin?! Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenim në të shumë kundërthënie.”***

(En Nisa: 82). Ajeti është një përgjigje për ateistët që thonë se Kur'ani është shkruar nga Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Si mund ta dinte çështjen e piramidave, kaq larg nga koha e tij dhe kur ai nuk i kishte parë asnjëherë ato?

4. Faktet konfirmojnë se Piramida më e Madhe në Giza ose e ashtëquajtura piramida e Keopsit ka qenë ndërtesa më e lartë në Tokë për 4500 vjet. Ajo ishte një nga ndërtimet ose monumentet më të famshme të faraonit. Allahu i shkatërroi monumentet dhe ndërtimet e bëra nga faraoni, i cili pretendonte se ishte zot, kurse piramidat që qenë ndërtuar nga faraonët e tjerë, u ruajtën nga Allahu për të qenë një dëshmi e vërtetësisë së Librit të Allahut, të Gjithëfuqishmit.

5. Në ajetin “Dhe, Ne i shkatërruam plotësisht të gjitha veprat dhe ndërtimet e mëdha që i kishte ngritur Fir'auni (Faraoni) dhe populli i tij.” Shihni fjalën “kishte ngritur”. Ajo tregon teknikën e përdorur në Egjiptin e lashtë për të vendosur gurët njëri mbi tjetrin. Në fjalorin “*Al Kamus Al Mubit*” të gjuhës arabe gjejmë fjalën *ngre, ndërtoj*: ngre tendën e rrushit; ngre bimën në listelë; ngre shtëpinë. Përfundimi: fjala “ngre” ka kuptimin “vë drurin për të ngritur gurët”.



Kjo është ajo që thonë shkencëtarët dhe studiuesit sot: faraonët kanë përdorur skelë druri për të ngritur gurët duke u ngjitur në mënyrë spirale përgjatë ndërtesës, mu ashtu si rrushi që kacavaret për shtyllë. Allahu i Gjithëfuqishëm e ka përdorur fjalën “ngre, ndërtoj” për të treguar mekanizmin gjeometrik të ngritjes së ndërtesave dhe të monumenteve. Pjesa më e madhe e piramidave janë shkatërruar nga Allahu; janë lënë vetëm ato piramida që janë dëshmi e vërtetësisë së Kur'anit.

6. Kjo mrekulli është një përgjigje për ata që thonë se Profeti ynë më i madh, Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na i paska marrë shkencat dhe tregimet nga Bibla ose nga murgu Bahira ose nga prifti Uaraka bin Naufal, ngaqë ndërtimi teknik me baltë nuk përmendej në librin e shenjtë, Teuratin. Përkundrazi, kushdo që lexon Teuratin, vjen në përfundimin se gurët ishin sjellë nga vende larg piramidave dhe ishin natyrorë dhe jo prej dheu. Kjo është arsyeja që i ka penguar disa shkencëtarë perëndimorë ta njohin këtë zbulim shkencor.

7. Kërkimi shkencor i prof. Davidoviçit i ka zhvlerësuar të gjitha mëtimet (pretendimet) biblike (Teuratin) se mijëra punëtorë kanë punuar për shumë vjet në këto piramida. Ai zhvlerëson gjithashtu, idenë se gurët ishin sjellë nga vende të largëta për të ndërtuar piramidat. Prandaj, nga provat fizike del se tregimi i Teuratis është në kontradiktë me shkencën. Kjo do të thotë se ka një dallim të madh midis Teuratis dhe fakteve shkencore dhe kjo tregon se kopja e sotme e Teuratis është shkruar nga njerëzit dhe jo nga Allahu i Gjithëfuqishëm. Ky fakt vërtetësohet nga Kur'ani: ***“A nuk e përfillin ata me vëmendje Kur'anin?! Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenim në të shumë kundërthënie.”*** (En-Nisa: 82).

Ai tregon, gjithashtu se Kur'ani është nga Allahu i Gjithëfuqishëm sepse harmonizohet me shkencën.

Disa pyetje për ata që janë skeptikë për mesazhin e Islamit:

1. Si mund ta dinte profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se faraonët kishin ngritur ndërtesa të larta në kohën e tyre?!



Dhe, po ta kishte marrë informacionin nga Teurati, ai do të kishte arritur tek i njëjti informacion që përmendet në Teurat. Ku e mori idenë e arkitekturës?!

2. Si mund ta njihje profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) teknikën e përdorimit të deltinës në ndërtim në Kohën e Faraonëve?! Dhe, çfarë e bëri atë të fliste për çështje të tilla historike dhe metafizike meqë nuk do t'i sillte asgjë mesazhit të tij?! Në qoftë se na e paska shkruar Profeti Kur'anin (siç pretendojnë disa njerëz), atëherë, do të kishte qenë më mirë që ai të fliste për legjendat arabe që janë më afër njerëzve për ta pranuar Mesazhin e tij!

3. Si mund ta dinte profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se faraoni e kishte shpallur veten zot? Dhe që ai kishte ngritur monumente?! Dhe, si e paska mësuar se këto monumente qenkan shkatërruar dhe paskan mbetur vetëm rrënojat si një dëshmi për ekzistencën e tyre në të shkuarën?! Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: ***“Dhe, ato janë shtëpitë e tyre, në të cilat, pas tyre nuk ka banuar kush përveçse për pak kohë. Dhe, vërtet Ne kemi qenë trashgimtarët.”*** (El-Kasas: 58).

4. A është e mundur nëse profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ta ketë shkruar Kur'anin dhe ta ketë thënë një gjë të tillë: ***“A nuk udhëtojnë ata nëpër tokë dhe të shohin se cili ka qenë fundi i atyre që ishin para tyre? Ata ishin edhe më të fortë se këta, punuan tokën dhe e populluan më shumë se këta (paganët). Dhe, atyre u patën ardhur të dërguarit e vet me prova të qarta. S'ka dyshim se Allahu nuk u bëri padrejtësi atyre, por ata i bënë vetë padrejtësi vetes.”*** (Er-Rum: 9). Allahu i Plotfuqishëm na bën që t'i sodisim këto piramida dhe monumente të tjera të lashta për të kuptuar fuqinë e Tij dhe të ardhmen e njerëzve arrogantë që sfidojnë Allahun.

Këto fakte fizike, të pasqyruara në Kur'anin e Shenjtë të Allahut tregojnë vërtetësinë e këtij Libri, dhe njeriu mund të thotë: Teoria e ndërtimit të piramidave nga balta nuk ishte bërë fakt shkencor.



Atëherë, si e shpjegoni këtë teori me Kur'an? Unë them: kjo teori nuk ka ardhur nga askund, por është rezultat i analizave shkencore e laboratorike dhe nuk është në kontradiktë me realitetin. Ajo përputhet me Kur'anin. Sado që të zhvillohet shkenca, ajo do të zbulojë vetëm ato fakte që përputhen me Kur'anin. Këto fakte janë mjete për të parë mrekullitë e Allahut në librin e Tij. Ai ka thënë: ***“Ne do t’ua tregojmë atyre Argumentet Tona në univers dhe në vetet e tyre, derisa t’u bëhet e qartë se ky (Kur’ani) është e Vërteta. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për gjithçka?”*** (Fussilet: 53)²

2. Burime literature:

- 1- http://www.signonsandiego.com/uniontrib/2008508/news_1c08pyramid.html
- 2- http://www.signonsandiego.com/uniontrib/20080508/news_1c08pyramid.html
- 3- <http://www.davidovits.info/78/davidovits-pyramid-theory-worldwide>
- 4- <http://www.geopolymer.org/news/cutting-edge-analysis-proves-davidovits-pyramid-theory>
- 5- <http://www.timesonline.co.uk/article/0,,13509-2480751,00.html>
- 6- <http://www.nytimes.com/2006/12/01/science/science/01pyramid.html?ref=science>
- 7- <http://www.welt.de/data/2006/11/30/1129891.html>
- 8- http://www.livescience.com/history/070518_bts_barsoum_pyramids.html
- 9- <http://www.piramidasunca.ba/en/index.php/STONE-BLOCKS-FROM-THE-BOSNIAN-PYRAMIDS-ANALIZED-RESULT-ANCIENT-CONCRETE.html>
- 10- http://dsc.discovery.com/news/2006/12/08/pyramids_arc.html?category=archaeology&guid=20061208120000
- 11- <http://www.newscientist.com/channel/being-human/mg19225812.900-concrete-evidence-in-gizas-pyramids.html>
- 12- Herodotus, The Histories, Oxford University Press, 1998
- 13- Davidovits, J. and Morris, M, The Pyramids, Dorset Press, 1988
- 14- Pyramids were built with concrete rather than rocks, scientists claim, <http://www.timesonline.co.uk/tol/news/world/europe/article656117.ece>, December 1, 2006
- 15- Concrete evidence in Giza's pyramids, <http://www.newscientist.com/channel/being-human/mg19225812.900-concrete-evidence-in-gizas-pyramids.html>
- 16- http://dsc.discovery.com/news/2006/12/08/pyramids_arc.html?category=archaeology&guid=20061208120000
- 17- <http://www.materials.drexel.edu/Pyramids/>
- 18- MIT Class Explores Controversial Pyramid Theory with Scale Model,



III. Pa asnjë shtyllë që mund të shihet

A ka shtylla të padukshme që lidhin pjesët e universit, për të cilat flet ajeti kur'anor? A është e mundur që këto shtylla të jenë forca e rëndesës (gravitetit)? Le ta shikojmë.

Allahu i Plotfuqishëm thotë: ***“Allahu është Ai i Cili ngriti qiejt pa shtylla, që ju mund t'i shihni.”*** (Er-R'ad: 2).

Do të doja të ndalesha te fjala “shtyllat” e qiellit. Por çfarë është qielli? Qielli është gjithçka sipër nesh dhe shtrihet nga atmosfera deri te galaktika e fundit e universit. Kushdo që shikon qiellin nga jashtë universit vëren një fije të tendosur. Kjo fije është tërësia e blloqeve të qiellit, që janë galaktikat. Ky është një imazh i simuluar i universit, sikur ta shikonim nga jashtë. Ne shohim grupe galaktikash të vendosura në fije, sikur të ishin blloqe ndërtimi. Është forca e rëndesës që i lidh këto galaktika dhe që e kontrollojnë përhapjen e tyre me anë të këtij sistemi të mahnitshëm. Kjo provon madhësinë e Allahut, Krijuesit të gjithçkaje. Çdo fije shtrihet deri miliona vjet-dritë dhe qindra galaktika janë vendosur në këto fije. Të gjitha mbështeten në forcën e rëndesës, të cilën e ka krijuar Allahu për të siguruar koherencën e universit që të mos shkatërrohet ai. Në këtë ajet të shenjtë ka dy mrekulli.

Ato janë:

1- Nga ky ajet kuptojmë se Allahu e ka krijuar qiellin pa shtylla dhe kushdo që e shikon universin nga jashtë, vëren grupe

<http://www.azom.com/default.asp>, April 3rd, 2008.

19- <http://www.romanconcrete.com/index.htm>

20- <http://www.sciencedaily.com/releases/2006/12/061209122918.htm>

21- The Enigma of the Construction of the Giza Pyramids Solved?, Scientific British Laboratory, Daresbury, SRS Synchrotron Radiation Source, 2004.

22- http://www.boston.com/news/local/articles/2008/04/22/a_new_angle_on_pyramids/?page=1

23- <http://www.geopolymer.org/archaeology/pyramids/are-pyramids-made-out-of-concrete-1>

24- <http://www.geopolymer.org/archaeology/pyramids-2-the-evidences>

25- Barsoum, M. W., Ganguly, A. and Hug, G. Microstructural Evidence of Reconstituted Limestone Blocks in the Great Pyramids of Egypt, Journal of the American Ceramic Society 89 (12), 2006.



të stërmëdha galaktikash që lidhen me njëra - tjetrën dhe që lëvizin në sistem si një grup. Këto grupe galaktikash janë ngritur dhe vendosur në vendet e tyre të caktuara pa shtylla, por nga ligjet fizike të krijuara nga Allahu i Plotfuqishëm për vazhdimsinë e universit.

2- Ne mund ta kuptojmë ajetin në një mënyrë tjetër: ka shtylla, por të padukshme. Në ajetin “i ngriti qiejt pa shtylla që ju të mund t'i shihni”, ka një mrekulli: forca e rëndesës që ne nuk e shikojmë janë shtyllat e krijuara nga Allahu, pa të cilat, universi nuk mund të ekzistonte dhe galaktikat nuk do të ishin përhapur në këtë mënyrë. Sido që ta kuptojmë ajetin, ai mbetet një mrekulli e përhershme. Kjo do të thotë se ajeti është nga Allahu, i Urti dhe i Gjithëdituri. Allahu thotë: ***“(Ky është) një Libër, ajetet e të cilit janë radhitur (përsosurisht dhe njëherësh janë) shkoqitur me hollësi nga i Urti dhe i Gjithëdituri.”*** (Hud: 1).

Në librat e tjerë, që janë të një kohe me zbritjen e Kur'anit, ka pasur informacion të gabuar për kozmosin: për shembull, ka pasur një besim shumë të përhapur se Toka mbështetej mbi një breshkë, ose mbi një balenë, ose mbi një dem...! Askush nuk dinte për shtyllat e padukshme që lidhin pjesë të universit. Ato janë forca e rëndesës.³

IV. Prova rationale për mrekullitë shkencore në Kur'anin e Shenjtë

Shumë ngjarje kanë ndodhur përpara ateistëve dhe ata i kanë pranuar pa asnjë koment. Një nga këto ngjarje është ajo e Ebu Lehebit për të cilin Allahu i Plotfuqishëm thotë: ***“Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi! Dhe, ai i shkatërruar është. Atij nuk do t'i bëjnë dobi as pasuria e vet dhe as fëmijët e vet. Ai do të digjet në një Zjarr flakërues. Edhe e shoqja, ajo që bart dru (ferra)⁴. Në qafën e saj është një litar i trashë prej mesedi (fije palme).”*** (El-Mesed: 1-5).

3. Burimet: NASA

4. Gruaja e Ebu Lehebit sillte ferra dhe i zinte rrugën Profetit dhe shpifte për të. (shënim i përkthyesit)



Kur i Gjithëfuqishmi premtonte se Ebu Lehebi do të digjej në Zjarr sepse do të vdiste si ateist, në të vërtetë, ishte një sfidë për gjithë njerëzimin sepse kjo Sure zbriti në fillimin e Islamit dhe shumë vjet përpara se të vdiste Ebu Lehebi, dhe Ebu Lehebi e kishte dëgjuar këtë ajet shumë herë, por ai nuk kishte menduar të hynte në Islam. Po të kishte hyrë ai në Islam, e gjithë feja mund të përgënjeshtrohej. Por Ai që e tha këtë ajet nuk ishte njeri; Ai ishte Allahu i Cili di të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, ishte Ai që dinte në mënyrë të pakundërshtueshme se Ebu Lehebi nuk do t'i besonte kurrë profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Ebu Lehebi ishte xhaxhai i Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Po të kishte qenë Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) autor i Kur'anit (siç dëshirojnë të besojnë jobesimtarët dhe ateistët) Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) mund t'i kishte premtuar atij Xhenetin sepse e kishte të afërm. Por ishte Allahu i Madhëruar Ai që e kishte zbritur Kur'anin.

Një ngjarje tjetër të cilën na e thotë Allahu i Gjithëfuqishëm është dukuria mahnitëse kozmike e ndarjes së Hënës. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: ***“Ora (e katastrofës së përgjithshme) është afruar dhe Hëna është çarë (më dysh)”. Dhe, kur ata (idhujtarët) shikojnë ndonjë argument (mrekulli) zmbrapsen dhe thonë: ‘Kjo është magji e vazhdueshme!’ Ata përgënjeshtroan (ajetet e Allahut, Kur'anin) dhe ndoqën lakmitë e veta. Por çdo çështje do të zgjidhet.”*** (El-Kamer: 1-3).

Në të vërtetë, kur zbriti ky ajet, asnjë ateist dhe jobesimtar mekas nuk thoshte se Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte gënjeshtar; ata e pranonin atë që thoshte Profeti

5. Sipas llojit të veprave: veprat e mira të çojnë në Xhenet; veprat e këqija të çojnë në Xhehenem. *(shënim i përkthyesit)*

6. *Burimet:*

- NASA

- *Lecture for Sheikh Abdul Majid al Zindani*



sepse e panë me sytë e tyre çarjen e Hënës dhe jo vetëm në Mekë, por edhe në shumë vende të tjera. Jobesimtarët nuk thoshin që ai ishte gënjeshtar, por thoshin se ishte magji e vazhdueshme. Nga ana tjetër, në qoftë se besimtarët nuk do ta kishin parë këtë dukuri dhe nuk do t'i kishin dëgjuar ajetet për të, edhe ata mund të dyshonin për Profetin e tyre dhe për fenë islame. Por ata e panë ndodhinë me vetë sytë e tyre. Një provë tjetër që çarja e Hënës kishte ndodhur pa asnjë mëdyshje është se shokët e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e pyesnin atë për kuptimin e ajeteve të Kur'anit dhe për ngjarje të ndryshme që ndodhën gjatë 23 vjetëve të jetës së Profetit; por, ata nuk i patën bërë asnjë pyetje për çarjen e Hënës sepse e kishin parë vetë me sytë e tyre.⁷

E përktheu nga gjuha angleze: **Bledar Shehu**



7. Viti hënor kalendarik hixhrik ka 354.367 ditë (354 ditë, 8 orë, 48 minuta dhe 28.8 sekonda). Kjo është koha gjatë së cilës Hëna rrotullohet 12 herë rreth Tokës. Viti hënor hixhrik është 10.875 ditë më i shkurtër se viti diellor. Më 29.11.2011 është dita e parë e muajit Muharrem, muajit të parë të vitit 1433. (shënim i redaksisë)

Ajni Sinani

Hixhreti – ndryshim i rrjedhave të historisë

Abstrakt

Termi ***hixhret*** nënkupton shpërnguljen e myslimanëve të parë nga Meka, në të cilën ishte kërcënuar besimi dhe ekzistenca e tyre fizike, për në Jethrib/Medine, ku ideja e Islamit do të gjente terren të përshtatshëm. Myslimanët, së bashku me Pejgamberin, u detyruan të lënë vendlindjen, shtëpitë dhe gjithë pasurinë, për të ruajtur besimin dhe për të fituar lirinë. “Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në Tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t’i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (En-Nisa, 100).

Fjala hixhret-un në arabisht rrjedh nga folja *haxhere* që etimologjikisht do të thotë “shpërngulje, emigrim, largim”. Prandaj hixhreti ishte shpërngulje dhe largim nga shtëpitë, të afërmit dhe vendlindja duke braktisur gjithçka. Kjo ngase Allahu i madhërishëm e favorizoi shenjtërinë e fesë dhe imanit mbi çdo gjë tjetër. Për rrjedhojë, vendlindja, shtëpia, familja, pasuria, pozita dhe reputacioni nuk kanë vlerë në qoftë se besimi dhe feja vihen në rrezik.



Termi hixhret nënkupton shpërnguljen e myslimanëve të parë nga Meka, në të cilën ishte kërcënuar besimi dhe ekzistenca e tyre fizike, për në Jethrib/Medine, ku ideja e Islamit do të gjente terren të përshtatshëm. Myslimanët së bashku me Pejgamberin u detyruan të lënë vendlindjen, shtëpitë dhe gjithë pasurinë, për të ruajtur besimin dhe për të fituar lirinë: ***“Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në Tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”*** (En Nisa: 100).

Hixhreti zgjati tre muaj. Të fundit nga Meka u larguan Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), Ebu Bekri dhe më pas hazreti Aliu. Me shpërnguljen në Medinë ishte realizuar vetëm një pjesë e hixhretit, ngase hixhreti ishte emigrim dhe shpërngulje me qëllimin e kthimit. Me hixhretin u përmyll periudha e Mekës. Ajo, padyshim, përkundër të gjitha torturave dhe mundimeve, ishte shumë e rëndësishme për thirrjen islame sepse gjatë saj u forcua besimi i sahabëve dhe zbritën ajete dhe sure rreth besimit dhe moralit. Islami në periudhën e Mekës filloi dhe u trajtua si i huaj deri në përfundim të saj, por 8 vite më pas ai do të kthehej me ithtarët e tij triumfues. Prandaj, fillimi fillon nga Meka, sepse pa periudhën e Mekës nuk do të kishim periudhën e Medinës, pa muhaxhirët nuk do të kishim ensarët. Pa besim/iman, moral dhe durim ndaj sprovave nuk do të kishte ummet, shtet dhe fuqizi.

Takimet në Akaba

Në vitin e dhjetë të misionit të tij, Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) humbi Ebu Talibin dhe Hadixhen, dy persona të dashur dhe të rëndësishëm për të. Ebu Talibi ishte mbrojtës i tij kurse hz. Hadixheja ishte ajo që i ofronte përkrahje të vazhdueshme. Pas vdekjes së Ebu Talibit, agresiviteti i idhujtarëve ndaj Pejgmaberit do të shtoej gjithnjë e më shumë.



Kështu, në fillim të vitit të njëmbëdhjetë, Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e gjen veten në një mjedis shumë armiqësor. Jeta e besimtarëve dhe e Pejgamberit ishte në rrezik të vazhdueshëm dhe mundësia për t'i ftuar njerëzit në Islam ishte pothuajse zero.

Mu për këtë, Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) fillon të mendojë për largimin nga Meka. Takimet në Akaba me myslimanët e Medinës ishin përgatitje për shpërngulje dhe hixhret. Në takimin e parë, në vitin e njëmbëdhjetë, morën pjesë gjashtë persona nga Jethribi. Muhammedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dërgoi me ta sahabiun e ri Mus'ab ibn Umejrin që t'ua mësonte Islamin medinasve.

Në takimin e dytë në Akaba, në vitin e dymbëdhjetë, ishin prezent 12 persona, të cilat u zotuan për herë të parë para Pejgamberit për besnikëri ndaj tij. Në takimin e tretë, në qershor të vitit 622, ku u bë "betimi i madh", morën pjesë 73 burra dhe 2 gra.

Me këtë rast, myslimanët e Medinës u zotuan se do ta mbronin Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Pas takimit të tretë në Akaba, Pejgamberi i urdhëroi sahabët të fillojnë hixhretin për në Medinë.

Vendimi për ta vrarë Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Brenda rreth dy muajsh pas fillimit të hixhretit nga sahabët, politeistët e Mekës mbledhin parlamentin e tyre ku diskutojnë për t'i dhënë goditjen e fundit Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Muhammedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) sapo informohet nga Xhibrili për konspiracionin e idhujtarëve shkon menjëherë tek Ebu Bekri dhe i thotë atij të përgatisë devetë, pajisjet dhe çdo gjë tjetër që u nevojitet për udhëtim. Hazreti Aisha r.a. tregon se babai i saj kishte qarë nga gëzimi që ishte caktuar që ta shoqëronte Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) gjatë hixhretit.



Më pas Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kthehet në shtëpinë e tij dhe e informon Aliun r.a. për vendimin e mushrikëve të Mekës dhe për planifikimin e tij për t'u nisur për në Jethrib. Ai i jep Aliut mantelin e tij të gjelbër dhe i thotë që të qëndronte në shtratin e tij, në natën e 27-të të muajit Sefer (12 shtator 622) dhe i thotë të mos kishte frikë për shkak se mushrikët nuk do të mund ta lëndonin.

Largimi nga Meka

Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) duke dalë nga shtëpia e tij filloi të lexojë ajete nga surja **Ja Sin** dhe kur arrin te ajeti: ***“Ne kemi vënë pengesë para tyre dhe pas tyre e i kemi mbuluar, kështu që ata nuk shohin.”***

Allahu ia merr për një kohë të caktuar të parit të rinjve politeistë që ishin vendosur rreth shtëpisë. Muhammedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur u largua kaloi përmes tyre duke marrë një grusht me rërë dhe duke ua hedhur mbi kokë. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) shkoi në shtëpinë e Ebu Bekrit dhe menjëherë pasi i morën devetë u nisën jashtë Mekës. Ata qëllimisht nuk shkuan në veri drejt Jethribit, por u nisën nga jugu në drejtim të Jemenit që t'i shmangeshin ndjekjes së mekasve. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) duke u larguar nga Meka u kthye nga ajo dhe tha: “Ti je për mua toka më e dashur dhe sikur populli të mos më nxirrte nuk do të të lëshoja kurrë.”

Ata arritën me shpejtësi në kodrën Theur dhe u vendosën në shpellën e saj. Ata vendosën të qëndronin aty për një kohë, sepse Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e dinte se idhujtarët sapo të mësonin për largimin e tij do të dërgonin menjëherë njerëz në rrugët që çonin jashtë Mekës dhe sidomos atyre që të shpinin në drejtim të Jethribit.

Kurejshët ofruan një shpërblim prej njëqind devesh për ata që do ta gjenin Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe do ta kthenin atë në Mekë.



Për këtë flet Zoti në Kur'an (El-Enfal: 30).

I Lartësuar Allah deshi që Pejgamberin e Tij të fundit ta nderojë në mënyrë të veçantë dhe t'i japë atij një shenjë dhe ndihmë të drejtpërdrejtë. Në kohën kur idhujtarët po i afroheshin shpellës, Ebu Bekri u frikësua se mos po i zbulonin, por Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e qetësoi duke i thënë: “Mos u pikëllo, All-llahu është me ne!”. Edhe pse deri në mëngjes hyrja e shpellës kishte qenë tërësisht e zhveshur, fare afër saj mbinë disa kërcej të mëdhenj drize që mbyllën gjysmën e hyrjes. Kurse gjysma tjetër do të mbyllej nga një rrjetë e trashë merimange.

E gjithë kjo jepte përshtypjen e plotë se në shpellë nuk kishte hyrë ndonjë njeri apo kafshë për një kohë të gjatë, kështu që idhujtarët që ishin në ndjekje të Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) edhe pse u afruan nuk hynë për ta kontrolluar atë. Kujtimin e kësaj ngjarjeje të madhe Allahu e ka ruajtur për të gjithë brezat e myslimanëve deri në Ditën e Gjykimit, duke e përmendur në Kur'anin fisnik (Et-Teube: 40).

Në rrugën për Medinë atyre u priu një udhërrëfyes i shkathët i shkretëtirës që quhej Abdullah ibn Urejkit El Lejth. Ai ishte pagan, por ishte besnik dhe kishte rënë dakord për t'i çuar deri në Medinë, duke ndjekur një rrugë tjetër nga ajo që ndiqnin mushrikët e Mekës.

Arritja në Medinë

Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur arriti në Kuba, që ishte një fshat i afërt me Medinën, hodhi themelet e xhamisë. Ajo ishte xhamia e parë e ndërtuar nga Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që nga fillimi i shpalljes. Të premten në mëngjes, në fund të muajit shtator, më 622, Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) së bashku me Ebu Bekrin dhe Aliun, i cili tashmë kishte arritur, shkoi në qytetin oazë të Jethribit/Medinës. Gjëja e parë që bëri në Medinë ishte ndërtimi i xhamisë.



Kalimi në Medinë që i rëndësishëm për shumë arsye.

Atje myslimanët gjetën një mjedis shumë të favorshëm për përhapjen e shpejtë të fesë së Allahut. Ata formuan në këtë qytet shoqërinë islame. Aty Islami do të realizohet në praktikë si një sistem jete dhe shoqëria islame do të veprojë në përputhje me parimet e tij. Edhe ensarët i kishin pritur vëllezërit e tyre muhaxhirë në mënyrë të paparë. Çdo gjë që posedonin e vunë në dispozicion të tyre, kishin ndarë vëllazërisht me ta shtëpitë dhe të gjithë pronën që posedonin. Për t'i bërë lidhjet mes ensarëve dhe muhaxhirëve më të forta, Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) bëri vëllazërimin mes myslimanëve të Mekës dhe Medinës.

Në nivelin politik, Islami kreu një rilindje. Është e njohur se gjatë periudhës mekase ajetet dhe suret kur'anore ishin më shumë në fushën e besimit dhe moralit, kurse në Medinë zbritën suret dhe ajetet që përmbanin udhëzime praktike dhe rregulla ligjore. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të caktonte edhe të drejtat e qytetarëve të Medinës. Prandaj ai do të përpilonte kushtetutën e parë me shkrim në shtetit islam, e njohur si Karta e Medinës, në të cilën, për herë të parë në historinë e njerëzimit, do t'u jepeshin të drejtat pakicave kombëtare dhe fetare.

Kalendari hixhrik

Situata ekonomike, sociale dhe madje edhe politike e myslimanëve, pas ardhjes në Medinë, do të ndryshonte. Pas hixhretit, asgjë nuk do të ishte e njëjtë. Madje as në botë gjendja nuk do të ishte si më parë. Kjo, sepse hixhreti do të ndryshonte rrjedhën e historisë njerëzore drejt një drejtimi të ri dhe një botëkuptimi tjetër për jetën. Në një kohë shumë të shkurtër hartat gjeografike u ndryshuan, ranë perandoritë e mëdha dhe u formua shteti i ri i fuqishëm islam që dominoi botën.



Prandaj në vitin 638 të epokës së re, halifi i dytë, Umer ibn El Hatab, kur kishte filluar zgjerimin e shtetit islam, e përcaktoi hixhretin si fillimin e epokës myslimane. Që atëherë kalendari është rregulluar në mënyrë uniforme sipas hixhretit.⁸

Porositë e hixhretit

- Nga porositë e hixhretit është se të drejtuarit dhe lufta në rrugën e Allahut është një shenjë e qartë për kthimin nga e vërteta primordiale, drejtësia, shtëpia dhe atdheu, siç ishte kthimi i Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Mekë, në të vërtetën e Qabesë, të drejtës së sheriatit, në atdheun e dashurisë vëllazërore dhe në bashkësinë islamike. Ky ishte kthim në vetvete dhe në vlerat e identitetit.

- Hixhreti nuk ishte ikje nga rreziku, edhe pse rreziku ishte permanent dhe ishte një nga arsyet e tij, por, para së gjithash, ai u bë për të gjetur një mjedis tjetër, më produktiv dhe më të favorshëm për përhapjen dhe zgjerimin e Islamit.

- Hixhreti në emër të Allahut nënkupton braktisjen e çdo gjëje që Allahu nuk e do (*haram*) dhe bërjen e gjithë asaj që All-llahu e pëlqen dhe është i kënaqur. Hixhreti na bën të kuptojmë se një shoqëri mund të mbijetojë vetëm duke afirmuar vlerat e saj morale dhe fetare dhe se çdo gjë që kontribuon në degradimin e këtyre vlerave çon drejt shkatërrimit të saj.

- Hixhreti tek myslimanët ka kuptim të thellë në ndërgjegjen dhe fenë e tyre. Ai ka dalluar dhe ndarë në mes të drejtës dhe të gabuarës. Ai është emigrim drejt Zotit, largim nga shirku dhe nga kufri drejt Islamit. Ai paraqet kufirin ndarës mes mbeturinave të shoqërisë paraislamike dhe krijimit të shtetit islam në Medinë. Si rezultat i gjithë këtyre, duke filluar që nga emigrimi i Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nga Meka

8. Shih edhe në Kur'an: *Isai*, 2:87, 136, 253; 3:45, 52, 55, 59, 60, 84; 4:157-159, 163, 171, 172; 5:17, 18, 46, 72, 73, 75, 78, 110-116; 6:85; 9:30, 31, ; 12:13; 19:34; 33:7; 42:13; 43:57, 63; 57:27; 61:6, 14;



për në Jethrib, e cila më vonë u quajt Medinetun Nebijj (Medinja e Pejgamberit), filloi historia e hixhrit, apo takvimi (kalendari) hixhrik te myslimanët.

- Idhujtarët e Mekës, sikurse edhe këta të ditës së sotme, nuk deshën që myslimanët të bënë hixhretin, nuk deshën që ata të përqendroheshin në një vend dhe të ishin si një trup i vetëm. Por myslimanët u treguan të gatshëm për të emigruar nga Meka, sepse për ta Allahu ishte shumë më i dashur se vendlindja, shtëpia, familja dhe pasuria.

Prandaj secili mysliman duhet të shohë veten nëse e ka filluar emigrimin/hixhretin në drejtimin e duhur duke shpejtuar drejt Allahut, apo është duke shkuar drejt rrugës e cila e largon nga Ai. Fedale b. Ubejdi r.a. thotë se Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), në Haxhin e Lamtumirës, ka thënë: “Muhaxhir është ai që lë gabimet dhe mëkatet.”



Hajri Shehu

Ç'thotë Kur'ani për Isanë (paqja e Allahut qoftë mbi të!)

- i Dërguar, 2:253; 6:85; 19:130; 23:50; 33:7; 57:27;
- i Dërguar te pasardhësit e Israilit (Beni Israilët), 3:49-51;
- si Ademi, 3:59;
- rob i Allahut, 4:171;
- jo më shumë se i Dërguar, 4:171; 5:75; 43:59, 63, 64;
- Allahu e fuqizoi me shpirtin e shenjtë (Xhebrailin), 2:87, 253;
- nuk është Zot, 5:17, 75;
- nuk është biri i Zotit, 5:17; 9:30;
- ata që thonë kështu, janë femohues, 5:17, 72; 9:30;
- si shenjë e Zotit, 23:50; 43:61;
- lindja e tij, 3:45-47; 19:22, 33;
- nuk është kryqëzuar, 4:157, 158;
- është tek Allahu, 3:55;
- i zbreti Ungjilli, 4:163; 5:46, 78, 110; 19:30;
- zbret përpara Kijametit, 43:61;
- mrekullitë e tij, 3:49; 5:110; 19:30-33;
- vetëm me lejen e Allahut, 13:38;
- lutet për Tryezën e festës, 5:114, 118;
- nuk u mësoi të tjerëve adhurim të rremë, 5:116-118;
- hauarijunët kanë dhembshuri e mëshirë, 57:27;
- hauarijunët, ndihmëtarë në rrugën e Allahut, 61:14;
- hauarijunët e shpallin veten myslimanë, 5:111.
- jep lajmin e gëzuar për një të Dërguar me emrin Ahmed, që do të vinte, 61:6;
- myslimani e mbron Isanë, 3:42, 43, 59, 60, 199; 4:156-158, 172; 19:30-36; 21:91; 28:51-54; 43:59, 63, 64; 66:12. (*Shih edhe shënimet në S. 4:176; dhe S. 5:120*)

Drita e Kur'anit - Nr. 4 - 2011



Zbulime shkencore në një këndvështrim tjetër

Penicilina

Shumica e njerëzve mendojnë se zbulimet e mëdha janë rezultat i një pune të kujdesshme, të drejtuar të eksperimenteve të planifikuara e të lodhshme dhe i përfundimeve logjike. Zbulimi i penicilinës është shembulli më i spikatur që tregon të kundërtën. Megjithëse planifikimi, eksperimentimi dhe kërkimi kanë një rol të pamohueshëm në zbulimet shkencore, ngjarjet nuk formojnë gjithmonë një varg logjik dhe është pikërisht kjo që po përpiqemi të theksojmë. Gjatë Luftës së Parë Botërore, mjekët mbështeteshin në antiseptikët, për të mjekuar plagët e marra në luftë. A. Fleming, bakteriolog, vuri re se fenoli (ose acidi karbolik, antiseptiku më i përhapur në atë kohë), sillte më shumë dëm se sa dobi, sepse ai vriste leukocidet (qelizat e bardha të gjakut), më shpejt se sa vriste bakteriet dhe ai e dinte që kjo ishte e dëmshme, për arsye se leukocidet janë mbrojtësit natyralë të organizmit ndaj baktereve. Në 1922, kur po kalonte një të ftohur, Flemingu mblodhi sekrecionet e veta të hundës dhe pasi mikrobet u rritën në koloni, gjatë kohës që ai po shikonte kolonitë bakteriale ngjyrë ari, rastësisht mbi to ra një pikë loti. Ditën tjetër, kur po ekzaminonte kulturën bakteriale, ai pa një zonë të pastruar nga kolonitë, pikërisht aty ku kishte rënë pika e lotit. Flemingu konkludoi me të drejtë se loti përmbante një substancë, që mesa duket i zhdukte bakteriet me shpejtësi, por nuk dëmtonte qelizat e organizmit. Enzimën antibiotike që gjendej në lotë ai e quajti lisozinë.



Por, doli se vlera e saj praktike ishte e pakët, sepse mikrobet, që vriste lizozina ishin relativisht të padëmshme. Në verën e vitit 1928 Flemingu u angazhua me kërkime në fushën e gripit. Kur po kryente disa punë të përditshme laboratorike, duke ekzaminuar në miroskop kultura bakteriale të rritura në pjata petri (pjata të sheshta xhami të mbuluara me kapak), Flemingu vuri re një zonë të qartë, të pazakontë, ku nuk kishte më rritje. Ekzaminimi vuri në dukje se zona e pastër rrethohej nga një koloni myku, që ishte zhvilluar për shkak të ndotjes së rastësishme të ajrit, gjatë kohës që pjata kishte qenë e pa mbuluar. Duke kujtuar përvojën me lizozinën, Flemingu arriti në përfundimin se myku kishte prodhuar diçka që vriste stafilokokët e zhvilluar në pjatë.

Më vonë ai do thoshte: *“Ka me mijëra lloje myqesh dhe me mijëra lloje bakteresh dhe shansi që bëri të bjerë në kohën e dubur myku përkatës, në kulturën bakteriale të ndjeshme ndaj atij lloji myku, ishte një lloj si të fitosh llotarinë irlandeze.”* Fjalët e vetë Flemingut mjaftojnë për t’iu përgjigjur atyre që besojnë se zbulimet shkencore i dedikohen shansit apo shkencëtarëve idhuj.

Tefloni

Telefoni përdoret për prodhimin e shumë artikujve, duke filluar që nga tiganët që nuk ngjisin e deri te kostumet e kozmonautëve dhe valvulat artificial të zemrës. Tefloni ka gjetur zbatim në disa fusha. Zbulimi i tij u arrit nga një vëzhgim, në dukje “aksidental” i një kimisti të ri, R. Plunket, që punonte në laboratorët e firmës Dypon. Më 6 prill 1938 Plunket hapi një enë me tetraetilen gazor me shpresë që të përgatiste një ftohës johelmues prej kësaj lënde. Por, nga ena nuk doli fare gaz, gjë që e çuditi shumë Plunketin dhe ndihmësin e tij. Në vend që ta linte atë enë e të merrte një tjetër, për kërkimet e veta në fushën e ftohjes, Plunketi vendosi të shuante kureshtjen e tij për “enën e zbrazur”. Pasi përcatoi që valvula e enës nuk ishte e prishur, ai vështroi brenda saj. Atje, ai pa një pluhur si rrëshirë e bardhë dhe si kimist e kuptoi se çfarë mund të kishte ndodhur. Molekulat e tetraflouretilenit ishin kombinuar me njëra-tjetrën,



pra ishin polimerizuar në atë masë sa të formonin një trup të ngurtë. Pluhuri i bardhë në trajtë dylli kishte me të vërtetë veti të mrekullueshme: ishte më inert se rëra, mbi të nuk vepronin acidet e forta, bazat dhe nxehtësia, nuk kishte tretës që ta shpërbënte, por në dallim nga rëra, ai ishte shumë më i rrëshqitshëm.

Rrezet X (Röntgen)

Fizikani W. Röntgen zbuloi rrezet, që më vonë u emërtuan sipas emrit të tij, në mënyrë krejt të papritur dhe të paplanifikuar. Röntgeni po përsëriste eksperimentet e fizikanëve të tjerë, ku tensione elektrike të larta shkarkoheshin nëpërmjet ajrit ose gazeve të tjerë në tuba pjesërisht të boshatisur. Tani, ne e dimë se rrezet katodike janë tufa elektronesh, që lëshohen nga katoda dhe goditja e tyre pas faqeve të tubave të qelqit prodhon fosforeshencën e njohur. Në vitin 1892 u demonstrua që rrezet katodike mund të depërtojnë fletët e holla metalike. Tubat e shkarkimit, që kanë dritare të holla prej alumini lejonin rrezet katodike të dilnin nga tubi, ku ato mund të zbuloheshin nëpërmjet dritës, që prodhonin mbi një ekran me material fosforeshent (ekrane të tillë ishin përdorur, gjithashtu, për të zbuluar rrezet ultraviolet), por doli se atomet mund të përshkonin dy apo tre centimetra në ajër me presion të zakonshëm jashtë tubit me gaz të rralluar. Röntgeni i përsëriti disa nga këto eksperimente për të familjarizuar veten me këto teknika. Pastaj vendosi të shihte nëse mund të zbulonte rrezet katodike që dalin nga një tub bosh krejtësisht prej xhami. Domethënë nga një tub pa dritare, alumini të hollë. Askush nuk i kishte parë rrezet katodike në këto kushte. Röntgeni mendoi se arsyeja mund të ishte fosforeshenca e dobët e ekranit që vë në dukje rrezet. Për të përcaktuar efektshmërinë, ai errësoi dhomën dhe kyçi tensionin e lartë për ushqimin e tubit. I kënaqur me të vërtetë, ngaqë mbuloja e përdorur po e kryente funksionin e vet dhe nuk po e lejonte dritën fosforeshente të dilte, ai qe gati të çkyçte tensionin dhe të hapte ndriçimin e sallës për të vendosur ekranin fosforeshent në distancë të ndryshme nga tubi në boshllëk. Pikërisht në atë çast, ai vuri re një dritë të dobët,



që vezullonte në një pikë të dhomës së errësuar më tepër se një jard larg tubit katodik. Në fillim ai mendoi se mund të ishte një dalje drite e pashmangur nga mbuloja e kartonit dhe që mbase po pasqyrohej nga ndonjë pasqyrë në dhomë. Megjithatë, në dhomë nuk kishte pasqyrë. Duke ndezur me nxitim një shkrepëse, Röntgeni për habinë e tij të madhe, pa se burimi i kësaj drite misterioze ishte ekrani i vogël fosforeshent që ai kishte parashikuar ta përdorte si dedektor afër tubit katodik të mbuluar, por që ndodhej mbi tryezë, më tepër se një jard larg tubit (1 jard=91.44 cm). Röntgeni e kuptoi menjëherë se kishte zbuluar një dukuri të re. Nuk ishin rrezet katodike që kishin ndriçuar ekranin fluoreshent më tepër se një jard larg tubit. Me një aktivitet të ethshëm, ai iu kushtua tërësisht i përqendruar për disa javë studimit të këtij tipi të ri rrezatimi. Ai i raportoi rezultatet e veta në një artikull të botuar në Wunburg, më 28 dhjetor 1895, me titull “Një tip i ri rrezesh, komunikim paraprak”. Megjithëse në këtë artikull ai përshkoi me përpikëri shumicën e vetive cilësore të rrezeve të reja, fakti që ai nuk kishte kuptuar tërësisht natyrën e tyre, tregohej me emrin që ai zgjodhi për to, rreze X. Ai raportoi se rrezet e reja nuk ndikoheshin nga fusha magnetike siç ndodhte me rrezet katodike. Ato, jo vetëm që depërtonin më tepër se 1 jard në ajër, kundrejt 2 ose 3 inç si kufi për rrezet katodike, por gjithashtu, (duke cituar artikullin e tij): *“Të gjithë trupat janë të tejdukshëm për këto rreze, megjithëse në shkallë të ndryshme. Letra është shumë e tejdukshme: pas një libri me njëmijë faqe unë e pashë ekranin të ndriçojë shumë. Blloqe druri të trasha janë gjithashtu të tejdukshme. Një fletë alumini prej 15 mm e trashë, sido që e dobëson shumë veprimin, nuk e shuan plotësisht fluoreshencën. Në qoftë se dora mbahej ndërmjet tubit të shkarkimit dhe ekranit, hija më e errët e kockave shihej brenda hijes më pak të errët të vetë dorës.”* Ai konstatoi që madje mund të fiksohej imazhi i skeletit në një film fotografik. Kjo veti e rrezeve X e pushtoi menjëherë vëmendjen e botës mjekësore. Brenda një kohe shumë të shkurtër rrezet X u përdorën në praktikën e përditshme mjekësore për diagnostikim në spitalet e të gjithë botës.



Insulina

Vetëm në qoftë se ndonjë i afërm ose mik i juaji vuan nga diabeti, ju mund ta kuptoni se sa e rëndësishme është insulina për të. Si një nga ilaçet që përdoret për shumicën e diabetikëve sot, insulina u zbulua si një përgjigje e lutjeve të qindra e mijëra diabetikëve ndaj më të Mëshirshmit. Mbase, mjete lehtësuese dhe ilaçe më të mira, presin të zbulohen në një vend apo kohë të papritur. Më 1889, kur po studionin funksionin e pankreasit në tretjen e ushqimit, dy studiues hoqën pankreasin nga një qen. Pikërisht, ditën tjetër, një asistent laboratoriu u tërhoqi vëmendjen studiuesve për një tufë mizash të mbledhura rrotull urinës së qenit. Meqë u bënë kureshtarë pse ishin mbledhur mizat tek urina, ata e analizuan atë dhe konstatuan se ajo kishte përmbajtje të lartë sheqeri. Sheqeri në urinë është shenja e përgjithshme për të sëmurët me diabet. Studiuesit e kuptuan se po shihnin, për herë të parë, dëshminë e shkaktimit eksperimental të diabetit në një kafshë. Fakti që kjo kafshë nuk kishte pankreas, tregoi se duhej të kishte një lidhje ndërmjet këtij organi dhe diabetit. Më tej, studiuesit provuan që pankreasi prodhon një sekrecion që kontrollon përmbajtjen e sheqerit dhe që mungesa e tij shkakton çrregullim në metabolizmin e sheqerit dhe shfaqjen e simptomave të diabetit. Janë bërë shumë përpjekje për ta veçuar këtë sekrecion, por me pak sukses deri në vitin 1921. Një student kanadez i mjekësisë e nxori sekrecionin nga pankreasi i qenit. Kur ekstrakti injektohej në qentë, që ishin bërë diabetikë nga heqja e pankreasit, niveli i sheqerit në gjak tek ta normalizohej ose ulej dhe urina nuk përmbante më sheqer. Gjendja e përgjithshme e qenve, gjithashtu përmirësohej. Deri kohët e fundit, e gjithë insulina për trajtimin e të sëmurëve me diabet, merrej nga pankreasi i disa kafshëve. Si rezultat i inxhinierisë gjenetike, mbështetur në njohjen e mekanizmit të kontrollit të sintezës së proteinave nga ana e ADN-së, një firmë e madhe farmaceutike filloi të prodhojë insulinë njerëzore me anë të përdorimit të baktereve. Fakti që krijesa mikroskopike siç janë bakteret, mund të shfrytëzohen në të mirë të njerëzve, është një çështje shumë interesante



për një studim të veçantë. Sigurisht, këto nuk janë shembujt e vetëm “të zbulimeve të rastit të lumtur”, të përshtatshëm për t’u përmendur. Po paraqesim dhe disa shembuj të tjerë: zbulimi i strukturës molekulare të përbërjeve organike, i saharinës dhe zëvendësuesve të tjerë të sheqerit të zakonshëm, që përdoren për automobile dhe aeroplanë, i oksigjenit dhe i elementeve të tjerë kimikë, radioaktivitetit, zbulimeve astreonomike, si pulsarët, (yje që mund të zbulohen duke pulsuar radiovalë) dhe rrezatimi i mbetur nga Big-Bengu, shumë teorema matematikore, superpërçues të temperaturave të larta, ngjyruetit sintetikë etj.

A mund të quhen të gjitha këto zbulime të mrekullueshme thjesht “shanse të lumtura që vijnë papritur”? Unë besoj se ndërgjegjia njerëzore dhe arsyeja duhet t’i rezistojë një konceptimi të tillë. Sigurisht, çdo person me një gjykim të shëndoshë mund të thoshte: Unë falënderoj të Gjithëmëshirshmin që na ka dhënë mundësinë të bëjmë këto zbulime dhe na ka aftësuar për të përfituar nga këto zbulime që qëndrojnë mes mirësive të pafundme të Tij.



Shtegtimi

Abstrakt

Shtegtimi i shpendëve është një nga tiparet më impresionuese të sjelljes së kafshëve, përgjatë mijërave kilometrave pengesash ekologjike, siç janë oqeanet, malet dhe shkretëtirat. Shpendët e ruajnë dhjamin e trupit të tyre për ta përdorur si “karburant” gjatë shtegtimit. Ata fillojnë ta bëjnë këtë përpara fillimit të shtegtimit. Dhjami i depozituar në trupin e shpendit përbën llojin më ekonomik të karbuarntit, për shkak të energjisë së lartë oksiduese për njësinë e masës. Kur kafsha apo shpendi bëhet gati për shtegtim, mund t’i duhet të presë, deri sa të gjejë kushtet më të përshtatshme për fluturim.

Mendojeni veten sikur jeni pilot i një avioni të lehtë, që ka për detyrë të përshkojë për një ose dy muaj një udhëtim i cili zgjat nga 50 deri në 200 orë fluturim. Përfytyroni, gjithashtu, se erërat janë mesatarisht pesë herë më të fuqishme se zakonisht, kështu që ato do t’i pengojnë dhe do të pakësojnë shpejtësinë e fluturimit ose në të kundërtën, do ta rrisin atë. Temperaturat do të jenë të ulta dhe karburantin e nevojshëm do të mund ta gjeni me çmime të ndryshme gjatë udhëtimit tuaj. Detyra juaj është: ta kryeni këtë udhëtim me shpenzime sa më të vogla, pa u dëmtuar dhe në kohën e caktuar. Sigurisht, për këtë ju duhet të bëni shumë llogari para nisjes: Cila do të jetë shpejtësia më e përshtatshme dhe më ekonomike për fluturim? Si do të përshtatet ajo me erërat që do të ndeshni? Cila do jetë lartësia e fluturimit? Cila do të jetë pesha e karburantit rezervë që do të keni me vete? A do të ishte më mirë që fluturimi të bëhej “non-stop” (pa ndalesa) për një distancë të gjatë, pa u ulur për furnizim apo të udhëtohej duke mënjanuar shpenzimet që kërkon transporti i rezervave të mëdha të karburantit?



Për t'i zgjidhur këto probleme që ju dalin përpara, ju duhet të dini stacionet e mundshme të furnizimit gjatë udhëtimit, çmimin e karburantit, pagesat për shërbimet e aeroportit dhe sa do të vonoheni në çdo vend që do të uleni. Cila do të jetë rruga më optimale që do të zgjidhni? Ndoshta do të ndiqni rrugën direkte ose një rrugë që do t'ju lejojë të përfitoni nga erërat. Sigurisht që ju do të fluturoni në ato ditë, kur kushtet e kohës të jenë mundësisht sa më të përshtatshme. Por cila është kjo? Dhe si do ta gjeni ju se cilat kushte të motit janë më të përshtatshme? Cilat lartësi fluturimi do të preferoni për kushte të ndryshme të kohës? Në të njëjtën kohë, ju duhet të merrni parasysh edhe situatat e papritura që mund të ndeshni. Pra, siç shihet, pyetjet që dalin janë të shumta dhe ju do t'ju duhej një kohë e gjatë për mbledhjen e të dhënave dhe për të bërë llogaritë e nevojshme para se të arrini në një vendim të arsyeshëm për fluturimin që ju pret. Gjendja juaj, në këtë rast, është e njëjtë me atë të shpendëve shtegtarë. Strategjia e shtegtimin të shpendëve është një përzierje e harmonizuar e dëshirës së paepur dhe në të njëjtën kohë, e llogaritjeve për të siguruar një udhëtim sa më ekonomik dhe të sigurtë, megjithë numrin e madh të faktorëve që ndikojnë në të. Është me të vërtetë një fakt mahnitës, se ku e gjejnë ato aftësinë dhe mjeshtërinë për ta realizuar atë. Ka shumë kafshë, jo vetëm shpendë, që shtegtojnë sipas një rregulli të caktuar. Ja disa shembuj: elefantët e detit udhëtojnë çdo vit në një largësi prej rreth 21 mijë kilometra, nga Kalifornia në Gjirin e Alaskës, që përfaqëson edhe shtegtimin më të gjatë të gjitarëve. Miliona flutura "monarke" fluturojnë 2 deri në 3 mijë km, nga Kanadaja në Gjirin e Meksikës. Balenat gri, notojnë rreth 10 mijë kilometra nga Oqeani Arktik në Kaliforni dhe Meksikë. Në Braken Kejv, në Teksas të SHBA, grumbullohen çdo verë rreth 20 milionë lakuriqë nate.

Dhe që të gjithë janë femra. Ato lënë meshkujt, 1500 km më në jug, në Meksikë, dhe vijnë këtu për të lindur. Harengat shtegtojnë çdo vit dhe përshkojnë një largësi prej 3 mijë kilometrash. Bizonët, peshku salmon, ngjالات, gjithashtu shtegtojnë në largësi të mëdha.



Por këtu duam të ndalemi më shumë në shtegtimin e shpendëve, një nga tiparet më impresionuese të sjelljes së kafshëve, përgjatë mijërave kilometrave pengesash ekologjike, siç janë oqeanet, malet dhe shkretëtirat. Shpendët e ruajnë dhjamin e trupit të tyre për ta përdorur si “karburant” gjatë shtegtimit. Ata fillojnë ta bëjnë këtë përpara fillimit të shtegtimit. Dhjami i depozituar në trupin e shpendit përbën llojin më ekonomik të karbuarntit, për shkak të energjisë së lartë oksiduese për njësinë e masës. Kur kafsha apo shpendi bëhet gati për shtegtim, mund t’i duhet të presë, deri sa të gjejë kushtet më të përshtatshme për fluturim. Për të përcaktuar vendndodhjen mbi sipërfaqen e tokës, kafsha duhet të zotërojë disa sisteme të caktuara ndjeshmërie dhe disa programe vendimdhënëse mbi mënyrën e veprimeve që duhet të bëjë gjatë shtegtimit. Aftësia për të vendosur mbi drejtimin që duhet të marrë në disa kushte të caktuara ambientale quhet “orientim”. Orientimi i shpendit është sikurse ai i një njeriu që zotëron një busull dhe një udhëzues për ta përdorur në disa drejtime të caktuara. Kafshët mund të orientohen me anë të objekteve që ndodhen në sipërfaqen e tokës, diellit, yjeve, fushës magnetike tokësore, drejtimit të rrymave e kështu me radhë. Madje, ato mund të përdorin një ose më shumë nga këto burime informuese ambientale në çdo kohë ose të përdorin njërën nga ato, sipas kushteve që paraqiten. Shpendët përdorin lëvizjen e krahëve për të fluturuar në mënyrë të pandërprerë ose për t’u ngjitur lart. Shtegtimi i tyre nëpërmjet fluturimit ka tërhequr së tepërmi vëmendjen e shkencëtarëve për shkak të përqëndrimit spektakolar të këtyre shtegtarëve gjatë fluturimit. Shpendët shtegtarë bëjnë “dredhi” për t’iu shmangur fluturimit me krahë mbi det, prandaj dhe vendet më të njohura të kapërcimit të deteve nga shpendët që largohen ose vijnë në Evropë janë ngushticat si Gjibraltari, Bosfori, Falsterbo, që kërkojnë një fluturim të shkurtër mbi det. Kjo sjellje ndoshta është një strategji e tyre për të shfrytëzuar erërat dhe për të ruajtur energjitë. Për shkak të ndryshimeve në fërkim, erërat, zakonisht janë më të forta mbi det sesa në tokë. Shpendët shtegtar, në këtë mënyrë,



duke kaluar gjatë brigjeve, zvogëlojnë harxhimin e energjisë. Disa shpendë fluturojnë duke bërë udhëtime të shkurtra që zgjasin 3-10 orë. Ato mund të fluturojnë si ditën ashtu edhe natën, mjafton që moti të jetë i përshtatshëm për fluturim. Por ka disa lloje shpendësh që ndërmarrin fluturime “non-stop”. Për ta një fluturim pa ndërprerje nga Amerika e Veriut në atë të Jugut ose mbi Oqeanin Atlantik, në një distancë prej 3000-4000 kilometra është i zakonshëm. Disa rosa fluturojnë pa ndalesa rreth 4000 km përmes Oqeanit Paqësor, nga Gadishulli i Alaskës në brigjet jugore të Kalifornisë etj. Bletëngrënësit dhe falkojtë Amur udhëtojnë gati 3000 km mbi Oqeanin Indian në Afrikën Lindore. Shumë zogj shtegtarë fluturojnë mbi detin Mesdhe ose shkretëtirën e Saharasë vetëm me një fluturim “non-stop”, udhëtim që zgjat të paktën 40 orë, kur erërat janë të favorshme dhe 60 orë kur ato janë kundër. Disa lloje shpendësh fluturojnë nga Britania në Brazil, rreth 10.000 km pa u furnizuar. Temperaturat e ulta, me sa duket, nuk janë pengesë për zogjtë që shtegtojnë duke fluturuar në lartësi të mëdha. Zogjtë shtegtarë janë vënë re të fluturojnë në lartësi të tilla ku temperatura është -15°C (nën 15 gradë). Në vitin 1967, një kontrollues radari raportoi për një objekt fluturues në lartësinë 8-8.5 mijë metra. U njoftua një pilot që me avionin e tij t’i afrohej vendndodhjes së objektit. Kur avioni iu afrua, piloti raportoi se kishte të bënte me një tufë prej 30 mjelmash që fluturonin në një lartësi prej 8200 metra, ku temperatura ishte -48°C dhe frynin erëra të forta veriore. Me të vërtetë që këto vëzhgime janë mahnitëse. Dikush mund të pyesë nëse këto fluturime janë me të vërtetë të jashtëzakonshme apo këto shpendë shtegtojnë rregullisht në lartësi të tilla? Shpesh ne nuk arrijmë të kuptojmë dimensionet e fakteve të tilla. Dhjetëra mijëra zogj nisin fluturimin së bashku. Shumë prej tyre nuk kanë fluturuar ndonjëherë kaq larg dhe nuk kanë qenë në vendet ku po shkojnë. Por përsëri ata janë në gjendje të fluturojnë dhe të arrijnë në vendin e duhur. Nga e dinë ata se kur duhet të nisen? Si e njohin vendin? Si vendosin për drejtimin e rrugës që do të përshkojnë?



Si arrijnë ta dinë se ku ta gjejnë ushqimin që u duhet? Si mund të bashkëveprojë në mënyrë të tillë një turmë e madhe shpendësh? Si dhe ku kanë mësuar ato të përdorin si mjete orientimi gjatë shtegtimin të tyre diellin, yjet dhe fushën magnetike tokësore? Pyetje të tilla ka shumë dhe në shumicën e rasteve, nuk është e lehtë t'u përgjigjesh. Problemi bëhet më i komplikuar dhe më sfidues, po të merren parasysh edhe llojet e tjera të kafshëve shtegtuese. Qindra miliona kafshë shtegtojnë rregullisht dy herë në vit, duke përshkuar mijëra kilometra. Ne mund të bëjmë shumë pyetje me “si” dhe “pse” dhe të mos marrim përgjigjet e vërteta.

Referenca: Baidley, D. “Shtegtimi i Kafshëve”. Botim i Universitetit të Kembrixhit. Sparks, J. “Zbulimi i sjelljes së kafshëve”. Guild Publishing, Londër. (marrë nga revista “Burimi” nr.4, 1997)



Shumë gjumë dhe vdekje e papritur

Abstrakt

Një nga veprat e mëdha në Islam është falja natën sepse besimtari nuk fle shumë, ngaqë ai është i preokupuar për Jetën e Përtejme, kur do të qëndrojë përpara Allahut, Krijuesit. Por, vite më parë janë botuar disa studime që thonë se gjumi për një kohë të gjatë është i mirë dhe mund të jetë shkak për një jetë të gjatë. Studimet e reja kanë vërtetësuar se fjetja për shumë orë mund ta kufizojë jetën e njeriut. Sipas disa studimeve më të fundit shkencore amerikane, vërtetësohet se gratë që flenë shumë orë, janë të prirura për sëmundjet e zemrës më shumë se ato që nuk flenë kaq shumë. Një studim tjetër vërtetëson se ngritja natën e zgjat jetën.

Allahu i Plotfuqishëm na urdhëron të falemi natën (në pjesën e tretë të fundit të natës) meqë ajo konsiderohet lloji më i rëndësishëm i adhurimit të Allahut, të Vetmit Krijues. Cila është e reja për rëndësinë e zgjimit natën?

Për këtë jetë, Allahu thotë në Kur'anin e Shenjtë: “O njerëz! Jeta e kësaj bote nuk është asgjë tjetër veçse një gëzim kalimtar. Jeta e Përtejme është shtëpia që do të mbetet përgjithmonë.” (Gafir: 39) Kështu, çdo vepër që nuk bëhet për Allahun, vërtet, nuk vlen asgjë Ditën e Ringjalljes, kur asgjë nuk do t’i vlejë njeriut përveç asaj që është bërë për hir të Allahut.

Një nga veprat e mëdha në Islam është falja natën sepse besimtari nuk fle shumë, ngaqë ai është i preokupuar për Jetën e Përtejme, kur do të qëndrojë përpara Allahut, Krijuesit. Por, vite më parë janë botuar disa studime që thonë se gjumi për një kohë të gjatë është i mirë dhe mund të jetë shkak për një jetë të gjatë. Këtu, ka njëfarë kontradikte midis shkencës dhe Kur'anit. Si mund të kuptohen të dhënat shkencore, kur Allahu urdhëron ndryshe nga ajo që thotë shkenca?



Gjithmonë, duhet të dimë rregullën e artë: Kur'ani është gjithmonë i saktë, madje, edhe kur ka kontradiktë midis shkencës dhe Kur'anit sepse një ditë, saktësia e Kur'anit do të jetë e qartë për të gjithë njerëzit. Atëherë, ne kemi të drejtë të themi se e dhëna e mësipërme shkencore është e gabuar. Dhe, çfarë ka ndodhur në të vërtetë?

Studimet e reja kanë vërtetësuar se fjetja për shumë orë mund ta kufizojë jetën e njeriut. Sipas disa studimeve më të fundit shkencore amerikane, vërtetësohet se gratë që flenë shumë orë, janë të prirura për sëmundjet e zemrës më shumë se ato që nuk flenë kaq shumë. Një studim tjetër vërtetëson se ngritja natën e zgjat jetën. Sipas një reviste shkencore, është zbuluar se ka gjasë të madhe për goditje iskemike, deri në 70% ndërmjet grave që flenë natën 9 orë e lart. Studimi është bërë në rreth 93000 gra, nga 50-79 vjeç. Pas shtatë vjetësh studim, rezultoi se 1166 prej tyre patën goditje iskemike. Goditja iskemike ndalon oksigjenin të shkojë në tru, çka sjell vdekjen. Nga studimi doli, gjithashtu, se gjasa për goditje iskemike është 14% te gratë që flenë rreth 6 orë; 24% te gratë që flenë mbi 8 orë; 70% te gratë që flenë 9 orë.

I Madhëruar qoftë Allahu! A nuk është këtu urdhri islam, i thënë nga Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) 1400 vjet më parë? Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është një shembull i përsosur për myslimanët sepse ai ngrihej natën dhe falej për Allahun. Sot, mjekët dhe studiuesit na këshillojnë të bëjmë të tilla veprime. Por, dallimi midis asaj që thonë dhe bëjnë ata dhe asaj që themi dhe bëjmë ne, është se ata e thonë dhe e bëjnë për këtë jetë, kurse ne myslimanët e themi dhe e bëjmë për Allahun. Sa fe e madhe është!

Atëherë, vëllezërit e mi dhe motrat e mia, ne duhet të pasojmë udhëheqësinë e Profetit tonë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) sepse është adhurim i madh për Allahun e Gjithëfuqishëm të ngrihesh natën dhe të falesh. Profeti ynë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka thënë se falja në fund të natës është më e mirë se e gjithë bota.



Kontribute të teknologjisë islame

Abstrakt

Përveç ndikimit pozitiv të ideologjisë islame si fe, Islami arriti një ndikim të pasqorë në historinë njerëzore. Ai bashkoi qytetërimet e popujt e një territori të gjerë, që shtrihet nga kufijtë e Kinës e deri në Oqeanin Atlantik. Kjo zonë përfshinte vendet e atyre qytetërimeve të lashta, të cilat u bënë djepi i qytetërimeve të mëvonshme në Lindjen e Afërme, si për shembull qytetërimi helen. I gjithë ky territor, gjatë shekujve të parë të Islamit, mbeti nën një qeverisje. Gjatë shekullit të 6-të sipas Hixhrit, (shek. 12 e.s.) shkrimet e dijetarëve të tillë si Farabiu, Gazali, Fargani (Afragamus), Ibn Sina (Avicena) dhe Ibn Ruzhdiu (Averoes) u përkthyen në latinisht dhe u bënë të njohura e u çmuan në Perëndim. Punimet e Aristotelit, që shpejt patën një ndikim parësor në mendimin evropian u përkthyen nga arabishtja së bashku me komentimet e Ibn Sinës dhe Ibn Ruzhdiut, për evropianët e kohës së Mesjetës. Në ndikimin e Islamit dhe të gjuhës arabe, shkenca dhe teknologjia e këtyre zonave u zhvillua e u përmirësua.

“Me të vërtetë, jeta e kësaj bote i shëmbëllen shiut që Ne e lëshojmë nga qielli e me të përzihet toka dhe bën bimë, me të cilat ushqehen njerëzit dhe kafshët. E, kur Toka vishet dhe zbukurohet dhe, kur banorët e saj mendojnë se janë zotërues të saj (për ta vjelur a korrur), iu vjen urdhri ynë, natën ose ditën dhe Ne e bëjmë atë si të ishte e korrur, thuajse nuk kishte lulëzuar të djeshmen. Kështu, Ne ua shpjegojmë shpalljet Tona njerëzve që mendojnë.”

(Junus, 24)



Teknologjia është një tregues i qytetërimit dhe përderisa qytetërimi islam ka qenë për shekuj me radhë një forcë drejtuese në botë, atëherë ai duhet të ketë qenë i mbështetur në arritje të rëndësishme teknologjike. Lulëzimi i shkencës dhe i kulturës në qytetërimin islam ishte rrjedhojë e rritjes së vazhdueshme të nivelit të jetës materiale në qytetet e tij. Mirëqenia materiale, industrinë e ndryshme, tregtia lokale e ndërkombëtare dhe shkenca e kultura në lulëzim në këto qytete, ishin të gjitha të lidhura bashkë dhe nuk do të mund të ekzistonin pa një teknologji të zhvilluar. Në qoftë se Islami ishte forca që qëndronte prapa ngritjes së qyteteve siç vërtetohet shpesh, atëherë Islami ishte, gjithashtu, forca që qëndronte prapa tërë aspekteve të mirëqenies së qyteteve dhe të përpjekjeve teknologjike që e shoqëronin atë.

Përveç ndikimit pozitiv të ideologjisë islame si fe, Islami arriti një ndikim të pashoq në historinë njerëzore. Ai bashkoi qytetërimet e popujt e një territori të gjerë, që shtrihet nga kufijtë e Kinës e deri në Oqeanin Atlantik. Kjo zonë përfshinte vendet e atyre qytetërimeve të lashta, të cilat u bënë djepi i qytetërimeve të mëvonshme në Lindjen e Afërme, si për shembull qytetërimi helen. I gjithë ky territor, gjatë shekujve të parë të Islamit, mbeti nën një qeverisje. Për më tepër, madje dhe pas lindjes së dinastive të ndryshme, kjo zonë përfitoi nga njësimi kulturor që solli Islami. Islami hoqi pengesat, që i kishin veçuar këto vende nga njëri-tjetri, kështu që i gjithë vendi kishte një traditë fetare dhe një gjuhë letrare e shkencore. Njësimi kulturor siguroi, gjithashtu, tregti dhe kalim të lirë nga Kina në Lindje, deri në Spanjë në Perëndim. Shkencëtarë dhe shkrimtarë ishin të lirë të udhëtonin nga një vend në tjetrin, duke përshkuar largësi të mëdha, për të komunikuar me dijetarë të tjerë. Për më tepër, sido që Umejadët në Spanjë nuk e njihnin Kalifatin Abasid të Bagdatit, ekzistonin lidhje të vazhdueshme ndërmjet Spanjës dhe territoreve të tjera të Lindjes që ishin nën qeverisjen islame.



Kalimi i teknologjisë

Pikëpamja tradicionale e historianëve perëndimorë është se kultura europiane është pasardhëse e drejtpërdrejtë e qytetërimeve klasike të Greqisë dhe të Romës. Sipas kësaj pikëpamjeje, punimet e autorëve klasikë, më të shumtat në latinisht, por edhe disa në greqisht, janë ruajtur nga Kisha gjatë shekujve, që pasuan rënien e Perandorisë Romake, për të ridalë një ditë, si një forcë e madhe frymëzimi, në Mesjetën e Vonë dhe në epokën e Rilindjes. Të paktë janë ata që mund ta mohojnë ndikimin e madh të letërsisë klasike me mendimin europian. Deri kohët e fundit, punimet e Homerit, Turqiditit dhe dramaturgëve grekë, Tacidit, Virgjilit dhe Horacit, pa përmendur të tjerë, bënë pjesë në themelin kulturor të çdo europiani të shkolluar. Megjithatë, në shkencë situata është krejt ndryshe. Gjatë shekullit të 6-të sipas Hixhrit, (shek. 12 i erës sonë) shkrimet e dijetarëve të tillë si Farabiu, Gazali, Fargani (Afragamus), Ibn Sina (Avicena) dhe Ibn Ruzhdiu (Averoes) u përkthyen në latinisht dhe u bënë të njohura e u çmuan në Perëndim. Punimet e Aristotelit, që shpejt patën një ndikim parësor në mendimin europian, u përkthyen nga arabishtja së bashku me komentimet e Ibn Sinës dhe Ibn Ruzhdiut, për europianët e kohës së Mesjetës. Këto komente ishin po aq të rëndësishme, sa dhe vetë vepra e Aristotelit për formimin e mendimit shkencor dhe filozofik europian. Shumë punime të tjera shkencore, që fillimisht ishin përkthyer nga greqishtja në arabisht në shekujt e mëparshëm, tani u përkthyen në latinisht. Megjithatë, shumica qenë të periudhës helene dhe, sido që ishin shkruar greqisht, autorët e tyre patën ardhur nga të gjitha vendet e Lindjes së Afërme dhe ato të Mesdheut Lindor. Del pra, se disa shkrimtarë europianë që çmonin kryeveprat letrare të Greqisë dhe të Romës, u priren për të besuar se qytetërimi perëndimor, në të gjithë aspektet e tij, ishte mbështetur në themelet greke dhe romake. Nuk është kështu përse i përket shkencës dhe teknologjisë. Çarls Singer ka trajtuar disa nga çështjet që tashmë i kemi prekur. Trashëgimia greko-romake që ndërtuar mbi



qytetërimet e mëdha të Lindjes së Afërme dhe për më tepër, arritjet kryesore në shkencë dhe teknologji, të cilat janë quajtur helene dhe romake, qenë kryesisht arritje të Lindjes së Afërme, rrjedhojë e punës së dijetarëve dhe artizanëve të Egjiptit dhe Sirisë. Edhe qytetërimet paraislamike, që nga Spanja deri në Azinë Qendrore dhe Indinë Veriore, u trashëguan nga Islami. Nën ndikimin e Islamit dhe të gjuhës arabe, shkenca dhe teknologjia e këtyre zonave u zhvillua e u përmirësua. Duke iu referuar eurocentrizmit të historianëve perëndimorë, Singer shkroi: *“Megjithatë, Europa nuk është veçse një gadishull i vogël, që zgjatet nga territoret e gjera të Afroazisë. Ky është vërtet statusi i saj gjeografik dhe, të paktën, deri në shekullin e 13-të të e.s. ka qenë përgjithësisht dhe statusi i saj teknologjik.”* Përsa i përket talentit dhe aftësive për shpikje, në pjesën më të madhe të periudhës, nga viti 500 deri në vitin 1500 të e.s., Singer vazhdon: *“Lindja e Afërt ishte superiore ndaj Perëndimit... Potbujse për të gjitha degët e teknologjisë, produktet më të mira që përdoreshin në Perëndim ishin ato që prodhoheshin në Lindjen e Afërt... Teknologjikisht, Perëndimi kishte pak gjëra për të çuar në Lindje. Lëvizja e teknologjisë ishte në drejtim të kundërt.”* Tani do të përshkruajmë se si ka ndodhur kalimi i teknologjisë (shih. S. Çarls, etj. *“Një histori e teknologjisë”*, 8 vëllime, Oksford 1954) dhe do të japim disa shembuj të kalimit të ideve dhe teknikave nga bota islame në Perëndim. Marrja e teknikave të botës islame nga Europa pasqyrohet në shumë fjalë që kanë prejardhje arabe dhe që janë futur në fjalorët e gjuhëve europiane. Në anglisht, këto fjalë, në shumicën e rasteve, por jo gjithmonë, kanë hyrë nga italishtja dhe spanjishtja. Po japim vetëm disa shembuj: **në tekstil:** muslin, sarsanet, damask, tafta, tabi; **në detari:** arsenal, admiral; **në teknologjinë kimike:** alembik, alkool, alkali; **në teknologjinë e letrës:** ream; **në ushqim:** alfalfa, sheqer, shurup, sherbet; **në ngjyrosje:** saffron, kermes; **në punimin e lëkurës:** kordovan dhe maroko. Siç mund të pritet, spanjishtja është veçanërisht e pasur me fjalë me origjinë arabe, sidomos në fushën e bujqësisë dhe ujitjes. Përdoret për shembull: *tabona* për mulli, *acena* për mulli ose rrotë uji; *acequia* për kanal ujitës. Në Mesjetën e Vonë, shumë punime



arabe mbi çështje shkencore u përkthyen latinisht. Zyra e përkthimeve në Toledo, në shekullin e 12-të ku qindra punime të tilla qenë përkthyer në latinisht, është një shembull i qartë i kësaj veprimtarie. Për fat të keq, nuk kishte asgjë të krahasueshme në fushën e teknologjisë, në të cilën punimet e drejtpërdrejta nga arabishtja ishin shumë të rralla. Rreth vitit 1277 të e.s., në oborrin mbretëror të Alfonsit X të Kastiljes, nën drejtimin e vetë mbretit, me objektivin e qartë për t'i bërë të ditura njohuritë arabe për lexuesit spanjollë, u hartua në spanjisht një vepër e titulluar *Libros del Saber de Astronomia*. Vepra përmbante një kapitull për matjen e kohës, që tregonte për një lloj ore me pasha, me një aparat me zhivë që rregullon lëvizjen. Nga burime të tjera, dimë se orë të tilla janë ndërtuar nga myslimanët në shekullin e 11-të të erës sonë, domethënë rreth 250 vjet përpara se sa orë të tilla të shfaqeshin në Europë. Rreth vitit 1277 të erës sonë, sekretet e metodës siriane të përgatitjes së xhamit iu dhanë Venedikut, sipas një marrëveshjeje të bërë ndërmjet Bohemundit të VII, princi titullar i Antiokës dhe Doges së Venedikut. Shembuj të tillë, të kalimit të drejtpërdrejtë të teknologjisë, janë akoma relativisht të rrallë, por pa dyshim që me kërkime të mëtejshme do të dalin në dritë dhe shembuj të tjerë. Tani për tani, mund të tregojmë disa pika në hapësirë dhe kohë, ku ka ndodhur shkëmbimi i ideve. Marrëdhëniet midis Europës kristiane dhe Botës Islame nuk kanë qenë gjithmonë armiqësore. Drejtuesit myslimanë shpesh kanë qenë njerëz të ditur dhe tolerantë ndaj shtetasve të tyre kristianë, qëndrim ky i edukuar tek ata në saje të mësimave të Kur'anit. Për më tepër, arsyet tregtare bënë të mundur krijimin e bashkësive të tregtarëve europianë të vendosur në Bizant, ku ata hynin në lidhje me tregëtarë shëtitës suedezë, që bënë rrugën përgjatë lumit Dnieper. Lidhje të ngushta pati veçanërisht, ndërmjet Egjiptit dhe Fatimidëve dhe qytetit italian Amalfi në shekujt e katërt dhe të pestë sipas Hixhrit, (shekujt 10 e 11 të erës sonë). Kështu, harku i mprehtë gotik, element thelbësor i arkitekturës gotike, u fut në Europë nëpërmjet Amalfit. Kisha e parë që aplikoi këto harqe u ndërtua në Monte Kazino



në vitin 1071 të erës sonë. Disa historianë mendojnë se ndikimi i kryqëzatave në kulturën europiane ndoshta ka qenë i ekzagjeruar, por transmetim me siguri ka pasur, siç u përmend në rastin e teknologjisë siriane për prodhimin e qelqit. Megjithatë, pa asnjë dyshim, shkëmbimet më të mëdha e më të frytshme ndodhën në Gadishullin Iberik, ku për shumë shekuj regjimi, përgjithësisht tolerant i Kalifëve dhe i pasardhësve të tyre lejoi zhvillimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve. Veprimtaritë e myslimanëve në bujqësi, ujitje, inxhinieri hidraulike dhe manifakturë ishin pjesë përbërëse e jetës së përditshme në pjesën jugore të këtij gadishulli dhe kjo përvojë kaloi nga Spanja në Itali dhe më tej në Europën Veriore. Këto transmetime nuk u frenuan nga Rekonkuista (ripushtimi nga kristianët). Në të vërtetë, mbase edhe u përshpejtuan, duke qenë se kristianët i morën instalimet myslimane dhe i mbajtën ato në gjendje pune gjatë shekujve të mëvonshëm. Sistemet myslimane të ujitjes me punimet e tyre shoqëruese hidraulike dhe makinat e ngritjes së ujit, mbetën baza e bujqësisë spanjolle dhe më vonë iu kaluan dhe Botës së Re. Instalime të tjera dhe pajisje industriale, si fabrika e letrës në Jativa afër Valencias, kaluan në duart e kristianëve. Dy orë uji të mëdha në brigjet e Tagos në Toledo, u gjetën nga kristianët dhe vazhduan të punojnë, të paktën dhe për 50 vjet të tjera. Këto pak shembuj duhet të mjaftojnë si tregues të kalimit të ideve myslimane në Europë. Kontributet e qytetërimit islam në shkencë, veçanërisht në matematikë e astronomi, janë të njohura prej kohësh. Megjithatë, aplikimi i kësaj ekspertize shkencore në teknologji është neglizhuar. Historia e zhvillimit të teknologjisë islame ka akoma shumë për t'u plotësuar. Kërkimi në këtë fushë është akoma në fazë fillestare dhe pavarësisht se çfarë është botuar deri tani kontributet e Islamit në shkencë e teknologji ende nuk janë zbuluar plotësisht. Gjatë shekullit të 19-të dhe çerekut të parë të shekullit të 20-të, hulumtimi perëndimor në shkencat islame dha rezultate të dukshme. Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, ky interesim është rigjallëruar. Por ende është e nevojshme të bëhen kërkime plotësuese,



të bashkërenduara, nëse kërkohet të arrihen përfundime të rëndësishme. Fusha e kimisë është një rast me vlera të veçanta. Deri tani kjo është një fushë pothuaj e pashkelur, për të cilën të paktë kanë qenë ata që kanë treguar interes, qysh prej kërkimeve të admirueshme, disa dekada më parë, të kryera nga Kraus, Ruska, Stapleton dhe Wiedeman.



Aliaa Ibrahim DAKROURY^{1*}

Një qasje filozofike për hermeneutikën e Kur'anit

Abstrakt

Termi hermeneutikë rrjedh nga latinishtja hermeneuin ose hermeneutika, që do të thotë “procesi i ndërmjetësimit zhvillohet nga kuptimi i jashtëm në atë të brendshëm.” Gjatë këtyre rreshtave, njeriu mund ta shohë hermeneutikën jo vetëm si të përkthyerit ose të shprehurit e një kuptimi, por më tepër si një shpjellim dhe interpretim i shpirtit dhe kuptimit të brendshëm të një teksti të caktuar. Në përgjithësi, përmbajtja e Kur'anit mund të klasifikohet në tre tema kryesore: “mesazhi doktrinar,” i cili ndërton kufijtë etikë dhe moralë të marrëdhënies njerëzore (kjo temë është interpretuar si Shariab-Sheriati (ligji islam); “tregimet historike,” të cilat i referohen historive të profetëve, popujve, vendeve të ndryshme dhe materialeve të ngjashme; dhe “mrekullia hyjnore,” e cila është interpretuar tërësisht dhe është kuptuar plotësisht në kohën tonë. Rruga e vetme e mundshme për ta vepruar atë është përmes të kuptuarit metafizik.

1. *Aliaa Ibrahim Dakroury është një kandidat për doktoraturë në Programin e Komunikimit, Shkolla e Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti Karleton, Ota-va, Kanada. Autori i shkrimit dëshiron të falënderojë Karim H. Karim, Shkolla e Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti Karleton, për kritikën e tij dobiprurëse dhe rekomandimet me shkrim, si dhe të falënderojë për reagimet e të pranishmëve dhe organizatorët e Konferencës së Parë Rajonale të Shoqatës së Shkencëtarëve Socialë Myslimanë (Toronto 2003), të cilët e zgjeruan shkrimin e këtij artikulli.



Parathënie

Çfarë është hermeneutika? Termi *hermeneutikë* rrjedh nga latinishtja *hermeneuin* ose *hermeneutika*, që do të thotë “procesi i ndërmjetësimit zhvillohet nga kuptimi i jashtëm në atë të brendshëm.”² Gjatë këtyre rreshtave, njeriu mund ta shohë hermeneutikën jo vetëm si të përkthyerit ose të shprehurit e një kuptimi, por më tepër si një shtjellim dhe interpretim i shpirtit dhe kuptimit të brendshëm të një teksti të caktuar. Unë do të filloj që ta ilustroj rëndësinë e këtij studimi duke përmendur vlerën e debatit i cili e rrethon çështjen e komentimit të Kur’anit. Pas kësaj, unë do të sugjeroj një bazë të mundshme filozofike për një hermeneutikë të Kur’anit përmes përmbledhjes së dy rrymave të ndryshme të qasjeve ndaj filozofisë së hermeneutikës. E para do të jetë përvetësimi dhe të kuptuarit e përbashkët i parë nga dy interpretime të ndryshme: ai i al-Gazzalit (1058-1111) dhe ai i Muhammed Abduhu (1849-1905). E dyta do të jetë perspektiva perëndimore përmes pikëpamjeve të rëndësishme të Martin Heidegger (1889-1976) dhe Jürgen Habermas (1929). Studimi do të përfundojë duke diskutuar një pikëpamje të mundshme e cila mund të pranohet nga dikush kur shqyrtohet çështja e komentimit të një libri të shenjtë, në përgjithësi, duke ditur “ndjeshmërinë” e tyre, kryesisht për pasuesit dhe besimtarët e tij.

Kur’ani për myslimanët

Për të pasur një pikëpamje të qartë për rëndësinë e trajtimit të hermeneutikës së Kur’anit, së pari duhet pasur një përshkrim të kësaj pike kryesore nga perspektiva dhe besimi islam. Për shembull, myslimanët e shikojnë ajetin më poshtë si një shembull të veçantisë gjuhësore të Kur’anit:

“Nëse i gjithë njerëzimi dhe xhindët do të mbledheshin për të krijuar një Kur’an të ngjashëm, ata nuk do të kishin mundësi, edhe nëse do ta ndihmonin njëri-tjetrin.” (17:88)

2. Jean Grondin, *Introduction to Philosophical Hermeneutics* (Hyrje në hermeneutikën filozofike, Yale University Press, 1994), f. 21.



Megjithatë, janë shtuar shumë pretendime shekullore të cilat kërkojnë që Kur'ani të jetë “i hapur” ndaj historisë dhe letërsisë. Për shembull, Cragg thotë: “Nëse baza është e bllokuar për t'u futur, atëherë si mund të njihet fundi i saj?”³ Çfarë do të thotë kjo? A mundet që kjo, sipas myslimanëve, të jetë e mundur ose e pranueshme? Në të vërtetë, myslimanët e shohin Kur'anin si shkrimin e folur që zbatohet dhe praktikohet fuqishëm në shoqëritë e tyre përmes recitimit (*kira'ah*). William Graham, në librin e tij *Beyond the Written Word* (Pas fjalës së shkruar), argumenton se ajo çfarë e bën një libër të shenjtë është besimi dhe kuptimi i njerëzve të tij për të si i tillë; kjo është pikërisht ajo se si myslimanët e kuptojnë Kur'anin, si një vepër të paarrtshme letrare (*i'xhaz*).⁴

Një pjesë e *i'xhaz*-it të tij, sipas kësaj pikëpamjeje, është se kuptimi i drejtpërdrejtë është i paaftë për të shpjeguar dhe paraqitur kuptimin unik dhe bazë të Kur'anit: “Çdo fjalë mbart një pafundësi kuptimesh brenda vetes, dhe nuk ka asnjëherë një shpjegim të plotë “horizontale” dhe didaktik të përmbajtjes së saj.”⁵ Gjithashtu, edhe nëse kuptimi i shkruar fjalë për fjalë nuk është i dukshëm (d.m.th., për ata që nuk mund të lexojnë ose të shkruajnë) prania e fuqishme dhe thelbi i fjalëve të Zotit do të jetojnë përmes veshëve dhe zemrave të tyre. Graham⁶ thotë se myslimanët

3. Cragg, *The Mind of the Qur'an: Chapters in Reflection* (Mendja e Kur'anit), f. 15.

4. Ibid., f. 13.

5. Nasr, *Ideals and Realities of Islam* (Idealet dhe të vërtetat e Islamit), f. 48.

6. Këtu është interesante të shënohet se Graham thotë se një nga miqtë e tij nisi të dëgjonte Kur'anin çdo ditë në Radio Pakistani gjatë kohës që jetonte në Afrikën Lindore. Kur Graham e pyeti atë se pse po vepronte ashtu, ndonëse ai nuk mund ta kuptonte tërë Kur'anin, miku i tij i tha atij se *barakah* (bereketi) i këndimit të Kur'anit do të përhapej në shtëpinë e tij. William A. Graham, *Beyond the Written Word: Oral Aspects of Scripture in the History of Religion* (Përtej fjalës së shkruar: Aspektet gojore të Shkrimit të Shenjtë në historinë e feve, Cambridge, Cambridge University Press, 1978), f. 104. Është e rëndësishme të përmendet se shumë veta besojnë gabimisht se gjuha arabe është një gjuhë “e shenjtë” sepse Kur'ani është shpallur në atë gjuhë. E vërteta është se gjuha arabe e përdorur veçanërisht në Kur'an është një gjuhë e shenjtë, siç besojnë myslimanët, sepse ato janë fjalët e Zotit. Nasr e sqaron këtë pikë duke thënë: “Arabishtja është e shenjtë në kuptimin se ajo është një pjesë përbërëse e shpalljes së Kur'anit ku tërë tingujt dhe shprehjet e të cilit luajnë një rol në veprimet rituale të Islamit.” Nasr, *Ideals and Realities of Islam* (Idealet dhe të vërtetat e Islamit), f. 44.



e zotërojnë këtë “ndjenjë të shenjtë, ose *barakah* (‘bekim’), të zërave të fortë të librit të shenjtë si diçka e cila duket sikur depërton në çdo skaj të botës islame.”⁷ Thënë qartë, koncepti i *barakah* është i vështirë që të shpjegohet në mënyrë logjike dhe fjalë për fjalë.

Në përgjithësi, përmbajtja e Kur’anit mund të klasifikohet në tre tema kryesore: “mesazhi doktrinar”, i cili ndërton kufijtë etikë dhe moralë të marrëdhënies njerëzore (kjo temë është interpretuar si Shariah - Sheriati (ligji islam); “tregimet historike”, të cilat i referohen historive të profetëve, popujve, vendeve të ndryshme dhe materialeve të ngjashme; dhe “mrekullia hyjnore”, e cila është interpretuar tërësisht dhe është kuptuar plotësisht në kohën tonë. Rruga e vetme e mundshme për ta vepruar atë është përmes të kuptuarit metafizik.⁸

Kjo çështje është shumë më e ndërlikuar sesa ajo që mund të tregohet brenda kufizimeve të këtij artikulli. Megjithatë, këtu duhet të përmendet se edhe interpretimet e Kur’anit nga ata filozofë myslimanë të cilët janë pranuar brenda spektrit perëndimor janë parë me dyshim nga disa komentues myslimanë tradicionalë të cilët pohojnë se në mënyrë kuptimplotë janë përfshirë më pak në tekstin e Kur’anit sesa ato të teologëve dhe shejhëve (dijetarëve). Për shembull, Hamdi Zakzuk e akuzoi Ibn Haldunin për keqinterpretim të kuptimit thelbësor të hermeneutikës së Kur’anit kur, njëherë në një nga komentet e tij, ai thotë se “*të gjithë arabët mund ta komentojnë Kur’anin.*” Zakzuk shton se Ibn Halduni e thjeshtëzon detyrën e komentimit të Kur’anit. Një kritikë e tillë tregon vërtet se sa i rëndësishëm është Kur’ani për besimtarët myslimanë.

7. Graham, *Përtej fjalës së shkruar*, f. 104.

8. Nasr, *Beyond the Written Word (Ideat dhe realitetet e Islamit)*, f. 50-51.

9. Hamdi Zakzuk, *Bubuth wa dirasat fi Daw’al-Ku’ran al-Kerim* (Studime dhe gjurmime në dritën e Kur’anit të Lavdishëm, Kajro: Ministria e Vakëfeve, 2002), f. 13.



Një vështrim nga brenda: Modele të komentimeve islame të Kur'anit

E veçanta e komentimeve islame dhe kundërshtimi absolut i qasjeve të orientalistëve ndaj Kur'anit është më i dukshëm te Halifa, i cili skicon qartë kushtet paraprake për komentimin dhe shpjegimin e tij (*tefsir*). Ai tregon se Al-Tabari (839-923), njëri nga kryesorët e *tefsir*-it të Kur'anit pohon se “*besimi i vërtetë i komentuesve të Kur'anit është baza për çdo komentim të mundshëm dhe të pranueshëm.*”¹⁰ Për ironi, ai shton se nëse njeriu nuk është i ndershëm me veten në jetë dhe nuk beson në Zot, si mundet që ne t'i besojmë atij në komentimin e fjalëve dhe të fshehtave të Zotit? Një tjetër perspektivë interesante që ngrihet në këtë libër është se autori e merr perspektivën “tjetër” duke e studiuar Kur'anin në të dyja perspektivat, atë historike dhe të drejtpërdrejtë. Ai thotë qartë: “*Qëllimet kryesore të këtyre orientalistëve janë që të provojnë qartë se Kur'ani nuk është fjala e Zotit.*”¹¹

Në fund, Halifa tregon se në pajtim me konsensusin e teologëve dhe juristëve myslimanë, duhet të plotësohen pesëmbëdhjetë kushte të ndryshme para se të komentohet Kur'ani. Kushtet më të rëndësishme të cilat mund të jenë të përshtatshme për këtë studim janë njohja e gjuhës arabe (*lughah*); gramatika (*nahw*); dhe kuptimet, shënimet dhe alegoria (*ma'ani* dhe *rumuz*); dhe recitimi i Kur'anit (*kira'ah*).

Një hermeneutikë metafizike: Al-Gazzali

Abu Hamid al-Gazzali, i njohur në mesin e arabëve si *Huxhxbet al-Islam*¹² dhe *Zejn al-Din*,¹³ është themeluesi i qasjes metafizike të hermeneutikës së Kur'anit.

10. Abdel Rahman Ibrahim Halifa, *Dirasat fi menbexh al-mufessirin* (Studime në qasjet e komentuesve, Kajro: Al-Azhar University Press, 1997), f. 39.

11. Ibid., f. 68.

12. Nuk ka asnjë përkthim të saktë të kësaj fjale. Megjithatë, kuptimi i tij do të thotë: pjesëmarrja e një personi të madh dhe dedikimi ndaj një çështjeje, një mendimi, ose një parimi.

13. Zbukurimi i fesë.



Nëse dikush do ta përmbledhte këtë qasje në një fjalë, ajo do të ishte “dashuri”. Al-Gazzali është i dashuruar me Zotin e tij dhe beson se kjo dashuri e vërtetë do ta dërgojë atë tek njohja e Zotit dhe te shenjat e fshehura dhe të mistershme në fjalën e Tij: Kur’anin. Në librin e tij referues *Al-Munkidh min al-Dalal* (Shpëtimi nga lajthitja), ai shprehet: “Unë besoj me të vërtetë, sikur e shikoj, se nuk ka fuqi tjetër veç Atij, më të Lartit, Dhuruesit të Madh, Dhënësit.”¹⁴

Zakzuk e përshkruan qasjen e tij duke i kursyer lexuesit dhe besimtarët nga rënia në përbindëshin homerik. Al-Gazzali përjetoi dy kriza të mëdha të skepticizmit të cilat përfunduan, sipas tij, kur ai njohu të vërtetën: Islamin.¹⁵ Gjithashtu, Abul Kasimi nënvizon linjën e fundit në teorinë e komentimit të Al-Gazzalit: Në përgjithësi, tema e të gjitha feve të shpallura është se njeriu është i paafte për t’i zgjidhur të gjitha problemet e jetës së tij vetëm përmes arsyes së tij (*akl*) dhe prandaj ka nevojë për udhëheqje nga Zoti në nivelin teorik dhe praktik.¹⁶

Si pasojë, al-Gazzali shtron çështjen se si një qenie njerëzore mund ta kuptojë kuptimin e vërtetë të Kur’anit kur ai ose ajo nuk është një krijesë tërësisht e aftë. Prej këtui, ai pranon një qasje metafizike të lidhur me çështjet e arsytimit dhe kufijve të arsyes njerëzore për të njohur Zotin përmes fjalës së Tij. Në këtë mënyrë, al-Gazzali e kundërshton retorikën dhe filozofët e saj, veçanërisht myslimanët, duke thënë se “pamjaftueshmëria e saj filozofike është më e madhe sesa përfitimet e saj.”¹⁷ Sipas tij, Sufizmi nuk mundet, vetë, që ta kuptojë dhe njohë Zotin pa e ndërthurur teorinë me praktikën. Veç kësaj, Sufizmi është më i lartë se shumë nga qasjet filozofike, sepse ajo e cila nuk mund të arrihet nga arsyeja njerëzore dhe aftësitë e saj shkencore mund

14. Abu Hamid al-Gazzali, *Al-Munkidh min al-Dalal* (Shpëtimi nga lajthitja) (Beirut: Dar al-Kutub al-Ilmiyah), f. 77.

15. Zakzuk, *Bubuth wa dirasat*, f. 200-201.

16. Muhammed Abul Kasem, *The Recitation and Interpretation of the Qur’an: Al-Ghazali’s Theory* (Recitimi dhe komentimi i Kur’anit: Teoria e Al-Gazzalit, Malajzi: Universiteti i Malajas, 1978), f. 9.

17. Al-Gazzali, *Al-Munkidh min al-Dalal*, f. 103.



të arrihet dhe të kuptohet plotësisht nga ndjenja, shija dhe dashuria e Sufizmit.¹⁸

Këtu, është e rëndësishme të përmendet se al-Gazzali, gjithashtu, e kundërshton atë çfarë ai e quan filozofia “e shpjeguar,” sikurse ajo e al-Farabit dhe Ibn Sinas. Ai tregon se ata ishin shumë të sigurt për përjetësinë e botës dhe, për më tepër, nuk e kishin menduar siç duhet dhe nuk e kishin kuptuar plotësisht ringjalljen fizike të Profetit gjatë *isra*-së dhe *miraxh*-it të tij. Rahman e shpjegon këtë pikë duke thënë:

“Al-Gazzali pohon, gjithashtu, me të drejtë, se spekulimi metafizik nuk e ka sigurinë ose forcën demonstrative të përpjesëtimeve matematikore. Por ai vazhdon të thotë, gabimisht, se meqenëse filozofia e këtyre njerëzve është e dëmshme për fenë, atëherë duhet që edhe veprat e tyre shkencore, gjithashtu, të shmangen – meqë ishte përpjekja e fundit për të krijuar dashamirësi tek studentët ndaj filozofëve (të cilët ishin gjithashtu edhe shkencëtarë) dhe i përgatiti ata që ta pranojnë filozofinë e tyre!”¹⁹

Al-Gazzali iu qas Kur'anit duke pranuar se ka disa nivele të ndryshme të kuptimit të drejtpërdrejtë të lidhura me fjalët, tingujt dhe shkronjat e tij. Ai shton se disa nga këto kuptime janë të qarta ndërsa disa prej tyre jo. Gjithashtu, fjala e Zotit ka katër nivele të ndryshme të të kuptuarit: të brendshëm (*batin*), të jashtëm (*zahir*), të fundit (*hadd*) dhe të fillimit (*matla'ah*). Një shembull i komentimit të tij do të ishte me vlerë në këtë kontekst:

“Thua ju (njerëzve): Nëse oqeani do të bëhej bojë për të kopjuar fjalët e Zotit tim, nuk ka dyshim që oqeani do të thahej para se të mbaronin fjalët e Zotit tim, edhe nëse do të shtoej edhe një herë sa ai.” (18:109)

Ai shpjegon se nëse këtë ajet do ta lexonte një jobesimtar i thjeshtë dhe dikush që nuk e do Zotin, ai ose ajo do të ishte i paafte që të kuptonte llojin e “masës” hyjnore që është treguar në atë ajet. Aftësitë mendore janë të kufizuara dhe nuk mund të shpjegojnë të gjithë kuptimin e fjalëve të Tij, madje edhe fjalët

18. Zakzuk, Buhuth ve dirasat, 206-209.

19. Fazlul Rahman, *Islam and Modernity: Transformation of an Intellectual Tradition* (Islami dhe modernizmi: Transformimi i traditës intelektuale, Çikago, Universiteti i Çikagos, 1982), f. 34.



më të “vogla”, si p.sh. “Ai”. Ai shton duke thënë se kuptimi themelor i Kur’anit është pa dyshim vetëm brenda botës së padukshme (*melekeh*). Veç kësaj, meqenëse ky shembull është përtej sistemit tonë njerëzor shqisor dhe mendor, mënyra e vetme për ta kuptuar atë është përmes “depërtimit shpirtëror” (*nur al-basirah*). Në librin e tij *Mishkat al-Anwar* (Kamarja e dritës), al-Gazzali thotë:

“Natyra është e errët, prandaj ajo nuk ka as njohuri, as turp, as ndërgjegje, e as dritë e cila kuptohet nga mjeti i shikimit fizik... dhe ky maskim, ashtu siç ka qenë, është egoja qendrore, dhe e pshet e errësirës; për këtë arsye nuk ka errësirë më të madhe sesa robëria ndaj nxitjeve dhe egoizmit.”²⁰

Si pjesë e interpretimit të tij të brendshëm, al-Gazzali dyshonte në aftësinë e përkthimit për të transmetuar kuptimin e vërtetë. Ai thoshte se “përkthimi (*tarxhamah*) i fjalëve të tij, nuk është i mjaftueshëm për të kuptuar të vërtetat e kuptimeve të tij (*haka’ik al-ma’ani*).”²¹ Al-Gazzali e përmbloodhi metodën e tij të interpretimit duke vendosur disa kushte paraprake. Për shembull, ai besonte se katër “maskime” e pengojnë të kuptuarit e vërtetë të domethënies së fjalës së Zotit: shqiptimin e shkronjave (duke përdorur gojën dhe gjuhën); *taklid* (pasimi i verbër), ose vetëm pasimi i një shkolle të mendimit ndonëse nuk i zbaton me sinqeritet mësimet e saj; errësira dhe ndryshku (*sada*) i zemrës, të përcaktuar si në momentin kur njerëzit këmbëngulin në kryerjen e gjynaheve edhe pse e dinë se ajo nuk është e drejtë, një gjendje e cila e pengon zemrën dhe mendjen e njeriut që të jetë i hapur ndaj interpretimit të vërtetë të Kur’anit; dhe kur një burrë (ose grua) ka lexuar shpjegimin e jashtëm të Kur’anit dhe ka krijuar besimin se fjalët e Kur’anit kanë vetëm kuptimet

20. Abu Hamid al-Gazzali, *Mishkat al-Anwar* (Kamarja e dritës), përkthyer nga W. H. T. Gairdner (Lahore: Sh. Muhammed Eshref, 1924), f. 159.

21. Nikolas Her, “Abu Hamid al-Ghazali’s Esoteric Exegesis of the Koran”, (Komentimi i brendshëm i Kur’anit nga Al-Gazzali), në *The Heritage of Sufism: Classical Persian Sufism from Its Origins to Rumi (700-1300)* (*Trashëgimia e Sufizmit: Sufizmi klasik persian nga origjina e tij deri te Rumi (700-1300)*), botues Leonard Levisohn (Oksford: One World, 1999), f. 241.



e tyre ashtu siç kanë zbritur sipas traditës së shpjegimeve të tjera.²²

Në librin e tij *Kitab Xhevahir al-Kur'an* (Xhevahiret e Kur'anit), al-Gazzali shpreh me pak fjalë doktrinën e tij të interpretimit pasi është pyetur për dobinë e alegorive të përdorura në Kur'an, meqenëse ato shprehin, në njëfarë mënyre, shenja të qarta të asaj që është e vërtetë dhe e drejtë:

*"Duhet të dini se pas këtyre shenjave ka shumë dobi, për të cilat është paraqitur një krabasim në mënyrë që prej tyre të kuptoni përcaktimin e rrugës drejt kuptimeve shpirtërore të botës së padukshme përmes fjalëve tradicionale, në mënyrë që dyert e shfaqjes së kuptimeve të Kur'anit të jenë të hapura dhe që të njihen metodat e zhytjes në detet e tyre."*²³

Hermeneutika e arsyeshme dhe bashkëkohore: Muhammed Abduhu²⁴

Një shembull tjetër i rëndësishëm i interpretimit mysliman të Kur'anit është ai i Muhammed Abduh. Mënyra e tij e mendimit dhe metoda e interpretimit ishin ndikuar kryesisht nga përvoja e tij si një aktivist politik. Ai ishte njohur me mendimet bashkëkohore dhe përparimtare kryesisht nga Xhemaludin Afgani (1838-1897), një udhëheqës dhe aktivist politik:

*"Përmes al-Afganit, Abduhu u njoh me botëkuptimin e Europës e cila zgjoi tek ai një interes në lidhje me situatën e Islamit në botën bashkëkohore."*²⁵

Prandaj, Abduhu e përkrahu luftën kundër pushtuesve britanikë në Egjipt. Për të, feja nuk ishte vetëm një çështje adhurimi; përveç kësaj, ajo ishte një mënyrë jetese.

22. Abul Kasem, *Recitimi dhe interpretimi*, f. 72.

23. Abu Hamid al-Gazzali, *The Recitation and Interpretation (Kitab xhevahir al-Kur'an-Xhevahiret e Kur'anit)*, përkthyer nga Muhammed Abul Kasem (Kuala Lumpur: Universiteti i Malajzisë, 1977), f. 62.

24. Abduhu, i lindur në një qytet të vogël në veri të Egjiptit, i nisi mësimet e tij me studime islame dhe i vazhdoi ato në Universitetin e Al-Az'harit. Ai kishte disa profesione: mësues, gazetar, gjykatës, dhe, në fund, mufti.

25. Xhejn Smith, *An Historical and Semantic Study of the Term "Islam" as Seen in a Sequence of Qur'an Commentaries* (Një studim historik dhe semantik i termit "Islam" i parë nga një vazhdimësi e komenteve të Kur'anit, Montana: Scholars Press, 1975), f. 185.



Prandaj, ai e lexonte dhe e interpretonte Kur'anin në një mënyrë ndryshe nga paraardhësit e tij. Një tipar tjetër i rëndësishëm i trajtimit të tij është realizimi i reformave dhe zhvillimit të fesë, veçanërisht në dy fusha: në Universitetin e al-Az'harit²⁶ dhe në interpretimin e Kur'anit. Përpara tij, shumë komentime të Kur'anit ishin përqendruar kryesisht në strukturën gramatikore, traditën e Profetit Muhammed (*hadith*), dhe gjuhën arabe. Abduhu i refuzoi shumicën e këtyre *tefsir*-ëve "të caktuar" dhe "të padiskutueshëm". Ai besonte se Kur'ani nuk përfaqësonte vetëm aspektin e drejtpërdrejtë:

*"Në Ditën e Fundit Zoti nuk do të na pyesë neve për komentuesit se si e kuptuan ata Kur'anin, por Ai do të na pyesë neve për Librin e Tij të cilin Ai e zbriti për të na udhëzuar dhe mësuar neve."*²⁷

Dikush mund të sugjerojë se vështirimi i Abduhusë, në njëfarë mase, i përgënjeshtroi pohimet se Islami (dhe Kur'ani) e kundërshtojnë metodën përparuese dhe bashkëkohore të komentimeve. Një projekt modern, i cili nisi në Europën e shekullit të tetëmbëdhjetë, ka sulmuar mënyrat ekzistuese socio-politike dhe epistemologjike të shoqërisë në emër të epërsisë së arsyes njerëzore. Është interesante të thuhet se ndikimi i tij në botën arabe pranoi si të vërtetë dy forma të ndryshme: pranimi i besimeve thelbësore të projektit përmes reformës sociale,²⁸ refuzimi i plotë i tij (prirja *asalah* [autentike]) dhe pranimi i vërtetësisë së kulturës islame. Në mesin e atyre të cilët i mbrojtën dhe i përvetësuan këto pjesë të projektit të cilat u dukën të përshtatshme ishin al-Fargani dhe Abduhu. Ndërkohë që al-Fargani e pranoi projektin reformues të Muhammed Ali (1805-1949), ai e kundërshtoi laicizmin e përkrahur nga

26. Si rezultat i përpjekjeve dhe mendimeve të tij, Universiteti i al-Azharit është ndarë në tre fakultete: Ligji Islam (Sheriati), Teologjia (*Usul al-Din*), dhe Gjuha Arabe (*al-Luga al-Arabija*). J. Jansen, *Komentimi i Kur'anit në Egjiptin modern* (Leiden: E. J. Brill, 1974), f. 77-78.

27. Ibid., f. 19.

28. Ky ishte realiteti në Egjipt, kur Hidevi Muhammed Ali u përpoq që të reformonte arsimimin duke dërguar delegacione të ndryshme në vendet perëndimore dhe duke reformuar aspekte të ndryshme të jetës shoqërore, si në industri dhe bujqësi.



britanikët me arsyen se ai ishte një kërcënim i madh për Islamin dhe identitetin kombëtar:

*"Islami duhet të jetë baza morale e një shoqërie moderne dhe përparimtare, por ai nuk mund të pranojë çdo gjë që kryhet në emër të modernizimit. Shoqëria islame mund t'i përvetësojë mendimet dhe shkencat europiane pa hequr dorë nga Islami."*²⁹

Në të vërtetë, Islami nuk është kundër modernizimit dhe ai kërkon që arsyeja njerëzore të përdoret. Në gjithë tekstin e tij, Kur'ani bën thirrje dhe përkrah shumë nga pikëpamjet të cilat projekti modern i ka hedhur poshtë dhe i ka luftuar, si p.sh. mashtrimet në masë, magjia dhe mitet. Ai, gjithashtu, e pranon rëndësinë e përdorimit të arsyes njerëzore dhe të diturisë si një rrugë për të njohur Zotin dhe për t'u bërë një mysliman i mirë.³⁰

Prandaj, përdorimi i arsyes së vërtetë të njeriut gjatë interpretimit është, gjithashtu, një karakteristikë themelore e komentimit të Abduhus. Me fjalë të tjera, ai e shkroi komentimin e tij të projektuar në një mënyrë të tillë për të thjeshtëzuar dhe shpjeguar fjalën e Zotit për njerëzit e thjeshtë, sepse në atë kohë niveli i shkrimit e i këndimit në Egjipt ishte shumë i ulët.

Tefsiri tradicional³¹ nuk i kishte përgjigjet e duhura për shumë nga pyetjet e kohës që ishin pyetur nga njerëz të thjeshtë dhe intelektualë të cilët kishin krijuar lidhje me Perëndimin nëpërmjet shkollave publike misionare në Francë, Angli dhe vende të tjera europiane. Abduhu donte që feja të përfshihej në jetën e tyre, në vend që të mbetej diçka abstrakte dhe ekzistuese vetëm brenda

29. Derek Hopvud, "Introduction: The Culture of Modernity in Islam and the Middle East" (Kultura e modernizimit në Islam dhe në Lindjen e Mesme, në *Islam and Modernity: Muslim Intellectuals Respond* (Islami dhe modernizimi: Përgjigje e intelektualëve myslimanë, botues Xhon Kuper, Ronald Netler dhe Muhammed Mahmud (Londër: I. B. Tauris, 1998), f. 6.

30. Në shumë ajete, Kur'ani jep një shenjë të kësaj çështjeje, ku ndër to janë dhe ajetet 2:102 dhe 114:1-7. Ndërsa për rëndësinë dhe përdorimin e arsyes, shih, për shembull, ajetin 79:26.

31. Abduhu e shpreh krizën e komentimit tradicional të Kur'anit gjatë arsimimit të tij të hershëm: "Kam shpenzuar një vit e gjysmë... pa kuptuar asgjë... mësuesit ishin mësuar të përdornin terma teknikë të gramatikës ose të jurisprudencës të cilat ne nuk i kuptonim, dhe ata nuk u munduan aspak që t'ia shpjegonin kuptimin e tyre atyre që nuk i dinin." Jansen, *The Interpretation (Komentimi)*, f. 29.



ambientit të xhamive.

Në përgjithësi, dikush mund të thotë se “arsyetimi” është tema kryesore e komentimit të Abduhusë. Për ta argumentuar këtë, ky konkluzion mund të burojë nga diskutimi i mëparshëm mbi marrëdhënien mes Islamit dhe modernizmit, dhe për këtë arsye ai e përdori mendjen e tij dhe e futi atë në komentimin e tij të Kur’anit, veçanërisht kur bën fjalë për *tefsirët* “e caktuar”.³² Një gjë e cila duhet sqaruar këtu është se Abduhu e pohon dhe e miraton përdorimin e arsyes gjatë komentimit të Kur’anit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ai e nënvleftëson rëndësinë dhe domethënien e shpalljes në interpretimin e tij. Në të vërtetë, ai e ndërthur në mënyrë unike shpalljen dhe përdorimin e arsyes si burimin islam të *hidajah* (udhëheqjes), një shembull i të cilës mund të vërehet në ajetin në vijim:

“Nuk ka Zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përhershmit; Ai ua zbriti juve Librin (Kur’anin) me të Vërtetën, duke vërtetuar ato që kishin zbritur më herët, dhe Ai e zbriti Teuratin dhe Ungjillin më parë si udhëzues për njerëzit, dhe Ai e zbriti edhe Furkanin.” (3:1-4)

Shpjegimi tradicional dhe më shumë i njohur i fjalës *furkan* është se ajo fjalë është një sinonim për Kur’anin,³³ ose se Kur’ani bën dallimin mes të vërtetës dhe mashtrimit. Komentuesit klasikë si al-Zammahshari, al-Razi, dhe al-Tabari kanë pikëpamje paksa të ndryshme. Abduhu e interpreton fjalën *furkan* si “arsye”. Nga një perspektivë perëndimore, duke paraqitur një version të qartë bashkëkohor, Jansen thotë se “Abduhu duket sikur e ka zëvendësuar shpalljen me arsyen.”³⁴ Kjo është përgënjeshtruar nga Abdullah Shehata, një komentues i famshëm egjiptian,

32. Për shembull, marrim në konsideratë *tefsirin* e tij ku thotë “Ai u vrenjt dhe u largua, sepse burri i verbër iu afrua atij. Por çfarë mund të të tregonte ty se mbase ai mund të pastrohej, ose të të kujtonte (për të vërtetën), dhe të ndihmonte duke ta kujtuar atë?” (80:1-5). Komentimi tradicional është se burri i verbër donte që ta pyeste Profetin për diçka ose donte që t’i tregonte një gjynah. Abduhu pohon se burri i verbër po e pyeste për dituri. Ibid, f. 21.

33. Përkthimi arabisht i fjalës *furkan* rrjedh nga folja *faraka*, *jefruku*, që do të thotë “të dallosh” ose të “veçosh.”

34. Ibid., f. 22.



i cili thotë se pikëpamja e Abduhus në lidhje me marrëdhënien ndërmjet arsyes, shpalljes dhe *hidajah* është e qartë: Arsyeja njerëzore dhe shpallja janë dy burime të rëndësishme, por ato duhen “gërshetuar” (*jetenafaka*).³⁵

Një tjetër parim i rëndësishëm në komentimin e Abduhu, të cilin Jansen dhe të tjerë e kanë kritikuar, është pohimi dhe pranimi nga ana e tij i disa kuptimeve “të fshehta” dhe “të pakuptueshme” të Kur'anit. Abduhu thotë se ne nuk duhet të përpiqemi të shpjegojmë një kuptim të panjohur (*mubham*) në Kur'an. Disa nga pasuesit e tij kanë shkruar edhe një libër të titulluar *Menbexh al-Imam fi al-Mubham* (Doktrina e Imamit ‘Muhammed Abduhu’ në të kuptuarit e panjohur). Prandaj, dikush mund të shohë një pikëpamje në lidhje me komentimin e Kur'anit, siç është prezantuar nga Abduhu dhe të tjerë, e cila sugjeron që edhe një komentim i arsyeshëm i Kur'anit, nuk duhet pranuar si një kuptim shumë i qartë për shkak të mundësisë së një kuptimi të brendshëm ose të fshehtë të lënë nga Zoti për njerëzit që të mendojnë.³⁶ Në fund, dikush mund ta përmbledhë qasjen e Abduhusë në komentimin e Kur'anit si të arsyeshme. Në të vërtetë, ai thotë se ne duhet ta përdorim Kur'anin për të komentuar kuptimin e tij: *tafsir al-Kur'an bi al-Kur'an*.³⁷ Këtu poshtë kemi një pohim tjetër i cili përshkruan parapërgatitjet për një komentim të saktë:

“Myslimani i vërtetë në gjykimin e Kur'anit është ai (ajo) i cili (e cila) është i patëmetë (halis) nga të metat e shoqërimit të të tjerëve me Zotin, është i/e singertë (muhlis) në veprat e tij (e saj) dhe që ka besim, i çdo komuniteti

35. Ibid., f. 23, nr. 20.

36. Këtu, një shembull do të qartësojë dallimin mes Abduhu dhe komentuesve të tjerë: “Sa herë që Zekeria hynte në strehë për ta parë atë (Merjemen), ai gjente ushqime pranë saj. Ai e pyeste: “O Merjeme, si e sigurove këtë ushqim?” Ajo përgjigjej: ‘Është nga Allahu; Allahu i jep atij që Ai do’” (3:1-4). Shumë komentues synonin që të përshkruanin gjërat e mrekullueshme në strehën e Merjemes, ndërsa Abduhu këmbëngul se ky nuk është kuptimi i vërtetë dhe i arsyeshëm i këtij ajeti. Për më tepër, ai mendon se gjëja më e rëndësishme këtu është që të kuptohet se fuqia e Zotit i lejon Atij që të bëjë atë që do Ai, pavarësisht çdo mendimi njerëzor ose të arsyeshëm.

37. Ibid., f. 33.



fetar qoftë (millah - millet), dhe në çfarëdo kohe ose vendi qoftë ai (ajo).³⁸

Shembuj hermeneutikë të Perëndimit

A ka ndonjë mundësi?

Në këtë pjesë, është e nevojshme të paraqitet një analizë shumë e ndërlikuar dhe sfiduese si një qasje e mundshme filozofike ndaj hermeneutikës së Kur'anit duke marrë një teori jo-islame të komentimit përmes një diskutimi të qasjeve të ndryshme nga dy profesorë perëndimorë të hermeneutikës: Martin Heidegger (1889-1976) dhe Jürgen Habermas (1929-). Kjo do të pasohet nga sintetizimi i elementeve të ideve filozofike të tyre të cilat mund të jenë të dobishme për të krijuar një interpretim “të vërtetë” të Kur'anit. Një përparësi e paraqitjes së këtyre dy shembujve është që të provohet se udhëzimi etik, edhe nëse thuhet nga një përkthyes jomysliman, do të pranohet në komentimin e Kur'anit. Al-Gazzali dhe Abduhu i përkrahin të njëjtat ide në trajtimet e tyre.

“Dasein” (Ekzistenca) e Martin Heidegger

Martin Heidegger, një filozof dhe fenomenolog gjerman, mund të shihet si një kontribues i rëndësishëm në mendimin hermeneutik bashkëkohor. Shumë shkencëtarë pranojnë se ai është përgjegjës për ndryshimin në të menduar në lidhje me hermeneutikën si një disiplinë filozofike. Para tij, hermeneutika kërkonte të arrinte ose një qëllim epistemologjik (duke zbuluar bazën e njohurisë njerëzore) ose një qëllim metodologjik (duke kërkuar mjetet të cilat të çojnë në njohurinë objektive). Në të vërtetë, Heidegger më shumë ishte i interesuar për t'iu përgjigjur pyetjes së “Qenies,” meqë ai donte të shpjegonte kushtet “ontologjike” dhe pozitën e njohurisë njerëzore: “Heidegger e ktheu analizën e hermeneutikës ndaj çështjes së Qenies.”³⁹

38. Smith, *An Historical and Semantic Study* (Një studim historik dhe kuptimor), f. 192.

39. Gajle L. Ormiston dhe Alan D. Shrift, *The Hermeneutic Tradition: From Ast to Ricoeur* (Tradita hermeneutike: Nga Ast deri te Ricoeur, Albany: Universiteti Shtetëror i Nju Jorkut, 1990), f. 15.



Pikëpamja e përgjithshme filozofike e Heideggerit në lidhje me rolin e hermeneutikës mund të zbatohet në diskutimin tonë si një përkthyes jomysliman i Kur'anit. Jean Grondin thotë:

“Unë mendoj se mund të tregohet se hermeneutika e të faktuarit të Heideggerit ka qëllim që të jetë një hermeneutikë e çdo gjëje që vepron pas pohimeve.”⁴⁰

Prandaj, perspektiva Heideggeriane nuk shihet vetëm në fjalët e sakta, pohimet, apo tekstet; por më shumë, mund të themi se ajo do që të përshkruajë procesin e të kuptuarit “para” përkthimit, një çështje e cila nuk është e kundërt me vlerësimin dhe respektin e madh të mysllimanëve ndaj Kur'anit. Sipas Heideggerit, përkthyesi perëndimor do ta kuptojë “Qenien” e Kur'anit përpara se ai ose ajo të orvaten ta komentojnë ose ta përkthejnë atë.

Grondin e vë theksin mbi këtë çështje, duke shpjeguar se *kuptimi i përparshëm* është një koncept më i thellë sesa një lloj i kuptuari shkakësor ose sipërfaqësor. Sipas Heideggerit, kjo është e njëjtë me kontrollimin e të kuptuarit:

Në këtë mënyrë ne mund të themi se një atlet “kupton” ose di se si të luajë futboll. Me këtë ne sigurisht nuk kuptojmë se ai ka njohuri, por ka një aftësi të madhe të pashprehur, një mjeshtëri, në të vërtetë “një art.”⁴¹

Një tjetër tipar i rëndësishëm i hermeneutikës së Heideggerit është përqendrimi i tij në transparencë. Kjo çështje është shumë më e rëndësishme në përkthimin e një libri të shenjtë në përgjithësi, dhe më i madh në mënyrë të posaçme në rastin e Kur'anit:

“Është e nevojshme që situatën tonë ta bëjmë transparente në mënyrë që të vlerësojmë saktësinë e tekstit - që domethënë, pa lejuar që paragjykimet tona të pashpjeguara të mbizotërojnë tekstin padashur dhe në mënyrë të fshehtë siç është më e përshtatshme për të.”⁴²

Ky mendim ka zënë gjithmonë një vend kryesor në perspektivën islame mbi komentimin e “të tjerëve,” siç është rasti me orientalistët, të cilët mysllimanët i kritikuan për moskuptim

40. Martin Heidegger, “Being and Time” (Qenia dhe koha), *ibid.*, f. 90.

41. Grondin, *Introduction (Hyrye)*, f. 93.

42. Heidegger, *Being and Time* (Qenia dhe koha), f. 119.



të Kur'anit dhe i akuzuan si të “paqenë” mjaft transparentë për ta përkthyer atë në mënyrë të drejtë dhe të pranuar. Heidegger e shpjegon këtë koncept të transparencës në librin e tij “Qenia dhe Koha”:

“Ne e zgjodhëm këtë term (transparencë) për të treguar ‘njohurinë e Vetes’ në një kuptim i cili kuptohet mirë, në mënyrë që të tregohet se kjo nuk është një çështje e ndjekjes perceptuale dhe e shqyrtimit të një pike të quajtur ‘Vete’, por është një çështje e kapjes së zbulimit të plotë të Qenies në botë nëpërmjet të gjitha termave themelorë të cilat janë thelbësore për të, dhe duke e vepruar atë me mirëkuptim.”⁴³

Një veti tjetër e rëndësishme e hermeneutikës së Heideggerit e cila lidhet me temën e këtij studimi është koncepti i kuptimit. Për atë, kuptimi nuk është përpara të kuptuarit; për më tepër, ai e pason të kuptuarit. Që këtej, ai përshkruan tre lloje të të kuptuarit: të diturit më herët, të parashikuarit, dhe të konceptuarit më herët. Të diturit më herët (*Vorhabe*) është shkalla e të përfshirit me vetë “Qenien”. Për shembull, nëse e marrim Kur'anin, të diturit më herët do të jetë njohuria që ka dikush për gjuhën arabe, dhe kjo sjell të kuptuarit. Kështu që, si mundet një njeri i cili dëshiron që të përkthejë një tekst në gjuhën arabe, ndonëse ai ose ajo nuk e njeh gjuhën arabe, të arrijë një të kuptuar të saktë? *Parashikimi* (*Vorsicht*), i përcaktuar si mendimet dhe qëndrimet e ndryshme të cilat i kemi pasur tashmë që “përpara” shfaqjes sonë në tekst, mund të shihet në njohurinë e dikujt të gjuhës dhe gramatikës arabe.

Është interesante që këto forma të të kuptuarit janë të ngjashme me kushtet e kërkuara nga al-Gazzali, kur ai përshkruan se sa shumë e nevojshme është njohja më herët e gjuhës dhe e gramatikës arabe për të komentuar Kur'anin. Faza e tretë e hermeneutikës është të konceptuarit më herët (*Vorgrif*). Ai argumenton se njohuria dhe të kuptuarit më herët i përmbajtjes së një teksti është pjesë në afërsinë tonë me llojin e tekstit. Kuptimi është ai “mbi të cilin” ngrihet dhe nga pikëpamja e të cilit diçka bëhet e kuptueshme qoftë edhe pak; ai e merr strukturën

43. Ibid., f. 124.



e vet nga të diturit më herët, parashikimi dhe të konceptuarit më herët.⁴⁴

Në fund, Heidegger shkroi se kur komentohet një tekst (ose një mesazh në përgjithësi), duhet parë gjithmonë edhe ana “tjetër”; për shkak se kuptimi nuk është me një drejtim, por ai lëviz në një drejtim të “shpërndarë”:

...çdo përgjigje kundër-bisedë rrjedh në mënyrë të përafërt dhe të drejtpërdrejtë nga të kuptuarit e asaj për të cilën bisedohet, e cila është “ndarë” tashmë në “anën e Qenies”.⁴⁵

Heidegger u akuzua se ka paraqitur një perspektivë “elitare” në hermeneutikë,⁴⁶ duke u fokusuar vetëm në “Qenien” dhe duke mos u interesuar për kontekstin shoqëror. Unë pajtohem me pikëpamjen e tij, por në të njëjtën kohë pranoj se ai, pa dyshim po përfshihet në hermeneutikë. Nëse në filozofinë e tij ai është përqendruar te “Qenia” ontologjike. Ai, gjithashtu, ka theksuar rëndësinë e “të kuptuarit më herët,” i cili është shumë i rëndësishëm për përkthyesin e një libri të shenjtë për të kuptuar popujt e tjerë dhe kulturat e tyre.

Hermeneutika dhe vepra e Jürgen Habermas

Ndalimi ynë i fundit është Jürgen Habermas, një teoricien kritik dhe filozof gjerman. Në fillim duhet të hedhim pak dritë mbi mendimet dhe filozofinë e tij para se të diskutohet për kontributin e tij në hermeneutikë në përgjithësi, dhe për përdorimin e tij të Teorisë së Veprimt Komunikues (TVK) për të zgjidhur disa pjesë të debatit në lidhje me një afrim të mundshëm ndaj hermeneutikës së Kur'anit. Kryesisht, dikush mund ta shohë ndikimin e filozofisë së Kantit si një nga pjesët themelore të prirjes së Habermas ndaj mbrojtjes morale në fushën e të vërtetës, bukurisë, dhe drejtësisë

44. Ibid., f. 137.

45. Ky diskutim lidhet me marrëdhënien mes hermeneutikës dhe kulturës. Për më shumë informacion, shikoni Rui Sampaio, www.bu.edu/wcp/Papers/Cult/CultSamp.htm

46. Jürgen Habermas, *Moral Consciousness and Communicative Action (Vetëdija morale dhe veprimi komunikues*, Kembrixh, MA: The MIT Press, 1990), f. 23.



- hapësirat kryesore të debatit në projektin bashkëkohor.

Në fillim, duhet nisur duke sqaruar sesi Habermas e ka kuptuar hermeneutikën. Ai mendon se hermeneutika nuk ka të bëjë vetëm me një tekst të shkruar, por ai konsiston në çdo shprehje kuptimplote - qoftë një shprehje me fjalë, e folur ose jo e folur, ose artikull i çdo lloji, si p.sh. një mjet, organizëm, ose një dokument i shkruar - që mund të identifikohet nga një perspektivë e dyfishtë, si një ngjarje e dukshme dhe si një objektivizëm i kuptueshëm i kuptimit.⁴⁷

Për Habermas, përdorimi i hermeneutikës për t'i shërbyer metodologjisë së shkencave shoqërore ka një interes thelbësor. Kjo ide përputhet shumë me futjen e tij në Shkollën e Frankfurtit dhe teorinë kritike, qëllimi kryesor i së cilës është që të hulumtojë dhe të studiojë në mënyrë kritike shkencat shoqërore.

Si rrjedhim, Habermas kishte një pikëpamje të vetën se si përdoret gjuha ndryshe nga, për shembull, Hans-Georg Gadamer, i cili e shikon atë vetëm si një mjet. Ai thotë se “gjuha nuk është vetëm një objekt në duart tona, por ai është rezervuari i traditës dhe një mjet përmes së cilit ne ekzistojmë dhe kuptojmë botën tonë.”⁴⁸ Përkundrazi, Habermas e vështron atë si një pjesë përbërëse të botës shoqërore. Prandaj, projekti i tij mund të përmbledhet me anë të marrëdhënies së afërt që ai sugjeron mes “gjuhës” dhe “veprimit” për t'i dhënë mundësi hermeneutikës që të lëvizë në atë që ai e quan “projekti i papërfunduar i sqarimit.” Prandaj, të kuptuarit e një gjuhe të caktuar, realizohet ashtu siç e shpjegon Xhon Thompson pikëpamjen e “veprimit” të Habermas duke thënë se ajo “do të thotë që të jesh i aftë për të vepruar, dhe të përfshihesh në të në mënyrë që ta zotërosh atë.”⁴⁹

47. Hans-Georg Gadamer, “On the Scope and Function of Hermeneutical Reflection” (Për fushën dhe funksionimin e mendimit hermeneutik, në *Hermeneutika dhe filozofia moderne*, botuar nga Brice Wachterhauser (Albany: Universiteti Shtetëror i Nju Jorkut, 1986), f. 286.

48. Xhon B. Thompson, *Critical Hermeneutics: A Study in the Thought of Paul Ricoeur and Jürgen Habermas* (Hermeneutika kritike: Një studim i mendimit të Paul Ricoeur dhe Jürgen Habermas, Cambridge: Cambridge University Press, 1981), f. 81.

49. Jürgen Habermas, *Communication and the Evolution of Society* (Komunikimi dhe zhvillimi i shoqërisë, Boston: Beacon Press, 1979), f. 16.



Me fjalë të tjera, ai dëshiron që filozofia dhe shkencat shoqërore të ecin përmes TVK-së së tij:

“Nga pozita e favorshme e interesit të studimeve të mia, unë shikoj që po ndodh një bashkëpunim i cili po merr formë mes filozofisë së shkencës dhe historisë së shkencës, mes teorisë së të folurit dhe qasjeve empirike ndaj pragmatikës së gjubës.”⁵⁰

Habermas pyet se si mund ta komentojmë një tekst në mënyrë që ta kuptojmë atë, ndërkohë që vetë kuptimi përfshin një komunikim “të shtrembëruar.” Me termin *i shtrembëruar*, dikush mund të kuptojë se mesazhi i transmetuar mes një dërguesi dhe një marrësi nuk është interpretuar me saktësi, ose, me fjalë të tjera, se kuptimi që do t’i shkonte marrësit nuk është i njëjtë me atë të cilin marrësi e merr nga një mesazh. Prandaj, Habermas thotë se dikush mund të shohë se sa kritike është çështja e “të vërtetës” në komentim. Është e qartë se unë po përdor pikëpamjen e “pretendimeve të vlefshme” të Habermas si parapërgatitjet e tij për një komunikim jo të shtrembëruar për të komentuar një libër të shenjtë. Në TVK-në e tij, Habermas saktëson se për të transmetuar një mesazh, duhet të plotësohen kushtet e pastërtisë, sinqeritetit dhe vërtetësisë:

“Unë do të krijoj një tezë të cilën çdokush që sillet në mënyrë komunikuese duhet që, gjatë mbajtjes së një fjalimi, të formojë deklaramë të vlefshme universale... për aq sa ai dëshiron të marrë pjesë në një proces për të arritur mirëkuptimin, ai nuk mund t’i shmanget rritjes në vijim... deklaramëve të vlefshme. Ai pretendon të jetë në gjendje:

- a. Të shprehë diçka të kuptueshme;*
- b. T’i japë (dëgjuesit) diçka që ta kuptojë;*
- c. Ta tregojë veten në mënyrë të kuptueshme; dhe*
- d. Të arrijë një mirëkuptim me një person tjetër.”⁵¹*

Pra, në diskutimin tonë në lidhje me komentimin e një libri të shenjtë si Kur’ani, përkthyesi, sipas Habermas, duhet që ta kuptojë i pari atë në mënyrë që ta komentojë me saktësi, dhe, në të njëjtën kohë, të ketë “miratimin” e komentimit nga dëgjuesi.

50. Ibid., f. 2.

51. Ibid.



Kjo çështje është shumë e rëndësishme meqë, në të folurën praktike, hermeneutika nuk është vetëm komentimi i një kuptimi, por më tepër është komentimi i një kuptimi “të pranueshëm” për përgjegjësin. Nëse teksti i komentuar do të ishte fjala e Zotit, do të kishte shumë rëndësi që ky komentim të pranohej dhe të kuptohej. Habermas shpreh:

“Folësi duhet të zgjedhë një mënyrë shprehjeje të kuptueshme në mënyrë që folësi dhe dëgjuesi mund ta kuptojnë njëri-tjetrin, folësi duhet të ketë synim që të kumtojë përmbajtjen e një pobimi të vërtetë... kështu që dëgjuesi mund të përfitojë nga dituria e folësit. Folësi duhet të kërkojë që të shprehë qëllimet e tij me sinqeritet në mënyrë që dëgjuesi të besojë.”⁵²

Prandaj, kushtet e vëna nga Habermas për një komunikim jo të shtrembëruar i cili është formuluar sipas TVK-së së tij është shumë i rëndësishëm kur komentohej një libër i shenjtë, megjithëse ai është akuzuar se është Eurocentik, gjë të cilën unë nuk e mohoj, siç ka thënë edhe ai vetë:

“Unë nuk besoj se ne, si evropianë, mund t'i kuptojmë seriozisht koncepte si etika dhe jeta e moralshme, personin dhe personalitetin, ose lirinë dhe emancipimin, pa i përshtatur përmbajtjen e mirëkuptimit judeo-krishterë nga pikëpamja e shpëtimit.”⁵³

Megjithatë, në të njëjtën kohë, ajo çfarë do të ndodhë më pas është me siguri ajo që ne, si studiues të komunikimit dhe shoqërisë, po kërkojmë të gjejmë te interpretime të ndryshme të mjeteve të komunikimit, veçanërisht nga një perspektivë “tjetër”: A mund ta shohin ne pastërtinë, sinqeritetin ose të vërtetën në interpretimin e historive të reja? Nëse Perëndimi nuk mund t'i interpretojë lajmet me drejtësi dhe transparencë, si munden vallë myslimanët ose popullsi të tjera joperëndimore të “pranojnë” interpretimet perëndimore të librit të tyre të shenjtë, të një libri i cili është vetë shpirti dhe jeta e tyre? Sipas mendimit tim, Situata e Fjalimit Ideal të Habermas, përbërësi utopik

52. Gerard Delanty, “Habermas and Occidental Rationalism: The Politics of Identity, Social Learning, and the Cultural Limits of Moral Universalism” (Habermas dhe racionalizmi perëndimor: Politika e identitetit, mësimi shoqëror dhe kufijtë kulturorë të universalizmit moral, *Teoria sociologjike* 15, nr. 1 (1997), f. 38.

53. Ibid., f. 38.



për të cilin ai beson se është mishëruar në të gjithë komunikimin gjuhësor të njerëzve dhe i cili shpreson të përfaqësojë një model për lirinë dhe drejtësinë e shoqërisë, nuk gjendet në shumë nga interpretimet tona bashkëkohore dhe, sipas perspektivës islame, mungon, gjithashtu, në interpretimet e Kur'anit si dhe në kulturat dhe traditat islame.

Në fund, duhet thënë se është problematik pretendimi se qasjet perëndimore janë dukshëm të pranueshme për myslimanët. Për më tepër, pretendimi se këto qasje të hermeneutikës së Kur'anit kanë mënyrat e tyre të leximit, të mendimit, të të kuptuarit dhe të vetë situatës, dhe se ato e pasqyrojnë këtë kuptim me pastërti dhe sinqeritet, mund të nxisë pranimin e pikëpamjes joperëndimore. Ky diskutim është përmbledhur nga Halid Abu Al-Fadl, i cili thotë se nëse një autor “perëndimor” dëshiron që të interpretojë dhe të kuptojë librin e myslimanëve, ai ose ajo duhet t'i rezistojë joshjes për ta bindur dhe për ta bërë të domosdoshme përvojën islame për t'i shërbyer një debati... duhet nisur me përvojën islame dhe më pas të merren parasysh me kujdes mënyrat, të cilat [intelektualët perëndimorë] mund t'i shfrytëzojnë për t'i shërbyer përvojës islame.⁵⁴

Përfundim

Diskutimi më lart sugjeron që Kur'ani mund të interpretohet me saktësi nga një përkthyes jomysliman. Megjithatë, shumë dijetarë myslimanë dhe myslimanët në përgjithësi, për shkak të respektit të tyre të lartë për Kur'anin dhe praninë e tij të rëndësishme në jetën e tyre, mbase mund ta hedhin poshtë plotësisht këtë përfundim. Sidoqoftë, argumenti i ngritur këtu nuk e kundërshton as perspektivën islame dhe respektin e tij për Kur'anin e as etjen për të njohur atë çfarë thotë Kur'ani nga një pikëpamje joislame.

54. Halid Abu El-Fadl, *And God Knows the Soldiers: The Authoritative and Authoritarian in Islamic Discourses* (Dhe Zoti i njeh ushtarët: Autoriteti dhe autoritarizmi në ligjërimet islame, Lahman, MD: University Press of America, 2001), f. 99.



Këtu nuk është propozuar që myslimanët të pranojnë pohimet laike dhe ta hapin librin e tyre të shenjtë ndaj historisë, në mënyrë që ai të shqyrtohet dhe të komentohet si çdo libër tjetër.

Në të vërtetë, ajo çfarë unë po përpiqem të bëj është që të ndryshoj imazhin “e huaj” që Islami ka marrë kohët e fundit si rezultat i Perëndimit, i cili e shikon atë si “ndryshe” dhe e kundërta, edhe frika islame për lejimin e dikujt tjetër përveç tyre për ta lexuar, kuptuar dhe komentuar Kur’anin tregon, pa dyshim, se njerëz të tillë ndeshen me kushtet fetare të interpretimit të diskutuara më lart. Siç pohon edhe Eduard Said:

“...pothuajse pa asnjë përjashtim, asnjë autor, i cili shkruan sot në Perëndim për Islamin pajtohet singlerisht me faktin se Islami konsiderohet një kulturë armike, ose se gjithçka e thënë rreth Islamit nga një dijetar profesionist është brenda sferës së ndikimit të shoqërive dhe qeverisë.”⁵⁵

Prandaj, Saidi u kërkon dijetarëve dhe orientalistëve perëndimorë që të kenë më shumë “mirëkuptim” dhe njohuri për Islamin dhe kulturën islame në njërin anë, dhe për botën shoqërore në anën tjetër, në mënyrë që ata të përfitojnë një tablo të qartë të asaj se çfarë është Islami, më mirë sesa të varen në atë se si media perëndimore e interpreton atë, veçanërisht në stereotipat e përhapura që nga periudha e kolonizimit. Ai shton, dhe unë pajtohem me të (së bashku me disa perspektiva islame), se “arsyet” janë përcaktuesit e vërtetë të një interpretimi të vërtetë: “Përsa i përket përkthimeve varet shumë nga ajo se kush është përkthyesi, kujt i adresohet ai ose ajo, dhe se cili është qëllimi i tij ose i saj në përkthim.”⁵⁶ Në të vërtetë, vetë Saidi është një shembull i diskutimit tim, meqenëse ai ishte një dijetar jomysliman vepra e të cilit mbi Islamin gjeti një auditor të mprehtë në botën islame.

Ajo çfarë unë kam treguar dhe propozuar në këtë artikull, të paktën në mënyrë akademike, është një qasje e mundshme filozofike ose një udhëzues për komentimin e Kur’anit.

55. Eduard Said, *Covering Islam: How the Media and the Experts Determine How We See the Rest of the World (Shpjegimi i Islamit: Si media dhe ekspertët përcaktojnë se si ta shohim pjesën tjetër të botës)*, Nju Jork: Pantheon Books, 1981), f. 158.

56. Ibid., f. 154.



Nëse komentuesi perëndimor është i pastër, i sinqertë dhe i besueshëm (Habermas); transparent (Heidegger); njohës i kulturës (Gadamer); dhe dëshiron me të vërtetë që të njohë dhe të kuptojë Islamin, atëherë komentimi i tij ose i saj i Kur'anit do të pranohet.

Marrë nga faqja:

http://qmul.academia.edu/MohammadHamidMahmoodAssaleh/Papers/1049181/Toward_a_Philosophical_Approach_of_the_Hermeneutics_of_the_Quran

E përktheu nga gjuha angleze:

Ermal BEGA



Ma. Albana Muja

Surja “Jusuf” dhe shoqëria e sotme

Abstrakt

Në morinë e sureve e të ajeteve kur'anore gjithnjë na ka sugjestionuar madhështia e sures “Jusuf”. Ndaj edhe zgjodhëm të shkruajmë për disa aspekte që na jep një studim pak a shumë krabasues i realitetit, për të cilin flet kjo sure me realitetin e sotëm.

Një konsultim baba-bir që ngushton largesat e panevojshme prind-fëmijë bën që të shihet familja si një vatër, si vetëstrehim, si mburojë e qetësi. Jusufi trokiti në qendër të kësaj vatre duke respektuar babanë, por edhe shenjtërinë e familjes. Sa afër kësaj shenjtërie jemi? Sa e njohim ne këtë shenjtëri? A nuk është shoqëria e sotme ajo që rend e troket për zgjidhje të problemeve dhyerë të errëta të kazinove, portave të ulëta të zvetënimit dhe të përçudnimit të moralit njerëzor? Të sprovuarit nuk janë të mobuarit nga mbrojtja e Allahut, as të lënë mënjanë, por janë zgjedhja e Allahut për t'i ngritur më lart e për t'i pastruar dhe se bëri të qartë rregullin dhe ligjin e Allahut se vërtet më të sprovuarit kanë qënë profetët, e si rrjedhojë edhe njerëzimi që vjen pas tyre kur sprovohet nuk është se ai nuk dubet nga Allahut, por i hidhet sprovë për ta pastruar e ngritur në shkallë e grada të tjera.

Drita e Kur'anit - Nr. 4 - 2011



Në morinë e sureve e të ajeteve kur'anore gjithnjë na ka sugjestionuar madhështia e sures “Jusuf”. Ndaj edhe zgjodhëm të shkruajmë për disa aspekte që na jep një studim pak a shumë krahasues i realitetit, për të cilin flet kjo sure me realitetin e sotëm. Jemi munduar të sjellim situata reale dhe dobite që pasojnë pas tyre.

Këshillimi

Jusufi (paqja e Allahut qoftë mbi të!) edhe pse më i vogël se vëllezërit e tjerë, me të parë ëndrrën, nuk iu drejtua as vëllezërve të tij më të mëdhenj, pra as atij “vëllait të madh”, as “shokëve të lagjes”, as shokut më të besuar, por babait. A nuk është ky një kontrast me atë çfarë ndodh sot, ku për hir të asaj të vërtetë që na dhemb të gjithëve, ka humbur rëndësia dhe institucioni i konsultimit për të cilin Allahu flet, madje në një sure, enkas të veçantë “Esh-Shura” (Konsultimi)? Ka humbur një shenjë e mirë: konsultimi me atë që di më shumë se ti. Bashkë me këtë del me rëndësi të veçantë edhe marrja dhe dhënia e përgjegjësisë atij që i përmbush ato, siç ishte një baba si Jakubi. Përse ia tregoi Jusufi ëndrrën, përse pikërisht babait dhe vetëm babait? Ai nuk ngurroi, nuk pati turp, frikë e drojë nga hija e rëndë e babait, por përkundrazi, iu drejtua duke ndërtuar një raport ideal prind-fëmijë, raport, për të cilin sigurisht mund të ketë investuar vetë Jakubi. Një konsultim baba-bir që ngushton largesat e panevojshme prind-fëmijë bën që të shihet familja si një vatrë, si vetëstrehim, si mburojë e qetësi. Jusufi trokiti në qendër të kësaj vatre duke respektuar babanë, por edhe shenjtërinë e familjes. Sa afër kësaj shenjtërie jemi? Sa e njohim ne këtë shenjtëri? A nuk është shoqëria e sotme ajo që rend e troket për zgjidhje të problemeve dyerve të errëta të kasinove, portave të ulëta të zvetënimit dhe të përçudnimit të moralit njerëzor?

Pas dëgjimit të ëndrrës, babai i thotë mes të tjerash:

“...Mos ua thuaj ëndrrën vëllezërve se ka mundësi që ata të thurin kurthe dhe se me të vërtetë, shejtani është ai



që i çon njerëzit në humbje.” U përmbyll ajeti kështu me një domethënie themeltare lidhur me faktin se vërtet e keqja vjen prej cytësit të keq.

Kur Jakubi e paralajmëroi Jusufin që të mos e tregonte ëndrrën, ne duhet të kuptojmë se familja e Jakubit nuk ishte familje e thjeshtë e me fare pak dije, por një familje që kishte njohuri fare të mira për ëndrrën dhe dija për ëndrrën është dije e lartë, që kërkon intuitë e zgjuarsia të lindur. Për sa i takon shpjegimit të ëndrrës, pasi duhet ditur se ëndrrat - shpjeguar edhe shkencërisht nga shumë dijetarë të marrë me botën okulte të tyre - janë mesazhe të koduara që realisht, dihet se jo çdokush do mund të dinte t’i çkodojë. A nuk ishte kjo familje, familje prej 3-4 brezash profetësh: Ibrahim, Is’haku, Jakubi, Jusufi (më vonë)?

Së dyti, Jakubi e ndaloi nga tregimi i ëndrrës jo duke lënë në errësirë arsyen e *përse?*-së, por as duke lënë të nënkuptohet se vëllezërit e tjerë të Jusufit qenkan agresorë e keqbërës, por e tejkaloi fajin dhe tek cytësi, tek i treti, tek pala e tretë mes tyre, një element tjetër, i kontrollueshëm i rrezikshëm për çdonjërin nga ne dhe nga ato pa asnjë dyshim.

Së treti, kur ndalojmë dikë nga diçka, mësuam se duhet arsyetuar përse-ja ose dhënia e mundësisë së dytë, e alternativës, shpjegimit. E arsyetoi duke thënë: “...mos ua trego se vëllezërit mund të të ngrejne kurthe”. Pra, tha: “mund” dhe shtoi elementin që sapo u përmend: një element të jashtëm (ndërmjetësin, pra, atë palën e tretë, e cila në të shumtën e rasteve kur ndërhyt mes dy palëve është rrezik i pashmangshëm-shejtanin).

Së katërti, Jakubi i zbuloi pas frikësimit të tij, në fakt, lidhur me çështjen e vëllezërve dhe e përgëzoi për një jetë plot sprova, por që do duhej të kishte durim, pasi do vinte sërish një ditë lumturie për të duke i thënë: **“...rruga do jetë plot sprova por ti mos mendo keq për Allahun, sepse Ai të ka zgjedhur ty...”**

E ushqeje me mendimin e mirë për Zotin. Kështu, edhe kur u takuan pas shumë e shumë vitesh, djali i tha babait të njëjntën gjë, të njëjtin ajet; iu drejtua me të njëjtin emër të Zotit:



"...Vërtet, Allahu është i Gjithëdituri, i Urti..."

Një mesazh i dhënë nga të dy në kohë shumë të larguara, një mesazh që ia forcon këmbët djalit në fillim të një sprove e babait të vet në fillim të një gëzimi duke e pëmbyllur ciklin e fillim-mbarimit të një takimi të përmallshëm me të njëjtin ajet që në fakt shëron edhe sprovën e shënjon edhe gëzimin e lumturinë.

Kur Jakubi i foli rreth vëllezërve të tij Jusufit, krahas sprovave i tha edhe këtë urtësi: **"...Kjo është sepse Allahu të ka zgjedhur ty..."**

I bëri të ditur se të sprovuarit nuk janë të mohuarit nga mbrojtja e Allahut, as të lënë mënjanë, por janë zgjedhja e Allahut për t'i ngritur më lart e për t'i pastruar dhe se bëri të qartë rregullin dhe ligjin e Allahut se vërtet më të sprovuarit kanë qenë profetët, e si rrjedhojë, edhe njerëzimi që vjen pas tyre kur sprovohet nuk është se ai nuk duhet nga Allahu, por i hidhet sprovë për ta pastruar e ngritur në shkallë e grada të tjera.

Kur vëllezërit e njohën këtë realitet, as që nuk e njohën ëndrrën, por me shumë filluan të urrenin Jusufin, pasi mendonin se babai i tyre i jepte më shumë rëndësi mirërritjes dhe edukimit të Jusufit se sa atyre.

Duke qenë se ata ishin më të mëdhenj, mendimi i tyre ishte: përse babai ynë nuk na do edhe ne po ashtu sa Jusufin dhe vëllain e tij, madje edhe më shumë, se ne jemi më ndihmëtarë për të, më të mëdhenj, më afër dhe thanë: **"Me të vërtetë Jusufi dhe vëllai ynë më i vogli janë më të afërt se ne me babanë dhe se babai ynë është në një humbje të qartë..."**

Si dolën në këtë përfudnim?

Nga një e keqe e madhe që ka mbërthyer pa dyshim rrënjësisht edhe shoqërinë tonë:

Paragjykimi, paramendimi

Ndaj dhe jo pa qëllim Allahu në Kur'an thotë: **"...Largohuni nga paragjykimet ngaqë ato (paragjykimet) të shtyjnë për në mëkat..."**



Dhe a nuk ishte mëkat veprimi dhe planveprimi i tyre? Kur Zoti ndaloj vrasjen e mundimin e njeriut apo tjetrit prej krijesave të tij, ç'mund të thuhet për dëmtimin, mundimin e vëllait tënd më të afërt aq më tepër kur ai nuk e ka hak atë, e as që ka bërë gjë kundër teje?!

Kështu vëllëzërit menduan në humbje, kryen aktin, akt i cili fillimisht ishte si më poshtë:

Ata thanë: “Vriteni!” e më pas, njëri prej tyre tha: *‘...mos e vrisni, por vëreni atë në një bunar se mos kalimtarët që kalojnë aty pari e marrin.’*”
(Sure “Jusuf”)

Këtu del në pah një qëllim por në fakt dy lloj mjetesh, por në fakt mjeti nuk justifikon qëllimin ndaj ky ishte kurthi më i shëmtuar, një mashtim e tradhti e rëndomtë dhe erdhën tek babai me një gënjeshtër tjetër, pas gënjeshtres e mashtimit duke thënë:

“... e sulmoi (hëngri) ujku.”

A nuk gjen kjo situatë argument në kohët tona ku njerëzit shpesh justifikojnë qëllimin me mjetin, ku shpesh njerëzit pas gabimit të parë, nuk vonojnë dhe bien në gabime të njëpasnjëshme. Po përse? Sepse është fjala e Allahut që thotë: ***“...Mëkati fton në mëkat dhe kush prej atyre e vazhdon mëkatin me një punë të mirë e pendim, vetëm ai ka shpëtuar.”***

Allahu thotë: ***“...erdhi një vargan e dërguan një grup për të kërkuar ujë, e zbriti kovën në pus, dhe tha: o myzhde, qenka një djalosh brenda dhe e morën e fshehën tek mjetet që patën me vete. Dhe Allahu e di se ç'do bënin ata me të.”***; ***“...e shitën me një çmim të lirë - me dërhëmë të numërueshëm”***, se çdo gjë që numërohet - është pak. Themi: “ditë të numëruara”, dhe veç mirësitë e Zotit që nuk kanë numërim: ato janë më të mëdhatë.

Pse e shitën? Sa e shitën? Po kush e bleu?

E bleu njeriu më afër mbretit - përmbysen rrethanat. Ky qe përgëzimi që i erdhi pas natës që kaloi vetëm në bunar.



Ja, kujt ia jep pushtetin Allahu. Vetë blerja nga ana e atij njeriu ishte shenjë që Allahu po e ndihmonte. Ai tha: **“Ndoshta na shërben ose mund ta birësojmë si djalin tonë...”**; **“Në këtë formë Ne i dhamë pushtet Jusufit.”** (Sure “Jusuf”)

Ajo për të cilën njihet surja “Jusuf” është devotshmëria e tij, është ndershmëria e tij. Ky stacion quhet boshti kryesor i sures “Jusuf”.

Jusufi u rrit në këtë derë. Çasti kur u vetmua me gruan e vezirit, në Kur’an përshkruhet natyshëm dhe në përshtatje me natyrën e njeriut. Një gjë duhet kuptuar fare mirë: Allahu mund ta përshkruante shkurt ngjarjen, por ajo nuk do ishte reale, prandaj e shpjegoi në detaje për të qenë sa më reale. Gruaja e vezirit ishte me pozitë dhe Jusufi ishte shërbëtori i saj. Megjithatë, provokimi i saj nuk pati fund. Kështu, kur përsëritet situata dhe kërkesa, ai nuk refuzoi rastësisht, por ishte si rezultat i zinxhirit të gjatë të kërkesave të ulta të saj dhe durimit të tij të lartë.

Ja mirësia që i dha Zoti vezirit. Një punë e bërë kur që Jusufi i vogël dhe Jusufi i ruajti bërthamën e familjes së tij - gruan. Iu kthye mirësia atij nëpërmejt nderit të Jusufit që e rriti.

E në Kur’an ka ardhur shprehja: **“...iku prej aktit që donte të ndërmerre gruaja e vezirit: iku me vrap si në ndonjë garim”**, iku nga fitneja dhe hapi derën. Pra, ikja me të shpejtë nga fitneja (sprova) e jo siç ndodh tek ne, ku njerëzit zhyten në fitne e justifikohen se nuk patën mundësi të iknin prej saj.

Allahu e ka pastruar Jusufin në gojët e grave kur thanë: **“Gruaja po e provokon dhe jo Jusufi po e provokon gruan e vezirit...”**

Prej rregullave jetikë është se sa herë që ndodh që dikush flet për të hapur të metat e dikujt (pra, kur qëllimi është përcërimi), dije se Allahu do e sprovovë këtë njeri me të njëjtin send. Pra, ato gra u sprovuan edhe vetë me atë tërheqje e mahnitje ndaj Jusufit. Gruaja e vezirit i ftoi ato gra në gosti, u interesua që t’u përgatiste secilës ndenjësën dhe u dha nga një thikë në dorë dhe urdhëroi Jusufin t’u **“dilte përpara (grave) dhe sapo e panë gratë e atij vendi, u prenë nga duart me thikat e tyre...”**



Ajo çfarë kuptojmë qartë është se siç deshën ta poshtëronin shoben e tyre, po ashtu i poshtëroi Allahu ato.

Justifikimi me mëkat ka ndalesë në Islam. Gruaja pranoi duke shtuar: ***“Unë jam ajo që e provokova, dhe nëse nuk bën atë që unë urdhëroj, atëherë unë do e burgos atë.”***

Dhe profeti Jusuf u bë pushtetari më i madh, jo në pallatin e mbretit, përkundrazi, në burg. Pra, jo prej pushtetit, por në burg. Asnjë rrethanë nuk e ndihmoi të triumfonte, përveçse morali e sinqeriteti ndaj Allahut. Shohim se kjo grua kërkoi pushtet më shumë se sa bashkëshorti i saj. ***“Kur dëgjoi Jusufi këtë, tha: ‘Burgu është më i dashur për mua.’”***

Sprova e radhës: Rrugë drejt ngritjes është e mbushur me rreziqe - ligj i Allahut

Njerëzit më të sprovuar janë peygamberët. Allahu ngre më lart kur bindja jote ndaj Allahut është e saktë dhe parësore nga çdo bindje tjetër. Pra, Allahu di se kujt ia jep sprovën.

Sprova ishte e madhe, pa baba, pa vëllezër, pa familje, i burgosur. Jusufi e shfrytëzoi burgun për mirësi. Metoda e thirrjes në të vërtetën e Jusufit ishte pa gojë, por me shembuj. Ai dha moralin e mire, dhe të burgosurit e tjerë kur shikonin ëndrra thonin: atij po ia themi ëndërrat, sepse në atë kohë mrekullia e asaj kohe ishte shpjegimi i ëndrrave.

1. Duhet të dimë si ta shndërrojmë sprovën në dobi, duhet të gjejmë mjetin dhe metodat produktive për mirësi.

2. Shfrytëzimi i rastit, p.sh. ditët e netët e Ramazanit, a nuk i shfrytëzojmë ne si netë të arta sepse ato nuk vijnë në çdo muaj?

Kështu, ai shpjegoi ëndrrat e dy të burgosurve brenda në burg dhe të dytit i tha: ***“Kur të dalësh nga burgu, më përmend mua tek i pari i vendit.”*** Jo për mbështetje tek ai, por tek qëllimi se po të dilte jashtë do të bënte më mirë thirrjen në të vërtetën.

Por ç’ndodhi kur mbreti i atij vendi pa një ëndërr, e cila e shqetësoi shumë?



Erdhi në Kur'an shprehja: ***"Unë po shoh 7 lopë të majme, pastaj këto lopë po hanin 7 lopë të imëta dhe 7 kallinj plot fryte dhe të tjerë kallinj të thatë."*** Shërbëtori ia dërgoi mbretit shpjegimin dhe mbreti filloi të ndiente miqësi e mirësi për Jusufin, atëherë tha: Ma sillni atë mua këtu dhe kur i thanë Jusufit se e kërkonte mbreti, Jusufi nuk pranoi të dilte prej burgut në atë mënyrë. Ai i tha shërbëtorit: ***"Kthehu tek zotëria yt, tek mbreti, e thuaji çfarë është bërë me ca gra që prenë duart e tyre."*** Doli profeti Jusuf dhe i dha Allahu pozitë të lartë, por pasi u sqarua tek njerëzit se kush qe fajtori për burgosjen.

Erdhën vëllezërit e Jusufit dhe Jusufi i njohu ata, ndërsa vëllezërit nuk e njohën.

Jusufi i njohu ata, e ata jo. Si ka mundësi? Dijetarët thanë se vëllezërit nuk e njohën sepse njeriun udhëheqës nuk mund ta shikosh shumë afër në fytyrë prej turpiti se dhe nuk u ka folur me gjuhë hebreje, sikurse vëllezërit, por egjiptiane. ***"Sa i ngarkoi me mallin që morën, u tha: 'Ku e keni, vëllain, silleni herën tjetër këtu.'"***

Nuk duhet lënë mënjane as metoda e kërcënimit, as e inkurajimit

Në fakt, i kërcënoi, por nuk e fshehu dashurinë që kishte për ta, gjë që do i shtynte të vinin sërish tek ai. Dhe shtoi se nëse nuk do sillnin vëllanë, nuk do kishin më mirësi.

Sapo u kthyen tek shtëpia e tyre i thanë babait: ***"Na është ndaluar mundësia për të marrë sërish furnizim nëse nuk vjen vëllai ynë atje me ne."***

Jakubi tha: ***"Po si t'jua besoj unë djalin tim siç jua besova Jusufin? Allahu është kujdestari më i Mirë."*** Nga kjo kuptojmë se vërtet, nganjëherë e kaluara e dikujt ka ndikim për të ardhmen e dikujt.

Pasi vëllai i vogël i Jusufit qëndroi te Jusufi, vëllezërit e panë se edhe kësaj here nuk po e mbanin fjalën kundrejt babait.



Jakubi dëgjoi me qetësi e vëmendje: ***“O baba, djali yt ka vjedhur e si pasojë e kësaj, u burgos. Ne nuk mundëm ta ruanim. Ne flasim drejt.”*** Mirëpo, Jakubi nuk u besoi duke u thënë se ky ishte mashtrimi i radhës dhe nga mërzia e madhe dhe lotët, iu zbardhën sytë dhe u verbua.

Jusufi doli për t’i pritur në mënyrë të veçantë prindërit e tij. U takua me to dhe i afroi afër vetes. Në vazhdim, Jusufi e thërriti të atin ashtu siç e kishte thërritur kur qe i vogël: “Ja ebeti! (fjalë përkëdhelëse: O babai im!). U përmbush ëndrra që pata parë.” Njëmbëdhjetë yjet që bënëin sexhde ishin vëllezërit e tij, ndërsa dielli e hëna ishin prindërit e tij. U përmendi prindërve sprovat e tij, por filloi me daljen nga burgu dhe nuk përmendi fare daljen nga bunari dhe tha: ***“Ka dashur Allahu që më ka gëzuar me ardhjen tuaj tek unë, pasi që shejtani futi përçarje mes meje e mes vëllezërve të mi.”*** Pra, nuk i qortoi direkt vëllezërit, por përmendi shejtanin dhe veten e tij para e më pas, vëllezërit. Pastaj iu kthye Allahut me dua: ***“O Zot, Ti më ke dhënë pushtet, Ti më ke mësuar komentimin e ëndrrave, më ke ndihmuar sjelljen në situata të ndryshme e kjo nuk është e rëndë për Ty se Ti je Krijuesi...”***

Ai tha: ***“Na mundëso të vdesim myslimanë!”*** Pra, nuk kërkohet vdekja si shpëtim nga sprovat e dynjasë, por si kurorëzim i projekteve të mira që ke bërë gjatë gjithë jetës dhe i vetmi moment kur besimtari kërkon vdekjen, është pikërisht atëherë, kur cënohet feja e tij. Sot, njerëzve u kujtohet të flasin për vdekjen vetëm kur ka ngjarë një vdekje, por tek besimtarët duhet të vijë si përkujtim, edhe kur jemi mes të mirash, duhet të jemi vigilentë e njohës se ai realitet do na kaplojë e caktimi i Allahut vjen kur e do vetë Ai.



Dr. Feti Mehdiu

Përzgjedhje në komentimin e Kur'ani Kerimit

Abstrakt

*Përkthimi i Kur'ani kerimit në gjuhën shqipe ka filluar të botohet qysh në fillim të shekullit XX me përpjekjet e para që bëri rilindësi i madh kombëtar, Naim Frashëri. Në vitin 1985 është botuar në Prishtinë përkthimi i parë i plotë në gjuhën shqipe. Ndërkaq, përkthimi, për të cilin bëjmë fjalë këtu, është i pesti në gjuhën shqipe. Është botuar me një tirazh prej 10 000 kopjesh. Ky përkthim është quajtur **Përzgjedhje në komentimin e Kur'ani Kerimit**, titulli që mban në origjinal - në arabisht. Ky është përkthimi i botimit të trembëdhjetë, me titullin **AL-MUNTAHAB FI TAFSIRI-L-KUR'ANI-L-KERIM**, që ka dalë në Kajro më 1988.*

PËRZGJEDHJE NË KOMENTIMIN E KUR'ANI KERIMIT, vëllimet: 1-10, TIRANË, 1996-1998. f I-VIII + 141 +147 +197 + 227 + 245 +216 + 200? + 217 + 176 + 139. B-5. Përktheu nga origjinali Haxhi Selim STAFJA. Botoi: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë – Komiteti i Botës Islame.

Përkthimi i Kur'ani kerimit në gjuhën shqipe ka filluar të botohet qysh në fillim të shekullit XX me përpjekjet e para që bëri rilindësi i madh kombëtar, Naim Frashëri.¹ Në vitin 1985 është botuar në Prishtinë përkthimi i parë i plotë në gjuhën shqipe.² Ndërkaq, përkthimi, për të cilin bëjmë fjalë këtu, është i pesti në gjuhën shqipe. Është botuar me një tirazh prej 10 000 kopjesh.

1. Naim Frashëri, Mësime, Bukuresht, 1894. ('Thelbi i Kur'anit)

2. *Kur'an-i, Prishtinë*, 1985. E përktheu Feti Mehdiu. E botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë.



Ky përkthim është quajtur *Përzgjedhje në komentimin e Kur'ani Kerimit*, titulli që mban në origjinal – në arabisht. Ky është përkthimi i botimit të trembëdhjetë, me titullin **AL-MUNTAHAB FI TAFSIRI-L-KUR'ANI-L-KERIM**, që ka dalë në Kajro më 1988. Titulli që mban ky botim, si në origjinalin arabisht, ashtu edhe në përkthimin në gjuhën shqipe, **tafsir** – komentim, nuk përputhet plotësisht me domethënien e mirëfilltë që ka fjala *tefsir*, gjegjësisht *komentim*, por kjo çështje do të jetë objekt diskutimi tjetër herë.

Botimi është i ndarë në dhjetë vëllime, me madhësi të ndryshme dhe i numërtuar me shifra arabe prej 1 deri 10.

Vëllimi I (VIII + 141 f.) hapet me “Dy fjalë lexuesit për Kur'anin dhe komentimet që i bëhen” të përkthyesit Selim Stafa. Këtu ai flet për Kur'anin në përgjithësi dhe historikun e tij. U tërheq vërejtjen lexuesve për ndërlikueshmërinë e përkthimit të kësaj veprë “... në të gjitha gjubët e botës...”, por nuk përmend se edhe në gjuhën shqipe përkthyesit e mëparshëm janë përballuar me të njëjtat probleme. U rikujton lexuesve disa konstatime që i kanë nxjerrë me kohë studiuesit e Kur'anit, si, p.sh. se *Kur'an* është vetëm teksti në gjuhën arabe (VI), se Kur'ani ka sjellë kthesë shumë të madhe në historinë njerëzore etj. Do të kishte më interes që për këto konstatime t'u referohej burimeve. Përkthyesi i shpreh mirënjohjen e merituar Komitetit të Botës Islame që e ka përkrah punën e tij “për të vënë në dorë të myslimanëve të Republikës së Shqipërisë këtë Koment të përzgjedhur (VII)”.

Përkthyesi ka bërë një punë më të madhe se kaq. Ky përkthim është në shërbim të të gjithë myslimanëve shqiptarë dhe jo vetëm të atyre në Republikën e Shqipërisë. Ky vëllim përfshin suret: “El-Fatiha” dhe “El-Bekareh”³

3. Titujt i japim ashtu si i ka lënë përkthyesi. Në origjinal kjo sure quhet “Al-Bakaratu”. Kjo “t”-ja e fundit, sipas normave të gramatikës së gjuhës arabe, kur bëjmë pauzë, nuk lexohet si “t”, por mbetet si një “h”, në të shqiptuar. Kur bëjmë tejshkrimin (transkriptimin), është më mirë të përfundojë me zanoren “a” ose “e” - *Bakara*, ose *Bekare*, kurse Bekareh është një formim i dhunshëm. Përkthyesi Stafa vepron njëllor tek të gjithë emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me “t” – n e rumbullakët, si Kijametu – Kijameh, Maidetu – Maideh, në vend që t'i lërë siç shqiptohen natyrshëm: *Kijame*, *Maide*, *Bekare*, etj.



Vëllimi II ka suret “Ali Imran” dhe En-Nisa”. Edhe në këtë vëllim përkthyesi i drejtohet lexuesit të “Republikës së Shqipërisë” me një hyrje të shkurtër që paraqet kryesisht përmbajtjen e hyrjes, e cila u tha në librin e parë.

Vëllimi III ka gjithashtu, një hyrje më të shkurtër se dy librat e parë dhe suret “El-Maideh” e deri në fund të sures “El-Araf”.

Vëllimi IV hapet me fjalën e përkthyesit “Në vend të hyrjes”, në një faqe dhe vazhdojnë suret “El-Enfal” deri në fund të sures “Jusuf”.

Vëllimi V. Pas fjalës së përkthyesit, në një faqe, vazhdohet me suret “Err-Rrad”, deri në fund të sures “Ta Ha”;

Vëllimi VI përmban fjalën hyrëse dhe suret “El-Enbija” deri në fund të sures “En-Neml”.

Vëllimi VII fillon me suren “El-Kasas” deri në fund të sures “Sad”.

Vëllimi VIII hapet me fjalën e përkthyesit, pak më e zgjeruar se në vëllimin e mëparshëm. Pasojnë suret “Ez-Zumer” deri në fund të sures “En-Nexhm”.

Vëllimi IX. Te ky vëllim, përveç fjalës së përkthyesit, si në vëllimin VIII, ka edhe fjalën hyrëse. Më tej, vazhdojnë suret “El-Kamer” deri në fund të sures “El-Kijameh”. Në faqen 177 ka edhe pasqyrën e lëndës, një element ky që u mungon vëllimeve të mëparshme.

Vëllimi X është i fundit. Fjala hyrëse e përkthyesit “Në vend të hyrjes”, përveç shprehjeve falënderuese që përsëriten edhe në vëllimet e mëparshme, ka edhe disa informacione dhe shprehje që vlen të theksohen.

Përkthyesi na informon se këtë punë e ka kryer për më shumë se dy vjet, që është për lakmi dhe meriton çdo lëvdatë për këmbënguljen e tij në punë. Shprehja e Selim Stafës për Kur'anin, “*Kushtetuta e jetës së muslimanit*” nuk është e re në literaturën islame në gjuhën shqipe, por është, gjithsesi një zhvleftësim, mbase



i paqëllimtë, për Kur'anin. Kur'ani nuk duhet krahasuar me aktet normative juridike që përpilohen nga njerëzit dhe janë të përkufizuara në hapësirë dhe në kohë të caktuar.

Janë suret “El-Insan” deri në fund të sures “En-Nas” dhe në faqen 134 – 137 vjen Pasthënia e përkthyesit.⁴ Këtu u drejtohet lexuesve dhe i thërret të kenë kujdes kur lexojnë Kur'anin, me çka, me të drejtë, u tërheq vërejtjen se asnjë përkthim nuk është identik me origjinalin “... se përkthimet e Kur'anit... kanë shërbyer dhe do të shërbejnë vetëm që muslimanët joarabë të njihen me përmbajtjen e librit të Allahut...”⁵ Në këtë pasthënie, përkthyesi jep edhe emërtimin e sureve e të ajeteve ku duhet bërë *sexhde-i tilaveti* dhe përfundon me një lutje të përgjithshme, që është e zakonshme pas leximit të Kur'anit.

Gati të gjitha suret kanë një hyrje informuese të përpiluar nga autorët e Muntehabit dhe S. Stafa e ka përkthyer besnikërisht. Ndërkaq, përkthyesi nuk ka arritur ta vërë tekstin origjinal të Kur'anit në gjuhën arabe afër tekstit në gjuhën shqipe me korrektësinë që e meriton Kur'ani Kerimi. Në suren e parë, për shembull, origjinali është në faqen e parë, kurse përkthimi në faqen e dytë. Surja e dytë, *Al-Bakaratu* e ka tekstin origjinal në faqen 3, kurse përkthimi fillon në faqen 6. Këso parregullsish hasim në tërë përkthimin. Ka raste kur ajetet e Kur'anit në origjinal janë të ndarë arbitrarisht dhe gjysma e ajetit është, p.sh. në f.48 e pjesa tjetër, në f.50 (vëllimi i parë), ose ajeti fillon në f.96 dhe përfundon në f.98 (vëllimi i pestë) etj. Kjo mënyrë e punës flet për një pakujdesi ose mosrespekt ndaj tekstit origjinal të Kur'anit.

Përkthyesi ka edhe disa lëshime, të cilat mendoj se janë pasojë e shpejtimit. Kështu nuk është menduar fort se *Ehlu-l-keita*b nuk janë vetëm çifutët, por janë edhe të krishterët që pasojnë Inxhilin. Kështu, përkthimi *çifutët*, në vend të pasues të Librit e ngushton kuptimin bukur shumë (f.50, v.1.).

4. *Përzgjedhje*..... Tiranë, 1996-1998. Kjo është dashur të ishte në fillim, në vëllimin e parë.

5. *Përzgjedhje*.... f. 78.



Edhe fjala *jetim* do të thotë *fëmijë pa prindër, pa njërin ose pa asnjërin prind*; prandaj nuk duhet të përkthehet *fëmijë që nuk e ka babën*.

Përkhyesi Stafa e realizon gjatësinë e vokaleve të gjuhës arabe përdhunshëm me “ë”, si *Enbijaë* në vend *Enbija*, Nisaë në vend Nisa etj.; për vokalin e gjatë *i*, ai përdor “j”, e cila në gjuhën arabe trajtohet si gjysmëvokal dhe shkruan *amijn* në vend *amin*. Tek emri *All-llah* dhe *Muhammed* nuk përfillen rregullat e origjinalit, domethënë, te secili emër humb nga një bashkëtingëllore dhe shkruhet: *Allah, Muhamed*, në vend të **All-llah dhe Muhammed**. Me fjalë tjera, nuk i përmbahet tejshkrimit të emrave me burim arab, dhe shkruan *Muntekhab* – në vend **Muntehab, Dukhan** - në vend të **Duhan, Akhḡab** – në vend të **Ahḡab** etj... çka do të thotë se nuk është përcaktuar për asnjërin tejshkrim të njohur nga shkollat e orientalistëve të Europës, por as të orientistikës shqiptare.

Përkundra lëshimeve të këtij botimi, ky është një kontribut i çmueshëm për lexuesin shqiptar, sepse paraqet përkthimin e një interpretimi të Kur'anit në gjuhën e sotme arabe. Prandaj, lexuesi në gjuhën shqipe nuk duhet të përpiqet ta barazojë përkthimin me origjinalin e Kur'anit në këtë botim, ngase ky përkthim nuk i referohet origjinalit. Ky nuk është përkthim i origjinalit, por përkthim i një përkthimi ndërgjuhësor të Kur'anit, që gjithsesi është i dobishëm edhe për lexuesin shqiptar; por në anën tjetër, nuk mund të cilësohet si interpretim (Komentim) i Kur'anit në kuptimin klasik. Në gjuhën shqipe mund të flitet për përkthim të tefsirit (komentimit) të Kur'ani kerimit kur të përfundojë puna me botimin e tefsirit të Sejjid Kutbit, i cili sapo ka filluar të dalë në gjuhën shqipe nga shoqata “Drita e jetës” në Gjilan.

Kur'ani, si libër i shenjtë, për tërë myslimanët, edhe te shqiptarët ka vend të veçantë nderi. Por, sikur ky botim të mos paraqitej në format të beletristikës, te lexuesi do të ngjallte një ndjenjë respekti edhe më të madh. Unë mendoj se ky përkthim meriton të botohet në një ose në dy vëllime të formatit më të



madh, me lidhje të fortë dhe duke e ruajtur integritetin e tekstit origjinal. Kështu do të ishte më serioz dhe do të zinte vendin e merituar në qarqet shkencore profesionale. Sidoqoftë, sot, shqiptarët i kanë bërë me këtë pesë përkthime të Kur'anit në gjuhën amtare, çka flet për një angazhim serioz të inteligjencës shqiptare në fushën e islamistikës.



Hajri Shehu

Rreth shkronjave të veçanta në Kur'an

(Paraqitje skematike)

Siç dihet, ka sure në Kur'an që fillojnë me shkurtime, që janë shkronja të caktuara. Sigurisht, secila prej tyre përfaqëson një tingull të arabishtes.

Janë 14 shkronja. Përse ky numër? Nuk mund të themi; por, thjesht si refleksion, gjykimi mund të ishte ky: Alfabeti i gjuhës arabe ka 29 shkronja (duke numëruar edhe hemzen dhe elifin). Siç do të shihet më poshtë, janë 29 sure që nisin me shkurtime të tilla. Gjysma e alfabetit (e marrë rrumbullak) është 14. Dhe ky (14) është numri i shkronjave që përfaqësojnë shkurtime.

Cilat janë këto shkronja? Janë: *elif, ha, ra, sin, sad, ta, ain, kaf, kef, lam, mim, nun, ha, ja*.

Ato kombinohen në raste të ndryshme.

Pesë shkronja kombinohen vetëm një herë: në dy sure - në suren 19 – *kaf, hâ, ja, ain, sad* dhe në suren 42 – *ha, mim, ain, sin, kaf*.

Katër shkronja kombinohen një herë në dy sure: në suren 7 – *elif, lam, mim, sad* dhe në suren 8: *elif, lam, mim, ra*.

Tri shkronja kombinohen në 13 sure: a) *elif, lam, mim* në suret 2, 3, 29, 30, 31, 32;

b) *elif, lam, ra* në suret 10, 11, 12, 14, 15; c) *ta, sin, mim* në suret 26, 28.

Dy shkronja kombinohen në 10 sure:

a) *ta, ha'* në suren 20; b) *ta, sin* në suren 27; c) *ja, sin* në suren 36; ç) *ha, mim* në suret 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46.

1. Ta Ha është emërtimi i sures XX. A mund të mos konsiderohen Ta, Ha shkurtim por fjalë?



Vetëm një shkronjë, pra, e pakombinuar në tri sure: a) *sad* në suren 38; b) *kaf* në suren 50; c) *nun* në suren 68.

A mund të konsiderohen mister këto shkurtime?

Sigurisht, ato nuk mund të konsiderohen mister sepse në Kur'an nuk ka mistere; në Kur'an ka ende gjëra të panjohura, të pazbërthyera, por jo mistere. Koha do t'i zbërthejë. Ato kanë një kuptim që do të rrokët dikur.

Së pari, ajo që mund të shihet, është se ato janë në sure që ndjekin njëra-tjetrën. Kështu, p.sh., kombinimi *elif, lam, ra* është në gjashtë sure që vijnë njëra pas tjetrës (10 – 15). Kombinimi *elif, lam, mim* është në gjashtë sure: në suren 2, 3 dhe vijon në katër sure që ndjekin njëra-tjetrën: 29-32. Kombinimi *ta, sin, mim* është në suren 26 dhe 28. Surja 27 ka kombinimin *ta, sin*. A mund të jenë këto shkronja (*ta sin mim*) për *Tur al Sinin* (mali Sinai) dhe *Musa*, meqë tregimi për Musanë zë pjesën më të madhe të sures? Mirëpo, përse mungon *Mim* në suren 27 që ka të bëjë në pjesën më të madhe me Musanë? A mund të konsiderohet si një sinkopë (rënie e shkronjave) apo *ta, sin, mim* mund të konsiderohen një formë e zgjeruar e *ta, sin*?

Së dyti, të gjitha shkurtime, në një mënyrë a në një tjetër, përmendin Kur'anin ose, Librin; p.sh., në suren 27 përmendet Kur'ani. Në suren 29:27 përmendet Libri në familjen e Ibrahimit ("Dhe Ne i dhamë (Ibrahimit) Isakun dhe Jakubin^{2**} ... dhe Zbulesën ...). Po kështu, edhe më tej, në ajetet 45-51. Në suren 30:58 përmendet Kur'ani. Po në këtë sure, në ajetet 20-27 përmenden shenjat e Zotit në natyrë, libri i natyrës.

^{2**} Isaku ishte djali i Ibrahimit; Jakubi, nipi i Ibrahimit. Në familjen e Ibrahimit është edhe Ismaili, djali më i madh i tij. Secili prej tyre pati profetësi dhe Shpal-lje; Isaku dhe Jakubi nëpërmjet Musait dhe Ismaili nëpërmjet Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).



Aktivitete

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë organizoi më 26.12.2011 një seminar me imamët e myftinive Kukës dhe Malësi e Madhe

Temat kryesore që u trajtuan gjatë seminarit me imamët e Veriut të vendit ishin: rëndësia e predikimit islam dhe përcjellja e mesazhit islam, metodat e predikimit, funksionimi i institucioneve fetare dhe roli i imamëve.

Tryezë rreth problematikës së përkthimit të Kur'anit në gjuhët e huaja

Agjencia Kur'anore Iraniane e Lajmeve (IKNA) njofton se është organizuar tryeza e katërt “Qasje kritike për problemet dhe vështirësitë e përkthimit të Kur'anit fisnik në gjuhët e huaja”. Tryeza është organizuar nga IKNA në bashkëpunim me Universitetin e Shkencave Kur'anore.

Në Kanberra të Australisë organizohet ekspozita e Kur'anit fisnik

Në ekspozitë janë vendosur për ekspozitë vepra artistike kur'anore, përkthimet e Kur'anit fisnik në gjuhë të ndryshme, guar të çmuar dhe sende me vlerë, mbi të cilat janë shkruar ajete të Kur'anit në mënyrë artistike.

Në Jordani u zhvillua kongresi “Kur'ani fisnik dhe pozita e tij në qytetërimin islam”

Në kongres morën pjesë personalitete të shquara dhe veprimtarë të dalluar të fushës kur'anore nga shtete të ndryshme të botës.



Shkëmbimi i përvojave për botimin e Kur'anit fisnik, përdorimi i teknologjisë moderne në Lindje dhe në Perëndim, kontributi i sotëm në shërbim të Kur'anit fisnik dhe shkencave kur'anore kanë qenë prej temave kryesore në kongres.

Agjencia Kur'anore Iraniane e Lajmeve (IKNA), duke cituar gazetën “Al-Jevmu Al-Sabi’a” të Egjiptit, njofton se në një panair ndërkombëtar në qytetin Xhide të Arabisë Saudite ekspozohet një dorëshkrim mëse 300-vjeçar Kur'ani. Ai është i ngjyrosur me za'feron dhe substancë porcelani.

Në Tataristan ekspozohet kopja më e madhe e Kur'anit fisnik e botuar deri me tani. Ajo është vendosur për ekspozim në xhaminë “Kul Sherif” në Kazanc, kryeqyteti i Republikës së Tataristanit në Federatën Ruse.

Ajo ka përmasat 200 centimetra e gjatë dhe 150 centimetra e gjerë. Ka gjithsej 632 faqe dhe peshon 80 kilogramë. Është prej lëkure dhe e zbukuruar me ar, argjend dhe gurë të çmuar. Ajo është projektuar dhe ndërtuar nga një kompani sllovene në Itali.

Agjencia Kur'anore Iraniane e Lajmeve (IKNA), duke cituar faqen e internetit “android-apps.com”, njofton se **ofrohet programi i multimedive për telefonat celularë me përkthim të Kur'anit fisnik në gjuhën suedeze**. Programi përmban tekstin e plotë të Kur'anit fisnik me shkrim të Osman Taha-së dhe leximin e Kur'anit fisnik nga tetë lexuesit e dalluar të botës islame. Suedishtja është gjuha zyrtare e Suedisë, por flitet edhe në disa pjesë të Finlandës.

Agjencia Kur'anore Iraniane e Lajmeve (IKNA), duke cituar burimin informativ “Ifsyp”, njofton se **në Amerikë organizohet olimpiada vjetore e Kur'anit fisnik për fëmijë**. Përveç hifzit të sureve të caktuara për çdo grup fëmijësh, shpjegohet edhe mesazhi kryesor i sureve.



Summaries

Abduldaem Al - Kahiil

The Compliance between Qur'an and the Science

Scientists have discovered that the depth of the ocean has waves that are different from those of the surface. Almighty Allah says: "Either (their deeds) are as the darkness in the deep sea that they cover wave over wave or over those thick clouds, so, the darkness one above the other that he can not discern even his own hand. He whom Allah gives no light, he will have no light at all." (An - Nur: 40)

The French and American researchers claim that the huge stones that are used by the pharaohs to build the pyramids, is but earthenware that is baked at high temperatures ... Have the scientists found any answer to the mystery of how pyramids were built in ancient Egypt? Are there people who still believe that the jinn are the builders of these pyramids? Can you believe that the pyramids of Egypt were built by extraterrestrial creatures? These speculations have prevailed in the world for several centuries. But the new discovery of the French and American scientists will change the opinion of the scientists forever. It would also give a simple explanation of the scientific mystery of pyramids building, but what is more surprising is that this mystery was presented in the Qur'an since fourteen centuries ago.



Ajni Sinani

Hijrah - a Change in the Course of History

The term means the displacement of the first Muslims from Makkah (Mecca) to Yathrib/Medina, where Islamic idea would find suitable terrain, because their faith and their physical existence were threatened in Mecca. The Muslims, together with the Prophet, were forced to leave home, houses and all their property, to maintain their faith and to gain their freedom. "He who emigrates for the cause of Allah, will find many places to live and prosperity on Earth. He who left his house, moving to Allah and His Messenger, and it happens that death may come to him, Allah will surely reward him. Allah is Forgiving and Merciful." (An-Nisa, 100).

Migration of birds and animals

Bird migration across thousands of kilometers of ecological barriers such as oceans, mountains and deserts is one of the most impressive features of the animals' behavior. Birds maintain their body fat to use it as "a fuel" during their migration. They begin to do this before starting the migration. The fat being deposited in the body of a bird makes up the most economical type of fuel, due to the high combustion energy and oxidizing power per unit of measure. When an animal or a bird is ready for migration, it may have to wait until they find suitable conditions for the flight.

Much sleep may result in sudden death

One of the great works in Islam is the prayer at night because the believer does not sleep a long time because he is very concerned about the Life of the Hereafter, when he will stand before Allah, the Creator. But, years ago were published several studies that confirm that sleeping for a long time is good and may result in living longer. New studies have proved that sleeping for many hours may limit human life. According to some recent scientific American studies,



it is confirmed that women that sleep too much, are prone to heart diseases more than those who do not sleep so much. Another study confirms that to stay up or awaken at night can extend your life.

The Contributions of Islamic Technology

Besides the positive impact of Islamic ideology as a religion, Islam reached an unprecedented impact on human history. It united the civilizations of the peoples of a vast territory, stretching from the borders of China to the Atlantic Ocean. This area included the countries of those ancient civilizations, which became later the cradle of civilizations in the Near East, such as Hellenic civilization. All this territory, during the first centuries of Islam, remained under the same governance. During the 6-th century under AH (the 12 century AD) writings of scholars such as Farabi, Ghazali, Fargani (Afragamus), Ibn Sina (Avicenna) and Ibn Rushdie (Averroes) were translated into Latin and became known and were appreciated in the Western countries. The Aristotle's works, which soon had a primary influence on the European thought were translated from Arabic together with the commentaries of Ibn Sina and Ibn Rushdie, for the Europeans of Medieval times. Under the influence of Islam and the Arabic language, the science and the technology of these areas were developed and improved.

Aliaa Ibrahim DAKROURY

A Philosophical Approach for the Hermeneutic of the Qur'an

The term derives from the Latin *hermeneuin* or *hermeneutic*, which means "the intermediation process is developed from the external to the internal understanding". In these lines, one can notice the hermeneutics not only as translating or expression of a meaning, but rather as a explication or a discussion and an interpretation of the spirit and the internal conception of a particular text. In general,



the content of the Qur'an can be classified into three main themes: "doctrinal message", which builds ethics and moral boundaries of human relationships (this topic is interpreted as Shariah-Shari'a (Islamic law), "historical stories", which refer to the histories of the prophets, peoples, different countries and similar materials, and "divine miracle", which is entirely interpreted and fully understood nowadays. The only possible way to do it is through metaphysical understanding.

MA. Albana Muja

The surah "Yusuf" and the present day society

In the myriad of Qur'anic verses and surahs we have always been influenced by the greatness of surah "Yusuf". That's why we chose to write on some aspects that present us a more or less comparative study of the reality, which this surah refers to with the present day reality.

A father-son consultation that narrows down the unnecessary distance between the parent and the child makes us to consider the family as a hearth, as a shelter, as a shield and tranquility. Yusuf knocked at the center of the hearth while respecting his father and the sanctity of the family as well.

How close to this sanctity we are? How much do we know about this holiness? Isn't the present day society that one which runs and knocks at the dark doors of the casinos and the low gates of degeneration and depravity or the defacement of human moral to solve the problems? The sterling are not the denied from the protection of Allah, nor they are set aside, but the God's choice to hoist and purify them. He made clear the rule and the law of Allah that truly, the most sterling and tested have been the prophets and consequently, the humankind following them, while being tested, it does not mean that they are not loved by Allah, but they are tested to be purified and hoisted to other scales and ranks.



Dr. Feti Mehdiu

The Selection in the Commentary of Qur'an Karim

The translation of Qur'an Karim in Albanian language has started to be published since the early twentieth century with the first efforts made by the great national Renaissance man, Naim Frashëri. In 1985 was published in Prishtina the first complete translation into Albanian. However, the translation, referred to, is the fifth translation in Albanian. It is published with a press run of 10 000 copies. This translation is named The Selection in the Commentary of Qur'an Karim, the original title - in Arabic. This is the translation of the thirteenth edition, entitled MUNTAHAB FI TAFSIRI-L-KUR'ANI-L-KERIM, which came out in Cairo in 1988.

PhD Hajri Shehu

About the Separate Letters in the Qur'an

The Arabic alphabet has 29 characters (counting the hamzah and alif). As it follows, there are 29 surahs that start with abbreviations. Half of the alphabet (in round figures) is 14. And this (14) is the number of letters that represent the abbreviations. Which are these characters? They are: *elif, ha, ra, sin, sad, ta, ain, kaf, kef, lam, mim, nun, ha, ja*. They combine with each- other in different cases.



ملخصات

التطابق بين القرآن والعلم

عبدالدام الكحيل

لقد اكتشف العلماء أن هناك أمواج في عمق المحيطات تختلف عن تلك التي على السطح. يقول الله سبحانه وتعالى: **أَوْ كُظِّلِمَتْ فِي نَحْرِ لُجِّي يَغْشَاهُ مَوْجٌ مِّنْ فَوْقِهِ مَوْجٌ مِّنْ فَوْقِهِ سَحَابٌ ظَلُمْتُ بَعْضُهَا فَوْقَ بَعْضٍ إِذَا أَخْرَجَ يَدَهُ لَمْ يَكِدْ يَرَهَا ۗ وَمَنْ لَمْ يَجْعَلِ اللَّهُ لَهُ نُورًا فَمَا لَهُ مِنْ نُّورٍ** ﴿٤٠﴾

(سورة النور: 40)

يزعم الباحثون الفرنسيون والأميريكيون أن الحجارة الضخمة التي تم استخدامها من قبل الفراعنة في بناء الأهرامات، إنما هي من الطين المشوي في درجة حرارة عالية (الصلصال)... هل وجد العلماء أية إجابة على لغز كيفية بناء الأهرامات في مصر القديمة؟ هل ما زال هناك من يعتقد أن الجن هم بناة هذه الأهرامات؟ هل يمكن الاعتقاد بأن الأهرامات في مصر بُنِيَتْ من قِبل كائنات خارج كوكب الأرض؟ لقد سادت هذه التخمينات في العالم لعدة قرون، ولكن الاكتشاف الجديد من قِبل العلماء الفرنسيين والأميريكيين سوف يغير إلى الأبد رأي العلماء. أيضاً فإنه سيُعطي شرحاً مبسطاً علمياً لسرّ بناء الأهرام، ولكن الأكثر إثارة للدهشة هو أن هذا السر موجود في القرآن منذ أربعة عشر قرناً.

الهجرة النبوية – تغيير مجرى التاريخ

أ. عيني سناني

يعني مصطلح "هجرة" نزوح المسلمين الأوائل من مكة المكرمة - حيث كان يهدّد إيمانهم وحياتهم وجودهم المادي - إلى يثرب/المدينة المنورة، حيث فكرة الإسلام سوف تجد أرضاً مناسبة. اضطر المسلمون جنباً إلى جنب مع النبي صلى الله عليه وسلم إلى مغادرة وطنهم، ومنازلهم وكافة ممتلكاتهم للحفاظ على الإيمان ولكسب الحرية. **وَمَنْ يُهَاجِرْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يَجِدْ فِي الْأَرْضِ مُرَاعِمًا كَثِيرًا وَسَعَةً ۚ وَمَنْ تَخَرَّجْ مِنْ بَيْتِهِ مُهَاجِرًا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ ثُمَّ يُدْرِكْهُ الْمَوْتُ فَقَدْ وَقَعَ أَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَّحِيمًا** ﴿١٠٠﴾ (سورة النساء، 100).

هجرة الطيور

هجرة الطيور هي إحدى الميزات الأكثر إثارة للإعجاب لدى سلوك الحيوانات، وعلى مدى آلاف الكيلومترات من الحواجز البيئية كالمحيطات والجبال والصحارى. تحافظ الطيور على نسبة الدهون في الجسم لاستخدامها ك"وقود" خلال الهجرة. فإنها تبدأ في القيام بذلك قبل بدء الهجرة. والدهون المستودعة في جسم الطيور هي نوع من الوقود الأكثر اقتصاداً، وذلك بسبب الطاقة العالية المؤكسدة لكل وحدة قياس. عندما يستعد حيوان أو طير للهجرة، قد يضطر إلى الانتظار حتى تحين الظروف المناسبة للتخليق.



كثير من النوم وموت مفاجئ

صلاة الليل هي إحدى أعظم العبادات في الإسلام لأن المؤمن لا ينام كثيراً في الليل، لأنه مُتَّزِعٌ بالآخرة، حيث سيقف أمام الله الخالق. ولكن، منذ سنوات نُشِرَتْ بعض الدراسات التي تقول بأن النوم لفترة طويلة مفيد، وقد يكون سبباً لحياة طويلة. وقد أكدت دراسات جديدة أن النوم لساعات طويلة قد يحد من طول حياة الإنسان. وحسب بعض الدراسات العلمية الحديثة في أمريكا أُكِّدَتْ أن النساء اللاتي نالن ساعات كثيرة، إنما هي عُرضة للإصابة بأمراض القلب أكثر من تلك اللاتي نالن كثيراً. ودراسة أخرى تؤكد أن الإستيقاظ في الليل قد تكون سبباً لطول الحياة.

إسهامات التكنولوجيا الإسلامية

أثر الإسلام تأثيراً غير مسبوق له في التاريخ البشري إلى جانب الأثر الإيجابي للفكر الإسلامي كدين. وحَدَّ الإسلام بين حضارات وشعوب مساحات شاسعة من الأرض تمتد من حدود الصين إلى المحيط الأطلسي. لقد شملت هذه المنطقة بلدان تلك الحضارات القديمة والتي أصبحت في وقت لاحق مهد الحضارات في الشرق الأدنى، مثل الحضارة الهلينية (الإغريقية). فكل هذه المساحة طُلَّت تحت حكم واحد خلال القرون الأولى للإسلام. خلال القرن السادس الهجري (القرن 12 الميلادي) كتابت العلماء كالفارابي والغزالي، والفراغاني، وابن سينا، وابن رشد تم ترجمتها إلى اللاتينية وأصبحت مشهورة وكانت موضع تقدير في الغرب. تُرجمت أعمال أرسطو - التي كانت لها تأثير أساسي على الفكر الأوروبي - من اللغة العربية إلى جانب تعليقات ابن سينا وابن رشد لها لأوروبيي القرون الوسطى. وقد تم تطوير وتحسين علوم وتكنولوجيا هذه المناطق تحت تأثير الإسلام واللغة العربية.

مقاربة فلسفية حول هرمنيوطيقا (تفسيرية) القرآن

عليا إبراهيم الدكروري

مصطلح (هرمنيوطيقا) مشتق من اللاتينية (*hermeneutik*) أو (*hermeneutika*)، والتي تعني "عملية الوساطة تُنظَر من معنى خارجي إلى معنى داخلي". من خلال هذه الأسطر، يمكن للمرء أن يرى الهرمنيوطيقا ليس فقط لترجمة أو تعبير عن معنى، بل باعتباره مناقشة وتفسير الروح والمعنى الباطني لنصٍّ معيَّن. بشكل عام، يمكن تصنيف محتويات القرآن إلى ثلاثة محاور رئيسية هي: "الوسالة الإيمانية" التي تبني الأخلاق والحدود الأخلاقية للعلاقات الإنسانية (تُفسَّر هذا الموضوع بللشريعة الإسلامية)؛ "القصص" التي تشير إلى قصص الأنبياء، والشعوب من مختلف البلدان وما شابهها؛ و"المعجزة الإلهية" وهي ما فُسِّر تماماً وما فهم تماماً في عصرنا. فلطريقة الوحيدة الممكنة لتحقيق ذلك هي من خلال الفهم الميتافيزيقي (فهم الماورائيات).

سورة يوسف والمجتمع اليوم

ألبانا موي

من بين العديد من الآيات والصور القرآنية أدهشنا دائماً عظمة سورة يوسف. ومن هنا، اخترنا أن نكتب عن بعض الجوانب التي تشير إلينا دراسة مقارنة للواقع الذي نتحدث عنه هذه السورة بالواقع اليوم. فالمشاور بين الأب وابنه هي التي تضيق المسافة بين الوالد والولد وتجعله يرى الأسرة كملجأ آمن، و



كدرع أمان. طرق يوسف باب هذا الملاذ، محترماً والده و قداسة العائلة. فكم نحن قريب من هذه القداسة؟ و كم نعرف هذه القداسة؟ ألم يسعى أفراد المجتمع اليوم و يطرقون أبواب الكازينوهات المظلمة، وأبواب الفساد الأخلاقي و الأماكن المشينة للأخلاق الإنسانية؟ الممتحنون ليسوا المطرودين من حماية الله، ولا الذين وُضِعوا منهمشين جانبا، و لكنهم اختار الله للرفعة و التطهير. هذه سنة الله، فمن الواضح أن معظم الممتحنين من الله هم الأنبياء و يليهم غيرهم من الإنسانية. أنما يختبرهم الله ليُظهرهم و حُباً بهم و ليعلوهم إلى المرتب العليا.

منتخب من تفسير القرآن الكريم

د. فتحي مهديو

بدأ نشر ترجمة القرآن الكريم إلى اللغة الألبانية منذ مطلع القرن العشرين مع الجهود الأولى التي بذلها كاتب النهضة الوطنية الكبير نعيم فراشري . و في عام 1985 نُشِرَتْ في بريشتينا الترجمة الأولى للقائمة إلى الألبانية. ومع ذلك، فإن الترجمة التي نحن بصدها هنا، هي الخامسة إلى اللغة الألبانية. و قد تم نشرها في 10000 نسخة، و سُمِّيَتْ **منتخب في تفسير القرآن الكريم**، الذي يوافق العنوان الأصلي في اللغة العربية. هذه هي ترجمة الطبعة الثالثة عشرة، مع عنوان **المنتخب في تفسير القرآن الكريم**، الذي صدر في القاهرة عام 1988.

حول الحروف المقطعة

أ. د. خيرى شهو

الأبجدية العربية لها 29 حرفاً (إذا عدنا الهمزة والألف). كما سيوضح أدناه، 29 سورة من سور القرآن تبدأ بالحروف المقطعة. فنصف الأبجدية (تقريباً) هو 14. وهذا (14) هو عدد الأحرف التي تمثل ال حروف المقطعة. ما هي هذه الأحرف؟ هي: الألف، و الهاء، و الواو، و السين، و الصاد، و الطاء، و العين، و الفاف، و اللام، و الهم، و النون، و الهاء، و الباء. إنها تتحد و تتشابه في حالات مختلفة.



نور قرآن

فصلنامه علمی قرآنی

صاحب امتیاز: مؤسسه قرآن کریم آلبانی

مدیر مسئول: محمد رضا حاج خضر

سر دبیر: پروفیسور دکتر خیری شہو

اعضای ہیئت تحریریه:

پروفیسور دکتر بدری بولوکو

پروفیسور دکتر فتحی مہدیو — استاد دانشگاه پریشتینا (کوزوو)

حاج افندی سلیمان رجبی — رئیس مشیخہ اسلامی کشور مقدونیہ

حاج سلیم اصطفی

حاج یتیمیر چیلا

شیخ ولنت مریا

ویرایش ادبی: خانم لیسیدا رامای

صفحہ آرایہ: فاتمیر شوتینا

2011/4 (18)

نمبر



KUJTESË PËR AUTORËT

Revista pranon me kënaqësi bashkëpunimin e të gjithë teologëve e të studiuesve të Kur'anit dhe të fushave të tjera të shkencës. Prandaj, janë të lutur autorët që të sjellin në redaksi artikuj studimorë që kanë të bëjnë me Kur'anin dhe kur'anologjinë.

Që të shqyrtohen artikujt nga redaksia, autorët janë të lutur të ndjekin udhëzimet e mëposhtme:

- Shkrimi nuk duhet të jetë më shumë se 10-12 faqe kompjuteri, bashkë me një abstrakt.
- Është e detyrueshme gjuha shqipe standarde.
- Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjave ë dhe ç me e dhe c.
- Të mos përdoret shkronja e madhe I aty ku nuk duhet.
- Midis shenjës së pikësimit dhe fjalëve pasardhëse të lihet vetëm një hapësirë.
- Citimet në tekst të jepen me shkrim të pjerrët.
- Referencat në tekst të jepen me numra arabë dhe të numërohen sipas rendit që citohen. Ja, si mund të ishte një shembull citimi: Shih M. Golshani, *Kur'ani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës*, Tiranë, 2007, f. 73. Librat e pabotuar e dorëshkrimet nuk citohen, por mund të jepen në tekst në kllapa.
- Artikulli të jetë i radhitur në "Word" dhe të dorëzohet në CD, USB ose të dërgohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail): (f_quran114@yahoo.com).
- Shkrimi nuk duhet të jetë botuar askund tjetër.
- Shkrimi nënshkruhet nga autori dhe jepet adresa e plotë, numri i telefonit dhe e-maili.

